



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 14 DHE 17 DHJETOR 2015

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 14. I 17. DECEMBRA 2015. GODINE

DHJETOR - DECEMBAR
2015

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016,
5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore 10,
6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2014 për projektin e Huas,
7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin Marrëveshjes së kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në QKUK,
8. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës,
9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive,
10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare,
11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115,
12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës,
13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial,
14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore,
15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e maturës shtetërore,
16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit,
17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë termike,
18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës,
19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjet nr. 03/L-221, nr. 04/L-116 dhe nr. 04/L-194,
20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për prokurimin publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237,
21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës,
22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
23. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit,
24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin anëtarëve në Bordin e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë - ZRRE,
25. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin anëtarëve në Bordin e Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare - ARKEP,

26. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit,
27. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media dhe
28. Propozimi i GP të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin Parlamentar.

Dnevni red

1. Vreme za deklarisanja izvan dnevnog reda,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodne sednice,
4. Drugo razmatranje Nacrta zakona o budžetu Republike Kosova za 2016.godinu,
5. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji sporazuma za zajam između Vlade Republike Kosova i Evropske banke za obnovu i razvoj o projektu za rehabilitaciju železničke pruge 10,
6. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji sporazuma za zajam između Vlade Republike Kosova i Vlade Savezne Republike Nemačke za finansijsku saradnju 2014 za projekat Zajma,
7. Razmatranje Nacrta zakona o ratifikaciji Sporazuma o kreditu Kosovo – Unicredit Bank Austrija AG za finansiranje Projekta modernizacije usluga invazivne kardiologije UKCK,
8. Razmatranje predlog – amandmana br. 25 na Ustav Republike Kosova, ponovno prosleđen od Vlade,
9. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju i sankcionisanju nasilja u sportskim događajima,
10. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sigurnosti na radu u rudarskoj delatnosti,
11. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br. 04/L-034 o Kosovskoj agenciji za privatizaciju, izmenjen i dopunjen Zakonom br. 04/L-115,
12. Drugo razmatranje Nacrta zakona o geografskim pokazateljima i nazivima porekla,
13. Drugo razmatranje Nacrta zakona o industrijskom dizajnu,
14. Drugo razmatranje Nacrta zakona o uspostavljanju Fonda za kreditno jemstvo na Kosovu,
15. Drugo razmatranje Nacrta zakona o ispitu državne mature,
16. Drugo razmatranje Nacrta zakona o regulisanju usluge vodosnabdevanja,
17. Drugo razmatranje Nacrta zakona o termičnoj energiji,
18. Drugo razmatranje Nacrta zakona o Akademiji Nauka i Umetnosti Kosova,
19. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmenama i dopunama zakona br. 03/L-048 o menadžiranju javnih finansijskih i odgovornostima, izmenjen i dopunjen zakonima br.03/L-221, br. 04/L-116 i br.04/L-194,
20. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona br.04/L-042 o javnoj nabavci u Republici Kosova, izmenjen i dopunjen Zakonom br.04/L-327,
21. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o tužilačkom savetu Kosova,
22. Drugo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o sprečavanju konflikta interesa u vršenju javne funkcije,

23. Razmatranje Predloga - odluke Vlade Republike Kosova o imenovanju članova borda Kosovske Agencije za privatizaciju,
24. Razmatranje Predloga - odluke Vlade Republike Kosova o imenovanje članova Odbora Kancelarije regulatora energije - KRE,
25. Razmatranje Predloga-odluke Vlade Republike Kosova o imenovanje članova Odbora regulativnog autoriteta za elektronske i poštanske komunikacije - RAEPK,
26. Razmatranje izveštaja Komisije za evropske integracije o nadzoru sprovođenja Zakona br. 04/L-218 o sprečavanju i borbu protiv trgovine ljudima i zaštiti njenih žrtava,
27. Predlog o osnivanju Ad-hoc Komisije o izboru članova Borda za žalbi u Nezavisnoj komisiji za medije i
28. Predlog PG PDK o zameni jednog clana u parlamentarnoj komisiji.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Përshëndetje të gjithëve!

Visar, a ka mundësi të na drejtohesh prej ulëses me kërkesën. Sepse as mediat as askush s'po e di cila është kërkesa. Vetëm ulu e fol, e ti mund prapë. Le të na drejtohet dikush, e ke mundësinë më mirë.

Urdhëro, le të dëgjojnë edhe mediat. Fol prej foltores! Kush të dojë prej liderëve opozitarë le të flasë. Ju kisha lutur! Ani de, mirë! Fol prej ulëses! Të lutem!

(Opozita hedh gaz lotsjellës në sallën e mbledhjeve plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.)

Përsëri?! Mosni kështu! Pauzë! Ju lutem, deputetët lëshojeni sallën derisa ambienti të pastrohet. Përsëri po e vetëpërfshijeni veten. Përsëri po e vetëkriminalizoni veten. E panevojshme për besë!

Dilni, largohuni edhe deputetët e opozitës! Largohuni, mos merrni gaz askush! Edhe mediat! Largohuni prej sallës, le të pastrohet.

Kryesia, takohemi në sallën 301. Kryesia dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Largohuni sa më shumë prej gazit. Pauzë!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes plenare në sallën alternative
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Media të nderuara,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritar,
I hap punimet e seancës së sotme plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Ndërkohë derisa të rregullohet përkthimi kush dëshiron, si pyetja e parë mund me qenë, ka të drejtë secili me korrektësi vetëm për hir edhe të publikut. Kryesia morri këtë vendim të cilën jemi aktualisht me Rregullore, keni të drejtë, kemi të drejtë me pas parasysh, por sido që të jetë shqetësimi është real. Derisa të rregullohet përkthimi jemi të obliguar të presim, më vjen keq.

Fjalën e ka Melihate Tërmkolli.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, kryetar i Parlamentit, anëtarë të Kryesisë edhe krejt çka jeni,

Kryetari tha që opozita e ka përjashtua veten nga parlamenti, mendoj që është e kundërta. Opozita është duke ndenjur në sallë atje, ne kemi dalë prej sallës, nuk e di kush e ka përjashtuar tash këtu veten prej Parlamentit. Ne e kemi përjashtuar veten prej Parlamentit. Edhe po ju them, unë do të rrijë këtu vetëm t'i votoj marrëveshjet ndërkombëtare që krejt bota po mundohet të na ndihmojë edhe për hir të tyre, për hir të ndihmesës së tyre unë do të jem këtu për t'i votuar, e pjesën tjetër jo. Ju kam thënë, lini më improvizimet! Nuk di qysh keni për të bërë zgjidhje, por zgjidhja duhet bërë.

Po shpreh me keqardhjen më të madhe, sepse kush e ka ndërtuar këtë shtet, kushdo që ka punuar qoftë një grimë, e di shumë mirë se është duke ju dhimbur shpirti që po na rrënohet shteti para syve. Faleminderit!

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjatë deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta. Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarojnë se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Kushdo si e kërkon fjalën duhet me dorë edhe votimi bëhet me dorë, ta keni parasysh. Urdhëro, Slavko!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

KRYETARI: Ju kisha lutur, vetëm pak qetësi!
I nderuar deputetë,

Ju lutem veç një minutë!

Deputeti i nderuar Nait Hasani ka ngritë një çështje e cila është edhe ajo reale. E lus administratën veçanërisht për gjithë deputetë të cilët nuk e njohin gjuhën serbokroate le ta sjell përkthimin. Te Naiti në rend të parë edhe rend, këto ndijueset. Sa veta janë që kërkojnë përkthim? 11. Të gjitha masat janë ndërmarrë, kërkojmë falje vetëm për shkak të kësaj situate, po Administrata e Kuvendit është e përgatitur për të gjitha masat.

A mundemi me e vazhdua seancën, a jemi gati? Atëherë të lutem, deputet i nderuar, vazhdo!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedniče!

Poštovani predsedniče Vlade,

Poštovani ministri,

Dame i gospode narodnih poslanici,

Poštovani građani,

Kao što ste svi upoznati, poslednih nekoliko dana desilo se niz napada na Srbe koje žive na Kosovu.

Ovo je još jedan u nizu pokazatelja da bezbednosna situacija na Kosovu nije zadovoljavajuća.

Prošle nedelje imao sam priliku da posetim naše uplašene i uznemirane građane koje žive u Goraždevcu i Srbobranu. I ovom prilikom želim takođe da se zahvalim i na poseti predsednika Skupštine, gospodina Kadrija Veseljija građanima koje žive u toj oblasti i što je razgovarao sa njima i što je im izašao u susret o voj teškim trenucima.

Videli smo da su građani u ovim mestima suočavaju sa konstantnom represijom, svi smo mogli u razgovoru sa žiteljima Goraždevca i Srbobrana sigurno da uočimo da kod njih ne postoji bilo kakav optimizam već strah i strepnja što je poražavajuće i zabrinjavajuće za naše društvo.

Oni ne veruju čak što više da će situacija da se promeni na bolje ili da će počinuti ovih krivičnih dela biti privedeni pravdi. Čak šta više oni navode da je to njihov svakodnevica.

Ovo je nešto što bi trebalo da zabrine kako Srpsku tako i Albansku zajednicu na Kosovu, međutim to je nažalost realnost koja Vlada na Kosovu za Srbe već poslednjih nekoliko godina i realnost koji mislim da trebamo svih zajedno da promenimo.

Zato apelujem na sve relevantne aktere a posebno na organe bezbednosti da urade sve što je u njihovoj moći da zaštite građane Srpske nacionalnosti i oni koje žive u povratničkim mestima na Kosovu i da tako... jasnu poruku svima onima koje žele da stabilizovati situaciju na Kosovu da to neće biti tolerisano i da će to biti najoštrija sankcionisano.

Krajnje vreme da se preduzmu konkretni koraci kako bi počinoci ovih groznih dela bili privedeni pravdi.

Ja istino smatram da većina albanskih zajednice želi da živi u miru pored svojih komšija Srba i za to ne smemo dozvoliti da čitavo naše multietničko društvo na Kosovu bude talac jednoj maloj grupi ekstremista koja želi da spreči, da gradimo našu zajedničku budućnost na Kosovu.

Ne želim ovde da pozivam međunarodnu zajednicu da zaštiti naše građane, ne želim zato što imamo institucije. Institucije koje su zadužene da pruže bezbednosti i sigurnost svim građanima i za to je potrebno da pokažu svoju sposobnost da ulože mnogo truda, da preuzme odgovornosti da konačno pokažu i da budu odlučniji ka je u pitanju bezbednost naših građana i da pokažu nepristrasnost.

Srpska lista će nastaviti da podržava povratak Srba na Kosovu i nastaviće da radi na poboljšanju života Srba ali isto tako i svih građana koji žive na Kosovu.

Još jednom apelujem na sve institucije, dakle došlo je krajne vreme da se pređe sa reč i obećanja na konkretne akcije kako bi se srpski narod koji živi na Kosovu i koji treba da bude deo ovoga društva zaštitio. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit! A dëshiron dikush tjetër? Jo!

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjatë 60 minuta. Për këtë seancë janë parashtruar 4 pyetje parlamentare. Me aq sa po shoh tri nga pyetjet deputetja nuk është këtu, vetëm në qoftë se donë ministri Imet Rrahmani, për Time Kadrijaj të përgjigjet ose kryeministri Isa Mustafa për Teuta Haxhiun.

Deputeti Slavko Simiq, pyetje për ministrin e Drejtësisë, zotin Hajredin Kuçi. Tjetër herë. Faleminderit!

3. Miratimi i procesverbalit nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë,
Nëse keni vërejtje në procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 30 nëntor 2015, urdhëroni!
Në qoftë se nuk ka vërejtje.

Konstatohet se Kuvendi miratoi procesverbalin e seancës plenare të mbajtur më 30 nëntor 2015.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa E ka shqyrtuar Projektligjin për Buxhetin e republikës së Kosovës për vitin 2016 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani që para deputetëve të arsyetoj raportin me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Të nderuar deputetë,

Buxheti i Republikës së Kosovës është buxhet i qytetarëve të saj. Nevojat dhe kërkesat janë të mëdha, janë shumë më të mëdha se mundësitë dhe Komisioni ka japë ndryshimet e propozuara, është kujdesur që ndarjet buxhetore të jenë të orientuara më shumë në investimet kapitale, në projektet ku përfitojnë drejtpërdrejtë qytetarët e Kosovës.

Kjo mund të shihet me ndarjen në arsim, në shëndetësi, aktivitete sportive dhe kulturore.

Me interes janë shqyrtuar edhe disa kërkesa për financimin e disa projekteve të mëdha të natyrës strategjike që kërkojnë mjete të mëdha financiare e që nuk mund të financohen nga buxheti dhe vlerësimet e Komisionit janë që për këto projekte Qeveria duhet të hartoj një program të veçantë të financimit të tyre siç është për shembull projekti të cilën kemi pasur kërkesë konkrete për “Ibër-Lepencin” që ka të bëjë me ujitjen e një pjese të madhe të komunave të Kosovës.

Komisioni është ballafaquar me një numër të madh të kërkesave të institucioneve dhe agjencive të pavarura të cilat janë bërë problem në vete për shkak të numrit të madh të tyre dhe për numrin e madh të bordeve që në disa raste po bëhen edhe pengesë në funksionimin e institucionit apo agjencisë...

KRYETARI: Ju kisha lutur pak, më fal i nderuar kryetar, pak qetësi se po kanë problem deputetët në dëgjimin edhe ata altoparlant mundësisht mos po interferojnë njëri me tjetrin me kamera diçka, veç pak qetësi.

NASER OSMANI: ...dhe Kuvendi duhet të rishikojë nevojën e ekzistimit të numrit kaq të madh të këtyre agjencive dhe të bëjë ndryshimet e nevojshme legjislative me qëllim të mundësisë së zvogëlimit apo fuzionimit të tyre të cilat thjeshtë janë bërë një ngarkesë e madhe për buxhetin e Kosovës.

E njëjta situatë është edhe për ndërmarrjet publike, gjë që vazhdimisht paraqesin kërkesa të mëdha buxhetore edhe pse ato duhet të jenë të vetë financuara.

Prandaj, Qeveria duhet të rishikoj mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre dhe të shikoj edhe vetë nevojën e ekzistimit të bordeve kur dihet se Qeveria është pronarë i tyre dhe lidhjet më të mira në nivelin e dhënies së përgjegjësisë do të ishte mes menaxhmentit dhe Qeverisë.

Me ndryshimet e propozuara është bërë e mundur financimi i RTK-së për periudhën janar-qershor të vitit të ardhshëm. Por, për kundër kësaj zgjedhja është zgjedhja e përkohshme.

Komisioni për Buxhet dhe Financa i rekomandon Komisionit Funkcional për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media që brenda kësaj periudhe të propozoj modelin për mënyrën e qëndrueshme të financimit të RTK-së.

Lidhur me shpenzimet e buxhetit për projektet kapitale të Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit për të cilat vazhdimisht ka pakënaqësi nga komunitetet Komisioni është munduar që të bëjë një zgjidhje të përkohshme përmes rregullimit në pjesën tekstuale të amendamentimit ka të propozuar.

Mendoj që me buxhetin e ardhshëm nuk duhet të ketë ndarje buxhetore në baza etnike e për projekte të paspecifikuara aq më pak projekte për kthim kur dihet se situata tani nuk është sikur ajo e pasluftës.

Prandaj, buxheti duhet të bëhet në bazë të projekteve të hartuara paraprakisht të kanë emër, para masën, parallogarinë të saktë për financimin e projekteve konkrete.

Komisioni për buxhet dhe financa një zëri ka miratuar raportit dhe Kuvendit i ka paraqitur miratimin e amendamenteve.

Amendamentet që nuk e kanë përkrahjen e Komisionit nuk do të duhej të miratoheshin apo të përkraheshin nga deputetët sepse në këtë mënyrë do të prishej struktura e buxhetit.

Prandaj, në emër të Komisionit dhe punës që ka bërë për këto pakë ditë me një dinamikë të jashtëzakonshme të punës kërkoj nga deputetët që t'i votojnë vetëm amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryetar i Komisionit! Kërkoj falje se ndoshta nuk e keni krejt këtë zhurmë por s'kemi...

Pas paraqitjes së raportit nga Komisioni Funkcional të drejtë për diskutim e kanë përfaqësuesit e komisioneve të përhershme, përfaqësuesit e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë dhe deputetët.

Projektligji për Buxhetin e vitit 2016 janë propozuar gjithsejtë 62 amendamente. Margarita, qoje dorën se Margarita po e kërkon fjalën. Urdhëro, Margarita! Margarita pa grup le ta merr se edhe kështu e njehë ekonominë.

MARGARITA KADRIU: Arben, për informatën tënde unë s'kam qenë e informuar për vazhdimin e seancës së kaluar, prandaj edhe e kam kërkuar të drejtën që atë të drejtë që kam pasur për të folur në seancën e kaluar tash shfrytëzoj kësaj radhe për buxhet. Faleminderit!

I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar Kabinet qeveritarë,

Të nderuar deputetë,

Dhe të nderuar qytetarë,

Fillimisht më duhet të theksoj se është për keqardhje do t'i bie sa më shkurtë. Unë besoj që këto vërejtje janë shumë me rëndësi.

KRYETARI: Më fal vetëm diçka të sqaroj me aspekt procedural. Rregullorja i japë mundësinë, përfaqësuesit e komisionit të përhershëm, ajo çka bëra shkelje Margarita si deputete e para, por mu në komisionet e përhershme në qoftë se donë para saj, përfaqësueset e grupeve parlamentare, përfaqësuesi i Qeverisë, por deputetët kanë të drejtë të keni parasysh.

Neni 58, paragrafi 1, i Rregullores së Kuvendit. Urdhëro, vazhdo e nderuara deputete.

MARGARITA KADRIU: Faleminderit, zonja Brovina!

Është për keqardhje mbajtja e seancës në këto kushte të jashtëzakonshme më duhet me e theksua pa tjetër, definitivisht pa praninë e opozitës, disa në burgje... arrest shtëpiak, me gaz lotsjellës poshtë në këtë sall të improvizuar. Definitivisht unë konsideroj para se të filloj veç një fjali të them. Unë ndih si deputetë nuk guxojmë kurrësi të lejojmë që të vazhdoj situata kështu, duhet të krijohet dialogu pozitiv dhe opozitë dhe të ecim tutje për punën të cilën ne e kemi.

Ndërkaq sa i përket projektbuxhetit i nderuar, në dhjetor të vitit të kaluar kur u votua Projektbuxheti për vitin 2015, gjatë diskutimit tim pata theksuar se vërejtjet për atë buxhet janë të panumërta, mirëpo problemi kryesor dhe që përsëritet për rreth 15 vitet e fundit është lidhur me projektimin e gjithë përfshirjeve reale apo jo të të gjitha të hyrave buxhetore në vend.

Sot, Projektbuxheti për vitin 2016 është në lexim në dytë, ndonëse në kushte të jashtëzakonshme dhe storia e njëjtë sërish po përsëritet. Pra një viti në cilësinë e deputetes së pavarur e kisha propozuar Kuvendin që të formoj një Komision të posaçëm ad hoc hetues parlamentar i përbërë nga të gjitha përfaqësimet në parlament, për t'i bërë të gjitha gjetjet dhe konstatimet e besueshme për ne të gjithë, se si kemi humbur në pakshim për çdo vit kalendarik nga një buxhet të tërë, duke i adresuar e duke i gjetur gjurmët e shpërdorimeve eventuale të cilitdo zyrtarë.

Mirëpo të nderuar kolegë, shumica parlamentare nuk e nënshkruan nismën e filluar nga unë për krijimin e Komisionit hetimor parlamentar. A thua pse? Ata vetë se e dinë sigurisht pse nuk e kanë nënshkruar, mirëpo qytetarët e vendin duhet të dinë se shumica parlamentare nuk e kishte vullnetin dhe dëshirën e gatishmërinë e as interesin ta zbardhin se ku po shkon ai buxhet i humbur në xhepat e kujt apo në kontot e kujt po përfundon edhe një buxheti i tërë që e paguajnë rregullisht qytetarët dhe bizneset e ligjshme.

Të gjithë të mirë të informuarit e thonë se po të zbatoheshin ligjet e vendit dhe Kushtetuta buxheti i republikës së Kosovës do të kapte shifrën rreth 3 miliardë euro, ose sa dyfishi i këtij viti që është propozuar nga Qeveria aktuale. E cila realisht është vetëdorëzuar para të fortëve që bëjnë pandashëm për çdo vit kontrabandën evazionin, korrupsionin, krimin e organizuar, ku përfshihen edhe zhvatjet, plaçkitjet e buxhetit të mbledhur të shtetit.

Të nderuar qytetarë,

Projektbuxheti për vitin 2016, nuk ka risi, është i pashpresë për qytetarët, sikur që nuk shpreh fare aspiratat e vërteta të qytetarëve tanimë të nëpërkëmbur të këtij vendi. Nuk jep shpresë as për përmirësim të ekonomisë, as për rritje të punësimit, e as për nxitje të investimeve të huaja dhe të vendit.

Ky propozim i Qeverisë është vetëm një dëshmi se Kosova do të vazhdojë rrugën e vendnumërimit, status quo-s që i bie mbetje në vendqëndrim.

Ky propozim i projektbuxhetit dëshmon gjendjen ekonomike dhe vullnetin e vizionit të qeverisë, ky projektbuxhet vërteton se gjendja e rënduar socio ekonomike në vend do të vazhdoj të mbetet e tillë.

Sipas Projektbuxhetit 2016, edhe vitin tjetër paratë e taksapaguesve kosovarë do të shkojnë për projekte të nisura para disa viteve, kryesisht premtime të vjetra elektorale.

Pjesa më e madhe e projekteve të reja do të jenë riparimi dhe ndërtimin e rrugëve të reja.

Edhe pse premtimet kanë qenë se do të rritet buxhet, duke e luftuar ekonominë joformale, asnjë shenjë nuk po shihet se diçka e tillë do të ndodh. Thjeshtë pajton krimit ekonomik Stop buxheti nuk do të ngrihet.

Buxheti 2016 po ashtu nuk përmban projekte të reja as për sistemin arsimor, as të shëndetësisë e as të bujqësisë si një fushë me potencial të zhvillimit.

Së pari, të hyrat prej 1.6 miliard eurosh, me një rritje prej 4.1% vazhdojnë të vjelën në kufi. Nga 61% sa ishte sivjet pjesëmarrja e të hyrave nga kufiri, vitin e ardhshëm shkojnë në 63%. Kjo tregon se lehtësitë fiskale me të cilën po krenohet Qeveria nuk do të kenë asnjë efekt pozitiv për qytetarët dhe vendin së paku në vitin 2016.

Ndikimi i tyre do të vërejnë vetëm atëherë kur të rriten të hyrat buxhetore nga vjeljet e brendshme, ngase në kufi nuk po arrijnë apo nuk po duam ta kemi situatën nën kontroll të plotë.

Efekti pozitiv do të vërehet vetëm kur ka ulje të informalitetit, gjë që ka mundur të hetohet me krijimin e Komisionit Hetimor Parlamentar.

Të nderuar qytetarë,

Pa e luftuar krimin brenda për brenda pa e luftuar informalitetin dhe kontrabandën as që mund të pritët që paratë e taksapaguesve të shfrytëzohen për projekte që u mundësojnë atyre një jetë më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju kisha lutë qetësi, deputetë e nderuar për dialog e ke autorizimin e plotë veç a mundesh me na ndalë këtë gaz edhe sekretari Amerikan i Shtetit të cilin e falënderojmë shumë, ka dhënë mesazhe shumë të qarta por mirë është me kon me i ndalë edhe autorizim ke të plotë, veç arrina një dialog mes nesh.

Kush e dëshiron tjetërkush fjalën. Naiti për amendamente, Xhevahirja për amendamente, Sala për amendamente.

Nait a ke specifikisht për amendamente se ti je i opozitës e ke më lehtë, hajde vazhdo Nait.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Unë kam pyetje për buxhetin për ministrin e Financave, ministrin e Arsimit, ish kryeministrin, kanë premtuar një ligj për punëtorët e Arsimit vitet '90-'99. Është miratuar një vendim në Kuvend të Kosovës që ai Ligj dje ka ardhur në Qeveri dhe ata nuk e kanë prua në Kuvend dhe për vitin 2016 ju kem premtua që duhet ta miratojmë këtë ligj edhe nuk është në vija buxhetore, cila është arsyeja që nuk është në vija buxhetore ky projektligj.

E para, cila është arsyeja që as ministri i Financave as i Kulturës kur nga buxheti është zvogëluar buxheti për ministrinë dhe nuk e kanë ngritë këtë çështje, këto janë çështjet e mia. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Nait! A shkojmë në amendamente, Hajde Xhevahire edhe Salë, e kanë shkurt edhe po shkojmë drejtë në amendamente.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra, ministra,

Kolegë deputetë,

Gazetarë,

Pikërisht pse nuk është në amendament edhe pikërisht se është larguar në momentin e fundit unë sot do të paraqes reagimin tim si deputetë e vetme fatkeqësisht ish dashtë me qenë edhe Aida Dërguti këtu, por po flas në emër të komunës së Vushtrrisë që ka 100 mijë banorë. Projekti i urës së Lumit Sitnica në fshatin Pestovë ka qenë i paraparë edhe është larguar në momentin e fundit, realisht as komuna as unë nuk e kemi ditur domethënë. Në rregull, unë po flas për një kërkesë e cila është dorëzuar prej komunës dhe janë gjithsejtë tetë projekte kapitale, janë futur vetëm dy projekte. Pra është çudi se si në momentin e fundit është largua projekti për urën mbi lumin Sitnica që është projekt shumë i rëndësishëm për ata mijëra banorë. Faleminderit!

KRYETARI: Vazhdojmë me seancën. Ta kemi parasysh në mbledhje jemi 81 deputetë.

Në projektligjin për buxhetin kur kemi filluar kanë qenë 84, i kisha thirr kolegët që të le të vijnë, 81 janë aktualisht.

Projektligji për buxhetin e vitit 2016 janë propozuar gjithsejtë 62 amendamente. Për amendamentin numër 4 janë dhënë dy propozime, propozimi i Komisionit Funksional nën a dhe nën b. Propozimi i Komisionit për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Amendamenti numër 56, është propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri me përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti numër 58, është propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti numër 58, është propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti numër 60, është propozuar nga Grupi Parlamentar “6+”, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti numër 61, është propozuar nga deputeti Qerim Bajrami, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamenti numër 62, është propozuar nga deputetët Adem Salihaj, Milazim Haliti, Blerim Grainca, Synavere Rysha, Ali Sadriu dhe Danush Ademi, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Ne në rend të parë do të vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas një radhe të paraqitur në raport nga Komisioni Funksional. Unë si kryetar i Kuvendit do të ju kërkoj të gjitha amendamentet nga një, në qoftë se pajtohem, si nuk pajtohem deri në amendamentin 56, larguar amendamentin 4 me i votua përnjëherë. A jeni për.

Sa janë kundër, veç ta di? Mos me i votua të gjitha përnjëherë. Jo shkojmë një nga një, hiq mos e merrni fjalën shkojmë një nga. Ok-ej një nga një do të shkojmë. Dy jeni kundër po demokraci opozitën se kemi, vetëm gjashtë deputetë nuk di a kanë ardhur ende. I ftoj të vijë në seancë.

Shkojmë me votua me ngritje dore. Unë do të shkoj vetëm kundër kush është edhe abstenim, për mbetet e aprovuar.

Dy deputetë, të cilët ishin kundër këtij votimi në paketë, edhe Flora Brovina deputetja, vetëm t'ia dëgjojmë mendimin. Urdhëro, Bekim Haxhiu, e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër, Kabinet qeveritarë,

Të nderuar zëvendëskryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Kërkesa pse po kërkojmë votimin me bë një nga një është për amendamentin 20, 21 dhe 23 që këto mos të ndryshohen të jetë ashtu si ka qenë të propozuara në fillim me projektbuxhetin nga Qeveria, më pastaj Ministria e Shëndetësisë ka ndërhy. Në autonominë e Qendrës Klinike Universitare apo Shërbimi Klinik Spitalor Universitar dhe kanë ndërhy ka bërë shkelje ligjore, domethënë është në kundërshtim me ligjin. Nëse Qendra Klinike Universitare bënë vërejtje në këto ndërhyrje që ka bërë Ministria e Shëndetësisë pas kalimit të Ligjit në leximin e parë dhe është drejtpërdrejtë në kundërshtim me ligjin e aprovuar të shëndetësisë që e kemi aprovuar në Kuvend, atëherë mendoj që ky projektbuxhet do të shkoj në kontestim më tutje dhe unë nuk besoj që do të donte dikush nga ne këtu deputetë të pranishëm që jemi të interesuar ta votojmë projektbuxhetin e vendit. Dhe këtu propozoj që të jetë ashtu si ka qenë që të mos ketë një ndërhyrje.

Kemi këtu prezentë ish ministrin e Shëndetësisë zotin Agani, i cili ka punuar në Ligjin e kaluar të shëndetësisë dhe esenca ka qenë në një reformë përmes ligjit, një reformë e cila është dashtë të vazhdoj tutje duke shkuar nga decentralizimi dhe me këto 2-3 amendamente ministri i Shëndetësisë e ka qëllimin vetëm te projektet dhe jo te decentralizimi dhe zhvillimi i shëndetësisë kosovare. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, zonja Brovina e ka fjalën! Pastaj do të shkojmë në propozim prapë, një propozim në qoftë se pajtoheni, ju e vendosni me shumicë. Deputetët le të kthehen në seancë, kemi votim.

FLORA BROVINA: Faleminderit!

Këto vërejtje që i tha kolegu Haxhiu, realisht kanë qenë vërejtje që u thanë edhe ministrit në takimin që patëm drejtpërdrejtë në shqyrtimin e buxhetit për shëndetësi.

Prandaj, nenet e përmendura janë prezantuar shkëlqyeshëm edhe nga kolegu ynë nënkryetari i Komisionit për Shëndetësi, e që është edhe anëtar i Komisionit të Buxhetit.

Prandaj, ne nuk pajtohemi që këto amendamente të ekzistojnë, sepse e bëjnë jofunksional Ligjin për shëndetësi dhe nxjerrin probleme. Nuk kam diçka, prandaj propozova që secili të votojmë veç e veç.

KRYETARI: Më fal, zonja Brovina. A ka mundësi të specifikohemi për arsye se unë do ta ndajë, 20, 21 e 23, a ke tjetër amendament me nda.

FLORA BROVINA: Prej 20 deri 23.

KRYETARI: Po këta do t'i ndaj. Atëherë a ka dikush tjetër prej deputetëve para se të shkoj në votim. Urdhëro, zonja Besa Gaxherri ka vërejtje.

Vetëm zonja deputete veç specifiko vërejtjen që të përmbledhem.

BESA GAXHERRI: Kolegë të nderuar,

Ne vërtetë jemi në një gjendje të jashtëzakonshme, këtu jemi koalicioni qeverisës, kemi natyrisht përgjegjësi të jashtëzakonshme në situatë çfarë jemi dhe unë me keqardhje për disa kolegë të cilët e shfrytëzojnë edhe sot ditën me bë fushatë politike, unë konsideroj se është shumë herët edhe kemi shumë përgjegjësi. Ne jemi marrë vesh dhe kemi punua të gjitha partitë politike në Komision të Buxhetit dhe jemi marrë vesh dhe jemi dalë me këto amendamente. E atë të cilën e tha kolegja Brovina edhe ne si Komision i Buxhetit e kemi shqyrtuar ligjin edhe ligji e obligon Ministrinë e shëndetësisë me bë politika shëndetësore e obligon. Prandaj, ju kisha lutur të jemi më seriozë, të punojmë, t'i votojmë këto amendamente që i ka sjellë Komisioni bashkërisht me shumë përpjekje dhe punë dhe kështu që të dalim sot serioz përkundër problemeve të madha që i kemi. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë e kemi një situatë, 62 amendamente. Ne mund të shkojmë votimin e 62 amendamenteve në qoftë se ju jeni pajtua duke i larguar amendamentin 4, 20, 21, 23, 57, 58, 59, 60, 61, 62 si shkojmë një nga një. Shkojmë amendament për amendament. Unë pyes kush është kundër edhe aprovohet se janë 83 deputetë, ok-ej, edhe abstenim.

Amendamenti 1.

Kush është kundër?

Abstenim, kalon.

Amendamenti 2.

Kush është kundër?

Abstenim, kalon.

Amendamenti 3.
Kundër, abstenim? Kalon.

Amendamenti 4.
Janë dy propozime, Komisioni Funksional.
Kush është kundër? Administrata të lutem,
Abstenim? Kalon.

Është variacioni i dytë, Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e Komisionit Funksional, i njëjti amendament.
Kush është kundër? Qoni dorën për arsye se njëri prej tyre kalon. Jo, jo ai kalon po dy duhet, me marrë vota ai më shumë, është e rregullt të keni parasysh. për të njëjtën amendament dy votime janë. Kush është abstenim? Kush është për? Lista serbe, po shoh konfuzion a e keni përkthimin mirë. Atëherë amendamenti 4, kalon varianti i Komisionit Funksional.

Amendamenti 5.
Kush është kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 6.
Kush është kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 7.
Kush është kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 8.
Kush është kundër? Kundër është Labinota.
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 9.
Kush është kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 10.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 11.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 12.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 13.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 14.

Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 16.

Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 17.

Shaip Muja e ka një sqarim. Kërkoj falje, mos pritni kur të kalojmë.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që vërtetë jemi tu bë një miratim të një buxheti në kushte të jashtëzakonshme dhe arsyeshmërinë për me bindë edhe vetveten por edhe publikun që vërtetë jemi tu bë edhe amendamente të qëlluara. Unë e kam të paqartë një problem në pikën 2 të amendamentit 17, ku thuhet programi i shërbimit terciar shëndetësor të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës me kodin 701, numri i të punësuarve prej 3000 personave ndryshohet me numrin 3020, në kllapa thuhet asistent të rregullt të Fakultetit të Mjekësisë dhe specialistë të lëmive përkatëse dhe tre mjekë specialistë të alokrologjisë me imunologji.

Unë mendoj që me linja buxhetore është i përzierë pjesa edukative me pjesën e shërbimit shëndetësorë dhe nëse janë të përzier në këtë mënyrë ju kërkoj të mos miratojmë diçka sepse ne i kemi edhe 700 specialistë të cilët nuk janë duke u paguar dhe ata janë instaluar në sistemin shëndetësorë dhe të cilët jo që nuk stimulohen por as nuk përkrahen me programe të veçanta dhe në këtë mënyrë ne po i nxjerrim nga loja 700 specialistë të cilët nesër jo që kanë dëshirë të jenë pjesë përbërëse e sistemit të Kosovës, por do të shohin dhe të ikin nga Kosova.

Prandaj, në këtë pikë unë kërkoj sqarim, o të mbahen në linjën e edukimit shëndetësorë pjesa e specialistëve dhe pjesa e shërbimit shëndetësor të planifikimit për specialistët të futet në amendament për 700 persona të cilët nuk paguhen me paga dhe atëherë ne duhet të ju japim ne përgjegjësi. Prandaj, nuk është e mirë që të ngutemi, të bëjmë buxhetin sot pse jemi mbledhur këtu, më mirë është tri ditë me zgjatë, s'kemi asgjë urgjente por ta bëjmë tamam qysh duhet. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit FunkSIONAL e ka fjalën për sqarime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Nëse ndërhyjmë kështu jashtë asaj që ka vendos Komisioni për Buxhet dhe Financa do të kemi telashe, sepse Komisioni ka marrë parasysh gjithnjë kërkesat e ministrit të Shëndetësisë që konsideroj që është personi përgjegjës që e ngarkon funksioni për politikën brenda Ministrisë së Shëndetësisë.

Çështja ka të bëjë se ministri ka ardhur me një kërkesë prej 52 veta që ka kërkuar me i sistemua, por ne nuk kemi pasur mundësi me e rritë për shkak të marrëveshjes që u bë me Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe komi konsideruar që këta 17 asistentë të cilët faktikisht janë ose doktorë të shkencave të mjekësisë ose janë në prag të doktoraturës, këtyre ju mundësohet vetëm me bë punën në QKUK, përndryshe ata humbin licencën pas 5 viteve.

Dhe një investim që është bërë kaq i madh te kjo gjeneratë e doktorëve të shkencës së mjekësisë konsideroj që do të ishte gabim me i nxjerr se fjala është për grupin e fundit të asistentëve që duhet të futen në QKUK dhe atë pa buxhet sepse ata pagën e marrin në Fakultet ku japin mësim. Edhe nëse ministri e ka paraparë atëherë unë e shtroj pyetjen cili duhet të ndërhyjë në politikat e ministrit për çështje të punësimit brenda institucionit.

Unë kërkoj nga deputetë që me e aprovua ashtu siç e ka paraparë Komisioni për Buxhet dhe Financa.

KRYETARI: Shqip, urdhëro, po desha edhe unë të shtoj diçka.

SHAIP MUJA: Zoti Naser, siç shihet nuk e kupton shpërndarjen e linjave buxhetore të kategorive të punuarve në sistemin publik të Republikës së Kosovës. edukimi për njohuri të juaja dhe ministri është dashtë me dalë me thanë unë nuk jam kundër 17 asistentëve unë jam edhe për ata 52 të ... sepse ne jemi përgjegjës në politika që i kemi planifikua ata të bëhen pjesë e edukimit të Republikës së Kosovës duhet t'ia gjesht edhe mënyrën se si do t'i financosh. Ndërsa këta të cilët në pjesën e shërbimit shëndetësorë si specialistë që janë punësuar është dashur, unë kategorinë e shërbimit primarë, unë kategorinë e shërbimit sekondar, unë kategorinë e shërbimit terciar ose në kategori të veçantë. Prandaj, 700 persona sot kur shkon në QKUK i ke specialistë të cilët kur shkojnë unë edhe ti ata nuk marrin paga dhe quhen doktor dhe prej tyre kërkojmë shërbim shëndetësorë edhe cilësorë.

Prandaj, edhe për ata 52 është bërë gabim që nuk janë futë dhe unë kam të drejtë me thanë që 17 ministri i ka selektuar me të njohshëm. Po. Edhe kështu që nuk ju humb. Duhet të merret Ministria e Arsimit edhe Universiteti me pjesën universitare, po jo Ministria e Shëndetësisë me linjën buxhetore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Unë kisha dëshirua në qoftë se ka mundësi veçanërisht me ministrin e Shëndetësisë një bashkëbisedim. Para 4-5 dite i ka ardhur një grup i specializantëve të cilët e kanë një problem veçanërisht kategori po kategorizofshin B edhe C, ka disa prej tyre si punojnë 36 orë qenie njerëzore edhe nuk mund të shkojnë në shtëpi të vetë, 24 orë punojnë për specializim edhe pastaj 12 orë me vazhdua për me marrë pagën me jetua për familje.

Ta ketë parasysh unë do ta votoj sot për vete si deputet por menjëherë në fillim të janarit do të inicioj së bashku me një grup parlamentar pavarësisht partive politike që të bëhet zgjidhje këtyre specializantëve mos të trajtohen ... e tillë, thjesht. Ne po e vendosim amendamentin 17 në votim për këtë herë deri në rishikim të buxhetit.

Amendamenti 17.

Kush është kundër? 5 kundër, abstenim a ka, do ta votoj si në rishikim të parë, Arbeni edhe Fikrimi janë për abstenim. Unë do ta votoj në qershor edhe publikisht duhet me ministrin me ju gjat zgjidhje. Faleminderit! Kalon amendamenti 17.

Amendamenti 18.

Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 19.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 20.
Labinotë, urdhëro e para. Kush dëshiron tjetër fjalën pastaj? Shaipi, Ok-ej Bekimi foli.

LABINOTË DEMI: Faleminderit, për fjalën kryetar!
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, ministra,
Kolegë deputetë,
Vërejtjet e mia kanë të bëjnë konkretisht fillimisht po sqaroj me amendamentin numër 20, ndërkaq gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë marrë vërejtjet e tyre për disa amendamente, Amendamenti 20, 21, 22 dhe 23.

Këto vërejtje vinë prej SHSUK-së dhe janë të sqaruara shumë mirë. Ndërkaq konkretisht do të ndalem tek amendamenti 20, vërejtjet të cilat i kam bërë edhe në Komisionin për Buxhet dhe Financa kur e kemi punuar projektbuxhetin për çka janë të informuar gjithë kolegët dhe vota ime ka qenë kundër.

Sipas amendamentit 20, në organizatën buxhetore Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës me kod organizativ 220 bënë ndryshimet si në vijim. Nënprogrami i shërbimet rajonale të kujdesit dytësorë shëndetësor me kod 700, tabela 3.1, kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, shuma prej 9 milionë e 442 mijë e 223 euro ndryshohet në shumën prej 4 milionë e 112 mijë e 223 euro. Nënprogrami i shërbimeve terciare shëndetësore QKUK me kod 7001, tabela 3.1 kategoria ekonomike mallra dhe shërbime shuma prej 14 milionë e 796 mijë e 550 euro ndryshohet në shumën prej 5 milionë e 126 mijë e 562 euro.

Ndërkaq në organizatën buxhetore Ministria e Shëndetësisë me kod organizativ 206 bënë ndryshimet si në vijim.

Në programin me kod 088 Agjencia e financimit shëndetësor në tabelën 3.1 në nënprogramin me kod 719 shërbimet mbështetëse administrative logjistike kategoria ekonomike mallra dhe shërbime për vitin 2016 shuma prej 120 mijë euro ndryshohet në shumën prej 15 milionë e 119 mijë e 988 euro.

SHSUK kërkon që këto amendamente të mbeten siç kanë qenë domethënë në draftin e parë që ka prua Qeveria, ndërkaq ashtu siç kemi thanë edhe në Komision po e mbështesim edhe vendimet e SHSUK-së.

Të gjitha këto ndryshime në vija buxhetore bie ndesh me nenin 3, pika 1, pikë 15 të Ligjit për sigurime shëndetësore numër 04/L-249 ku Agjencia e Financimit Shëndetësor AFSH ka detyrë ekskluzive që në emër të shtetit të bëjë kontraktimin pra deri në Shërbimet shëndetësore dhe kjo është në kundërshtime me mandatin e saj që të merret me punë të tjera si:

Blerjen e barërave dhe materialit harxhues medicinal për institucione shëndetësore kujdesi dy dhe tretësor që janë nënmenaxhim të organizatës të pavarur buxhetore SHSUK, vetë ... investime

kapitale për institucione shëndetësore të cilat janë nën varësi të një organizate të pavarur buxhetore.

Agjencia e Financimit Shëndetësor nuk është funksional dhe nuk ka staf për përcjellje dhe implementim të programit të furnizimit me barëra dhe material harxhues të njësive përbërëse të SHSUK-së.

Për zbatim të kësaj kërkesë AFSH dhe Ministria e shëndetësisë nuk kanë afruar kurrfarë plani për implementim të furnizimit me barëra dhe material hargjues për vitin 2016.

Transaksionet financiare në mes të dy organizatave buxhetore janë të kundërligjshme me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin e buxhetit.

Ka qenë shqetësim i imi dhe i disa kolegëve deputetë që 15 milionë euro është një shumë e madhe për t'u mbikëqyrur nga AFSH-ja konkretisht Agjencia për Financimin Shëndetësorë nga se është një agjenci që përbëhet nga vetëm katër persona.

Qëllimi i yni dhe dëshirë e jona është që buxhetet të decentralizohen dhe të kihet parasysh, të përcillet menaxhimi i tyre dhe jo të kthehen përsëri në Ministrinë e Shëndetësisë dhe aq më tepër Ministria e shëndetësisë nuk e ka konsultuar as edhe një herë AFSH-në për ndryshimin e këtyre linjave buxhetore.

Andaj, kërkoj nga gjithë kolegët e grupit tim dhe gjithë kolegët e Parlamentit të Kosovës që jemi këtu prezentë që mos t'i kalojmë këto ndryshime nga se për mendimin tonë nuk i bëjnë nderë zhvillimit të mirëfilltë të shëndetësisë dhe janë në kundërshtim me Ligjin për sigurimet shëndetësore. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip, urdhëro! Vjosa të bëhet gati. E sqaroj, atëherë Shaip të lutem! Përmbledhi edhe dy amendamentet tjera, ku pate vërejtje.

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar. Unë do ta kisha plotësua kolegen nuk kemi ardhur në këtu me i bë nderë askujt po me mbrojt ligjin.

Në këto amendamente është duke u shkel ligji, dhe me këto amendamente po kërkohet me votën tonë ta tejkalojmë atë shkelje ligjore dhe ta marrim besimin e Kuvendit që nesër të kemi arsyeshmëri ligjore për shkelje që kemi bërë. Dhe prandaj e ngrita edhe neni 17 dhe më mirë kish dashtë ta sqaroj ish ministri i Shëndetësisë pse në çfarë mënyre ka ardhur shërbimi spitalor dhe linjat buxhetore

(Reagime nga salla)

KRYETARI: Vazhdo deputet, vazhdo!

SHAIP MUJA: Unë mund të ju pres sa të doni. Problemi është kesi soj, që nenet, amendamentet të cilat janë miratuar në Qeveri duhet të merret procedura ligjore e ndryshimit, pasi të merret ajo ligjore atëherë fillohet me ndërhyrjen financiare të linjës buxhetore që është edhe ministri i

Financave. Çdo kush që do ta sheh nga jashtë unë kisha pas dëshirë të ma demantoj nga aspekti profesional po jo emocional edhe militantë. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit!

Më lejoni vetëm të jap një sqarim, pasi ministri i Shëndetësisë nuk është këtu.

Ka qenë kërkesë e donatorëve dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë që kanë mbështetë vazhdimisht Ministrinë e Shëndetësisë që buxheti të kaloj në Ministrinë e Shëndetësisë, ndërkaq Shërbimi spitalor të jetë vetëm ofrues i shërbimeve sepse sipas tyre është konflikt i hapur i interesit nëse shërbimi spitalor i ofron shërbime dhe i blenë këto shërbime. Po është kërkesë e tyre që buxheti të mbetet në Ministri të Shëndetësisë deri sa nuk funksionalizohet plotësisht fondi për sigurime shëndetësore.

Është dashtë me bë një rishikim por e kemi shty kërkesën e tyre deri në buxhetin e vitit 2016. Faleminderit!

KRYETARI: Shaip, merre foltoren se po lodhesh! Shaipi veç po i mbron të drejtat!

SHAIP MUJA: Unë falënderoj zotin ministër, dhe falënderoj angazhimin e faktorit ndërkombëtar shumë që na ka ndihmuar. Mirëpo, ju po flitni çka po keni qejf, por nuk po tregoni çka po thotë faktori ndërkombëtar.

Faktori ndërkombëtar në organizatën botërore të shëndetësisë në vitin 2008 e ke me draft sugjerimin e shtimit të numrit të administratës me Ministrinë e shëndetësisë, e kem në udhëzim nga faktori ndërkombëtarë, Banka Botërore prezent Zyra në Kosovë që të decentralizohet forma e financimit të institucioneve.

Prandaj, ju nga decentralizimi i cili akumulohet edhe përgjegjësia, mos u nervozoni unë s'ju kam faj që nuk lexoni ju, unë i lexoj këto, se kur po them unë i kam thënë...

KRYETARI: Shaip, drejtoju Kuvendit, e jo individëve!

SHAIP MUJA: Unë mendoj që Qeveria po mundohet me centralizua çdo veprim në mënyrë jo ligjore duke marrë besimin e votës së deputetëve të Kuvendit të Republikës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 20.

Kush është kundër? Ju lutem deputetë, kundër kush është?

Ndërkohë kryetari i Komisionit po kërkon fjalën edhe një herë. Atëherë po e bëjmë edhe një përjashtim. Urdhëro, kryetar i Komisionit futemi në votim pas kryetarit të komisionit. Më vjen keq profesor.

NASER OSMANI: S'kisha dashur, kryetar, me ra në aso pozite që të ketë votime politike për buxhetin që thashë në fillim që Buxheti i Kosovës është buxhet i qytetarëve të Kosovës.

Deputetja që ka qenë anëtare e Komisionit që e lexoj një shkrim që e ka dërgua drejtori i QKUK-së konsideroj që ka këtu një gabim të vogël po një gabim domethënës se ai thirret në ligj po nuk thirret në amendamentin e caktuar. Amendamenti është neni 56 i Ligjit për shëndetësi parasheh autorizimet e agjencisë për negociim dhe kontraktim të listës së barërave dhe materialit harxhues medicinal.

Ne kemi ngritë një institucion në kohën e ministrit edhe ai institucion është në kuadër të Ministrisë së Shëndetësisë dhe jo të QKUK-së.

Ajo që thirret në marrëveshje që e përmendi edhe Shaipi kemi të bëjmë me këtë dokument të Bankës Botërore, të Ambasadës së Zvicrës, edhe të donatorit të Luksemburgu, është e nënshkruar dhe këta janë donatorët më të mëdhenj të barërave dhe këta kanë kërkuar që këto barëra me shkua nëpërmjet agjencisë, i cili është në kuadër të ministrisë.

Konsideroj që QKUK-ja duhet me u marrë me çështje të tjera jo me çështjen e ofertave të furnizimit por vetëm me çështje të shërbimeve dhe kjo është arsyeja pse është ngritë në kohën e ish ministrit të shëndetësisë ky institucion që duhet me e përkrahë.

Kompetencat me ligj janë atje ku i kemi qitë ne ... si Komision.

KRYETARI: Përfaqësuesi i Qeverisë, Shaip e ke qartësuar realisht krejt. Po veç shpesh. Zëvendëskryeministri e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli!

I nderuar kryeministër Mustafa,

Të nderuar kabinet qeveritarë,

Të nderuar deputetë,

Pasi që u hap kjo çështje për debat këtu vlerësoj se do të ishte me interes që votohet propozimi i Komisionit. Komisioni është..., prandaj i ftoj gjithë deputetët pa dallim partie me votua për propozimin e Komisionit apo dakordimin në Komision. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Jemi te amendamenti 20, kush është vetëm për për. Shkojmë se po shoh se ka për, vetëm për një herë. Kush është për? 79 prezentë janë në sall. Naim qoje dorën më mirë. Kush është kundër? Edhe abstenim sa janë?

8 vota për abstenim, 16 kundër dhe 48 për. Kalon.

Amendamenti 21.

Kush është kundër? Abstenim? Flora Brovina është kundër evidentoni edhe Labinotja. Kush është për abstenim? U Krye.

Amendamenti 22.

Kundër? Abstenim? 5 kundër, 3 abstenim. Kaloi.

Amendamenti 23.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 24.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 25.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 26.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 27.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 28.
Kundër? Abstenim? Kalon.

Amendamenti 29.
Kundër? Abstenim? Kaloi.
Në qoftë se keni vërejtje më ndalni në çdo sekondë.

Amendamenti 30.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 31.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 32.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 33.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 34.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 35.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 36.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 37.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 38.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 39.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 40.
Kundër? Abstenim? Kaloi.
Amendamenti 41.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 42.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 43.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 44.
Kundër? Abstenim? Kaloi. Domethënë të gjitha janë votime për.

Amendamenti 45.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 46.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 47.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 48.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 49.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 50.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 51.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 52.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 53.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 54.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 55.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 56.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 57.
Kundër? Abstenim? Kaloi.

Amendamenti 58.
Komisioni për Zhvillim Ekonomik Infrastrukturë, Tregti dhe Industri nuk e ka përkrahjen e Komisionit Funksional.

Urdhëro, kryetari i Komisionit, cili po e merrni më falë. Profesor, më fal. Propozimin tonë kur unë e qesë në votim ajo çka rekomandoni ju, për mos me krijua konfuzion.

MUHAMET MUSTAFA: Po tash nejse. Unë po propozoj që kjo çështje është një kërkesë mjaftë vëllimore, është adresua pjesërisht dhe nuk ka mundësi tash të bëjmë rikonfigurime. Unë propozoj që kjo eventualisht të rishikohet të shqyrtohet me rishikim të buxhetit dhe ne ta tërheqim këtë amendament. Faleminderit!

Gjithashtu edhe amendamenti 59, me qenë se jam këtu është adresua me amendamente e përparshme prandaj tërhiqe. Faleminderit!

KRYETARI: Urdhëro, Sala e ka fjalën. Mbajeni mend propozimin e profesorit, është tërheqje e dy amendamenteve 58 dhe 59.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar!
Unë jam shumë e vetëdijshme se ky buxhet nuk është buxhet i dëshirave po është buxhet i mundësive, si do qoftë ne në Komision Parlamentar si Komision i kemi bërë tri amendamente që nuk kanë gjet mbështetjen e Komisionit dy prej tyre. Njëri prej këtyre amendamenteve është edhe amendamenti në fjalë.

Si do qoftë le të vendos seanca, unë po dua me dhënë një arsyeshmëri pse duhet me u kthye shuma për projektin në fjalë.

Unë po dua me ja përkujtua zoti Osmani sipas kornizës afatmesme të shpenzimeve projekti për funksionalizimin e laboratorit të gjeologjisë është planifikua në faza të caktuara afatmesme nga viti 2013 deri në vitin 2017.

Ndërsa shuma e planifikuar në kornizën afatmesme për vitin 2016 për laborator ka qenë e planifikuar 1 milion e 200 mijë, dhe do të imëta.

Tash më lejoni të ju them se duhet të potencohet se shërbimi gjeologjik që nga tetori i vitit 2014 është anëtar i Shërbimit Gjeologjik Evropian dhe funksionalizimi i laboratorit gjeologjisë do të plotëson kushtin për konkurrim në projekte ndërkombëtare në institucionet relevante Shërbimi Gjeologjik Evropian. Kur dihet fakti se realizimi i projektit në fushën e gjeoshkenca nëpërmjet këtij Shërbimi Gjeologjik Evropian i financuar nga Komisioni Evropian kap shumë e mjetëve financiare mbi një miliardë e 500 mijë euro.

Vetëm si i tillë laborator i Shërbimit Gjeologjik i Kosovës mund të ofroj rezultate të besueshme të pranueshme për institucionet vendore dhe ndërkombëtare në qoftë se funksionalizohet.

Më lejoni ta them edhe një fakt tjetër.

Të nderuar deputetë,

Unë po e marrë parasysh edhe orientimin e votës tuaj por unë e kam një pyetje këtu para jush. A dëshirojmë që institucionet tona që i kemi themelua me ligj agjencitë që në kuadër të qeverive dhe agjencitë e pavarura të kenë funksionalizim dhe a dëshirojmë që qe 16 vite e tash të ndërprejmë pagesën e qirave marramendëse të institucioneve në objektet që nuk kanë leje ndërtimi dhe në qoftë se dëshirojmë sot kërkoj votën e juaj për këtë projekt sepse ky projekt reflekton jo vetëm në shërbimin gjeologjik por edhe në institucione tjera të Qeverisë së Kosovës.

Më lejoni t'i numëroj:

Agjencia Kadastrale e Kosovës, funksionon në kushte të pafavorshme në Arkivin e Kosovës,

Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës i ka hapësirat e punës në kontejnerë.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale funksionon në një objekt ndërtimi pa leje që paguan më shumë se 100 mijë euro vjet në qira.

Shërbimi Gjeologjik i Kosovës është në objektet e papërshtatshme të objektet e "Ibër-Lepencit" dhe institucione tjera të cilat reflektojnë direkt në kthimin e shumës e cila është paraparë në kornizën afatmesme të këtij projekti.

Unë jam për me votua amendamentin nga Komisioni Parlamentar, ju mbetet juve të vendosni. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit funksional e jepi një qëndrim, amendamenti 58 dhe 59 për tërheqje është. A po doni me i shti në votim tërheqjen.

(Reagime nga salla)

Mos dëshiron të votojë dikush pos Salës, edhe për mjekësi edhe për laborator, pak si shumë, Shaip. Urdhëro, Shaip!

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, faleminderit!

Në mandatin e kaluar me që më the për laborator unë kam qenë në këtë Komision kur kemi miratuar këtë laborator. Prandaj, Komisioni nuk e njeh fushëveprimin e këtij laboratorit dhe të agjencisë, që është dashur ministri i Zhvillimit Ekonomik ta mbrojë.

Ndërsa është shumë shqetësuese nëse vërejtje epet sot edhe nga konsumatori edhe nga shoqëria civile edhe nga prodhuesit që neni 59 për standarde që nuk arrihen në shumë pika edhe për cilësinë për 17 mijë e 600 euro të eliminohet, unë ju ftoj deputetëve të ja japim nga 100 euro ministres ja bëjmë qatë buxhet edhe le t'i lëshon certifikatat e standardet.

KRYETARI: Faleminderit, Shaip!

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL ka propozuar mi heq 58 dhe 59. Në qoftë se shumica janë kundër propozimit të tij të deklarohen po janë tërheq, 58 e 59 u tërhoqën.

Amendamenti 60.

Grupi Parlamentar “6+”? E tërheq edhe Grupi “6+”.

Amendamenti 61.

Deputeti Qerim Bajrami, e ka një amendament pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Urdhëro, i nderuar deputet!

QERIM BAJRAMI: I nderuar deputet, zoti Fadil Demaku, kam thënë tërhiqe, por unë kur s'e tërheq. Po më çudit që luftëtari po thotë tërhiqe, luftëtarët nuk tërhiqen.

Poštovani poslanici,

Primetio sam da u glavnom svi razumete naš jezik, izvinjavam sa onima koji ne razumeju.

Imam jedan amandman, molimo za malo pažnje,

KRYETARI: Ju lutem qetësi, ta përfundojë deputeti!

ĆERIM BAJRAMI: Dakle predložio sam amandman za izdvajanje sredstava iz roba i usluga Univerziteta u Prištini ja javni univerzitet u Prizrenu, dakle u plate.

Upoznao sam poštovane naše poslanike u Komisiji za budžet i finansije, zahvalna sam i na razumevanju. Takođe sa ovim mojom predlogom upoznati ministar Hoti, dakle ne radi se o dodatnim sredstvima, nego se radi o prebacivanju iz jedne ustanove u drugu i unutar Ministarstva obrazovanja Republike Kosova.

Ovo je jako bitno za Bošnjačku zajednicu na Kosovu, jer se radi o otvaraju jednog novog smjera na Ekonomskom fakultetu u Prizrenu koji ove školske godine ove licenske godine nije godine otvoren zbog nedostatka sredstava.

Nažalost rektorat iz Prizrena nije predvideo bezobzira na obećanje da će uvrstiti ovu stavku u budžet za 2016, opet je ostavio broj za posedni isti što znači da ne planira zapošljavanje 4-5 novih angažiranih profesora za taj smer. To je propust oni su prihvatili da su to prepustili i zatražili su od nas da intervenišemo na ovaj način.

Takođe ovde je prisutan i ministar obrazovanja doktor Arsim Bajrami, on je takođe upoznat sa ovim.

Ja od vas tražim da izglasate ovo odvajanje sredstava i da prihvatite ovaj moj amandman radi se o 70 hiljada evra, nisu dodatna sredstva i sa ovim činom će te .. jednu poruku naših budućih studentima da ova Vlada i ova država misli na njih jer ove godine kao što svi znate imali smo veliki problema oko upisa naših studenta u Prištini, ovde upisano je samo 8 ili 9 studenta od 90 rezervisanih mjesta.

Molimo vas podržite ovaj amandman a na vašoj savesti kako ćete ovdje uraditi. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar deputet!
Ministri i Arsimit, dëshiron fjalën.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit, kryetar!

Bashkë me ministrin e Financave kemi diskutuar këtë amendament dhe në parim jemi pajtua që këtë amendament ta përkrahim dhe ta votojmë në rishikim të buxhetit, përse në rishikim. Sepse në ndërkohë programi që është propozua duhet të akreditohet dhe ne përpara duhet të shohim që a do të akreditohet ky program te Agjencia për Akreditim dhe nëse akreditohet kemi kohë të mjaftueshme sepse rishikimi do të bëhet në muajin qershor apo korrik dhe kemi kohë të mjaftueshme për ta aprovuar në rishikim dhe për të filluar nga 1 tetori ta zbatojmë.

Kështu që në parim e kemi përkrahë me ministrin e Financave po tash nuk mundemi me çrregulluar buxhetin sepse kjo do të kërkon çrregullime tjera dhe do ta diskutojmë me siguri me rastin e rishikimit.

KRYETARI: Faleminderit!

Amendamenti 61.

E dëgjuat edhe deputetin e nderuar edhe përfaqësuesin e Qeverisë.

Kush është për amendamentin 61 të Qerim Bajramit. Kush është për? Ju lutem kush është për? Kush është abstenim? 3 deputetë abstenojnë. Kush është kundër amendamentit të deputetit Qerim Bajrami.

Edhe një herë duhet të shkojmë në votim, 58 deputetë vetëm kanë votua, duhet me kalua 61, nuk konsiderohet.

Deputeti Qerim Bajrami e ka bërë një propozim. Kush për propozimin e deputetit Qerim Bajrami si amendament. Kush është për edhe një herë votoni për, pa përkrahjen e Komisionit, non stop jemi duke thënë pa përkrahjen e Komisionit funksional. Kush është për. Bekim ja qojë dorën ja ule. Kush është për abstenim, 5 abstenime. Kush është kundër amendamentit të deputetit Qerim Bajrami. Me keqardhje amendamenti i deputetit Qerim Bajrami nuk kalon.

37 janë kundër, 5 janë abstenim, 32 për. Po luftë e fort!. Nuk kalon.

Amendamenti 62.

Deputetët Adem Salihaj, Milazim Haliti, Blerim Grainca, Synavere Rysha, u tërhoq. Ok-ej!

A ka dikush ndonjë shqetësim nga këto votime të amendamentit se po shkojmë drejtë në votim të ligjit në tërësi? Nuk ka.

Votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Ta konstatojmë sa i kemi prezent në sall. 81 deputetë prezentë në sall.

Lus deputetët që të deklarohen me ngritje dore, kush është për Projektligjin për buxhet në tërësi? Kush është kundër buxhetit? Abstenim a ka?

Me 78 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim. Konstatoj se Kuvendi miratoi Ligjin për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2016.

(Duartrokitje)

Jemi në pikën e pestë të rendit të ditës.

E kisha kërkuar kryetarët e grupeve parlamentare na duhen 2/3 e votave, të paktën 80 deputetë.

5. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për projektin e rehabilitimit të rrugës hekurudhore numër 10

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ai ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Urdhëro, fjala është për ju. Ndërkohë deputetët e opozitës nuk janë duke ardhur të cilëve ju lejohet pjesëmarrja në seancë të kemi parasysh.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i nderuar!

Kryeministër,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritarë,

Programi i Qeverisë së Kosovës 2015-2018 synon që nëpërmjet bankave zhvillimore të financojë rehabilitimin e linjës 10 të hekurudhës që mundëson transport më të lirë për qytetarët dhe mallrat.

Duke marrë parasysh këtë orientim Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe BEZH-it për realizimin projektin hekurudhore linjës 10 nga kufiri me Serbinë deri në kufi me Maqedoninë kontribuon në realizimin e këtyre qëllimeve.

Ministria e Financave ka zhvillua negociata me kreditorë dhe donatorë të ndryshëm për gjetjen e fondeve për financimin e projektit i cili parashihej kushtoj 195.5 milionë euro përfshirë këtu edhe TVSH-në që është kontribut i Qeverisë.

Një prej burimeve të financimit është edhe marrëveshja financiare për kredi që kemi nënshkrua me Bankën Evropiane për rindërtim dhe zhvillim e cila në këtë projekt do të marrë pjesë me 39,9 milionë euro, çështje e cila trajtohet me këtë projektligj.

Kushtet e kredisë janë mjaft të favorshëm me një afat prej katër vjetësh, me 11 vjet amortizim, me 22 këste gjysmëvjeçare. Norma e interesit është mjaftë e volitshme me 1% plus, EURI BORI gjashtë mujor dhe unë ju ftoj që të apromoni këtë projektligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, ministër i nderuar!

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, zoti Naser Osmani, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka shqyrtuar në prioritet draft-ligjin që ka të bëjë me ratifikimin e marrëveshjeve sidomos të atyre huave që janë me lehtësira edhe njëkohësisht i ka rekomandua deputetëve që me i përkrahë. Duke pasur parasysh që nevojiten 2/3 e votave.

Komisioni një zëri i ka përkrahë dhe i rekomandon për votim. Faleminderit!

KRYETARI: Tani në qoftë se dëshirojnë e kanë radhën kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

A ka ndonjë nga përfaqësuesit PDK-ja, LDK-ja, Vetëvendosja, AAK-ja, Lista Serbe, Nisma dhe “6+”. Ok-ej! Ndonjë deputetë, nuk ka. Përfaqësuesi i Qeverisë e ka thënë.

Unë do të jap vetëm edhe këshillat juridike, të cilat kanë të bëjnë me vendimmarrjen. Në bazë të nenit 18 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Kuvendi i Republikës së Kosovës me votat e 2/3 të të gjithë deputetëve ratifikon marrëveshjen ndërkombëtare.

Pra, ratifikimi i marrëveshjes kërkon së paku 80 vota për. Ndërsa në bazë të rregullores së Kuvendit, neni 60, paragrafi 3, procedimi i Projektligjit për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare është i veçantë dhe i shqyrtohet vetëm një shqyrtimi.

70 deputetë janë në sallë, veç kot po lexoj.

Të nderuar deputetë,

Para se të vazhdoj me votimin e projektligjit, e konstatoj se 70 deputetë. Vazhdojmë me pikat tjera, pastaj votojmë të gjitha në grup.

6. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2014 për projektin e Huas

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ministri i Financave, zoti Abdullah Hoti, e ka fjalën që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar i nderuar!

Republika e Kosovës që nga viti '99 deri në vitin 2013 ka realizuar projekte të ndryshme me Qeverinë gjermane në bazë të marrëveshjeve të pranuar që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.

Nga viti 2014, ne kemi pasur kërkesë që bashkëpunimi nga 2014 e tutje të mos bëhet në bazë të marrëveshjeve paraprake.

Prandaj, kemi negociua këtë marrëveshje të re, e cila i ka kaluar të gjithë hapat ligjorë.

Ky projektligj përfshinë kredi me... pra Bankën Gjermane për Zhvillim për projektin, mbështetja e sektorit të energjisë shtatë, përmirësimi i rrjetit përçues... me kushte të favorshme në vlerë prej rreth 12 milionë euro.

Kjo shumë do të... te KOST-i dhe është pjesë e planit investiv të kompanisë të dakorduar me KOST-in dhe Bankën Gjermane për Zhvillim.

Marrëveshja e ratifikuar mundëson që KOST-i për herë të parë të marrë kredi duke u garantua prej Qeverisë Gjermane. Ky është rasti i parë kur Qeveria Gjermane garanton një kredi të tillë për ndonjë entitet jo publikë në Kosovë.

Pas ratifikimit të kësaj marrëveshjeje nga Kuvendi mund të lidhë marrëveshje financiare për projektin e lartcekur, i cili është me kushte mjaft të volitshme të kredisë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Deputeti Naser Osmani, nga Komisioni Funkcional për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Ratifikimi i Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Federale të Gjermanisë për projektin për bashkëpunim financiar 2014, projekti i Huas, është një projekt që është përkrahë edhe nga Komisioni për Buxhet dhe Financa.

Sa i përket kostos buxhetore, kredi që do të merren nuk do të ketë ndikim drejtpërdrejtë në buxhetin e Republikës së Kosovës, pasi që huamarrja merret nga operatori i sistemit të transmetimit dhe tregut për .. dhe me këtë rast Ministria e Financave paraqitet vetëm si nën-huazues i kësaj kredie.

Komisioni për buxhet dhe financa, në mbledhjen e mbajtur më 24. 11. 2015, e ka shqyrtuar projektligjin në fjalë dhe i ka rekomanduar Kuvendit që të aprovohet në procedurën e paraprakë me 2/3 e votave. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Para se me marrë fjalën kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Kisha pasur dëshirë që të kemi kuorum për arsye se nuk i kemi 80 vota.

2. Mund të krijojë edhe pakënaqësi kjo mënyrë e zgjedhjes të cilën Kryesia e Kuvendit po e bënë për të evituar situata të pakëndshme por ajo çfarë po mundohem të gjithë mos me krijua skena tërheqjes .. të kolegëve tanë deputetë, pushtetin edhe forcën e shtetit çdo kush mundet me përdorë lehtë, me i fut disa policë për t'i tërhequr zvarrë kolegët deputetë, unë nuk besoj se është aq dinjitoze as për mua si kryetar i Kuvendit as për Kryesi as për juve me vazhdua në sall me ndijë kënaqësinë tonë në sallën kryesore. Ta keni parasysh, po ju jeni kolegë deputetë, në fund të fundit me vendimmarrje është edhe të deputetëve e bëni po një herë për njëherë unë si kryetar i Kuvendit nuk i fus forcat e kujdestarisë së policisë me i tërheq .. edhe nuk ja sugjeroj askujt. As kjo kryesi deri tani, as kryetarët e grupeve parlamentare se kanë parapa asnjë moment që ta bëjnë një gjë të tillë. Vetëm këtë situatë me pas parasysh, pse është pak edhe për publikun më shumë se një pjesë e madhe e kolegëve e dinë por pi shoh çdo herë po ka reagime të tilla të cilat nuk janë shumë dinjitoze.

Deputetë, mirë do të ishte të jenë 80 për arsye se vendimmarrjen, në qoftë se përfaqësuesit e grupeve parlamentare prapë nuk e marrin fjalën qysh po e shoh mos t'i lexoj këshillat juridike janë të njëjtat po ato të mëhershmet. Pa i pas 80 deputetë nuk mund të vazhdojmë me votim.

KRYETARI: Pika pesë dhe gjatë janë vetëm në fazën e votimit. Kur të bëhen në mbledhje plenare 80 deputetë atëherë e fusim në votim.

7. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes së kredisë Kosovë - Unicredit Bank Austria AG për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës

Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin i Financave, zotin Abdullah Hoti, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

(Reagime nga salla)

Kështu ma kanë shkruar. Arban, urdhëro kërkoj falje. Ministri Arban Abrashi e ka fjalën.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryetar!

Kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë të Parlamentit të republikës së Kosovës,

Bazuar në marrëveshjen në mes të qeverisë së Kosovës dhe Bankës Qendrore të Austrisë. Qeveria e Kosovës ka përfituar kredi të butë në lartësi prej 20 milionë euro nga të cilat 4.6 milionë janë të dedikuara për shëndetësi.

Pjesë e kredisë së butë e dedikuar për shëndetësi është planifikuar të shkoj në funksion të përmirësimit të kapaciteteve diagnostifikuese të shërbimit spitalor.

Për fazën e parë të këtij projekti prej 2.6 milionë euro është përzgjedhur shërbimi i kardiologjisë invazive në QKUK. Kapacitetet e suficikuara diagnostiko të këtij shërbimi janë parakusht

themelor për zhvillimin e kardiologjisë intervante dhe posaçërisht janë parakusht edhe për zhvillimin e mëtejshëm të shërbimit të kardiokirurgjisë.

Gama e pajisjeve në projektin, modernizimit të shërbimit të kardiologjisë invazive në QKUK, përbëhet nga Angio CT, Ballompompa introaustike, ultrazëri për kardiologji 3D, ultra zë staciopum i jashtëm, aparat ekstra korporal për kardiokirurgji, te sistemi i monitorimi për kujdesin intensiv, pejsmiker i jashtëm, echoge për monitorim 24-orësh dhe ultrazëri i krahasorit i gjirit.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha pajisjet kanë kontrata që ofrojnë garanci 24 muaj, përfshirë këtu edhe servisimin dhe trajnimin e personelit mjekësorë të shërbimeve përkatëse.

Ndërsa mentalitetet e realizimit të kësaj kontrate janë harmonizuar në mes të ministrisë së financave dhe Bankës së Austrisë.

Të nderuar deputetë,

Këtë vit Ministria e shëndetësisë ka arritur të funksionalizojë shërbimin e kardiokirurgjisë dhe për dy muaj në këtë shërbim janë realizuar mbi 30 ndërhyrje në zemër të hapur. Pra ky projekt dhe këto pajisje përveç që kontribuojnë në ngritjen e spektrit dhe të cilësisë së shërbimeve në kardiologjinë invazive janë edhe parakusht themelor për qëndrueshmërinë e kardiokirurgjisë.

Ky projekt paraqet vazhdimësinë e angazhimeve të Ministrisë së Shëndetësisë në ndërtimin e kapaciteteve vetanake për të gjitha shërbimet specifike përfshirë këtu edhe ato të kardiologjisë.

Duke i zhvilluar kapacitetet infrastrukturore diagnostifikuese dhe resurseve humane Ministria e Shëndetësisë .. t'i realizoj gradualisht deri në 300 ndërhyrje në zemër të hapur brenda QKUK-së duke rritur kështu, të kursej fonde të cilat tani shkojnë në zgjedhjen e këtyre rasteve jashtë institucioneve publike shëndetësore.

Të nderuar deputetë,

Duke pasur në konsideratë rëndësinë jetë shpëtuese të këtyre pajisjeve dhe të këtij projekti ju ftoj të përkrahni ratifikimin e kësaj marrëveshje. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes plenare e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Zoti Osmani, e ka fjalën, kryetari i Komisionit Funkcional.

NASER OSMANI: Faleminderit, nënkryetar!

Ratifikimi i Marrëveshjes së kredisë të nënshkruar në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Unicredit Bank Austria për financimin e Projektit të modernizimit të shërbimeve të kardiologjisë invazive në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës i mundëson Qeverisë së Republikës së Kosovës të marrë kredi në shumë prej 2 milionë e 600 mijë.

Ministria e financave në opinionin e ndikimit buxhetor vlerëson për financimin e projektit që në Ligjin e buxhetit 2015 janë aprovuar 2 milionë e 600 mijë euro në kategorinë ekonomike të shpenzimit kapital.

Në rastin e moszbatimit të kësaj marrëveshje në vitin 2015, Ministria e Shëndetësisë obligohet që me ndarjet buxhetore të aprovuara për vitin 2016 të siguroj mjete të domosdoshme për përmbushjen e obligimit që dalin nga ky projektligj.

Me fjalë të tjera pas aprovimit të këtij ratifikimi do të bëhet pajisja në shumë e caktuar menjëherë në këtë vit.

Prandaj, Komisioni duke pasur parasysh që spitali të pajiset me këto pajisje të domosdoshme kardiologjike i ka rekomanduar me datën 8. 12. 2015 kur e ka mbajtur edhe mbledhjen që deputetët të aprovojnë ratifikimin e marrëveshjes për këtë qëllim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, Grupi Parlamentar i PDK-së, kush e merr fjalën. Nuk ka. T'i ke si deputet apo si.. n rregull. Grupi Parlamentar i LDK-së, nuk ka. Vetëvendosje nuk është, AAK nuk është. Lista Serbe e dëshironi fjalën. Jo! Grupi Parlamentar "Nisma", nuk është. "6+" nuk është. Deputetët sipas radhës së paraqitur, Zoti deputetë merr fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit!

Faleminderit, i nderuar nënkryetar!

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra, Kabinet qeveritarë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Krahasuar me dy marrëveshjet paraprake të prezantuara nga ministri i Financave dhe marrëveshja tani e afruar në këtë pikë të rendit të ditës ka dallim esencial në përmbajtje.

Për arsye se marrëveshja do jetë në fuqi për marrëveshjet paraprake pas miratimit tonë.

Për marrëveshjen për të cilën po diskutojmë këtu janë kryer edhe procedurat e tenderimit. Do të thotë janë përzgjedhur kompani e cila ka me pajis këto spitale me këto aparatura që ka planifikuar ministri i Shëndetësisë.

Kam pasur dëshirën që këtë debat për këtë temë ta bëjë me ministrin e Shëndetësisë, për arsye se në Projektbuxhetin e vitit 2015 në kodin buxhetor 14121 për kardiokirurgjinë kur ka qenë e planifikuar salla ... në vlerën 2 milionë e 600 mijë euro në vitin 2015 dhe 2 milionë euro në vitin 2016 që ajo të funksionalizohet salla hibride t'u pasur parasysh njohurit e ekspertëve të fushës është fjala e fundit e teknologjisë dhe modernizimit dhe atë sallë hibride e kanë pak shtete në rajon edhe në Evropë dhe hoqa dorë nga Salla ibride dhe orientimi tani në emër të modernizimit të një shërbimi të kardiologjisë invazive të një sektori të caktuar dhe dërgimi i atyre mjeteve të planifikuara në suficit dhe kërkesa tani që të hyjmë në kredi pa implementohet një projekt tjetër nuk do tjetër veç një papërgjegjësi dhe largim të donatorëve në këtë formë të menaxhimit të Ministrisë së Shëndetësisë.

Tu e analizua këtë situatë kam pasur në mendje që t'ia kërkoj dorëheqjen ministrit të Shëndetësisë, po pasi ai nuk është këtu kërkoj që nga kryeministri Isa Mustafa që menjëherë ta shkarkoj për shkak të papërgjegjësisë të tij, për shkak që na ka krijuar një mundësi ka bërë një shkelje të rëndë, paratë e buxhetit të Kosovës i ka dërguar në suficit, ndërsa po kërkon të na fusë në kredi. Kjo nuk lejohet... për të zgjedhur as familjarë, e lëre më në menaxhimin shtetëror të Ministrisë së Shëndetësisë. Nevoja dhe kërkesat e pacientëve duke e pasur parasysh respektimin dhe vullnetin e donatorëve në veçanti të Qeverisë së Austrisë që ta ndihmojë këtë sektor kërkesa e tyre ka qenë dhe këto para kanë qenë të planifikuara për prioritetet, për prioritetet e Ministrisë së Shëndetësisë.

Unë besoj që vërtetë pas një viti pune në Ministrinë e Shëndetësisë, ministri Imet Rrahmani ende s'e ka kuptuar cilat janë prioritetet atje. Unë nuk besoj që në një shërbim të cilin ia kanë ofruar donatorët që këtë angiografi ky që po donë me e ble 2 milionë e 600 mijë euro, të tjerët ia kanë ofruar pa pagesë por nuk e ka pranuar.

Një kontratë e një tenderi të cilin e ka zhvilluar 2 milionë e 100 mijë euro, ndërsa neve na ka pruar 2 milionë e 600 mijë euro të votojmë. Një tender i cili zoti kryetar i komisionit që besoj e keni parë dokumentacionin, tenderi ka qenë 2 milionë e 100 mijë euro, ndërsa ju na keni prurë marrëveshje 2 milionë e 600 mijë euro, më intereson të di nëse pajisjet janë 2 milionë e 100 mijë euro ku shkojnë 500 mijë euro tjera?!

Për çka edhe 500 mijë euro tjera?! Prandaj, shkarkimi i ministrit Imet Rrahmani është domosdoshmëri. Faleminderit!

KRYESUESI: Veç një sekondë, zonja Brovina e ka fjalën!

FLORA BROVINA: Pata rastin që gjithnjë të flas pas kolegut tim dhe ky i tha gjërat thelbore, megjithatë dua të them se Komisioni për Shëndetësi ka vizituar repartin e Kirurgjisë Invazive kardiokirurgjisë, gjithashtu si komision e kemi vizituar të njëjtat reparte edhe në shtetet e regjionit, në Shqipëri, në Malin e Zi dhe e dimë se si u pajisën ato.

Një ndër kushtet që më të mirat i ka është pikërisht kardiokirurgjia në Kosovë, por mos funksionalizimi i aparaturës ekzistuese dhe mungesa e kuadrit, sidomos stimulimi i kuadrit të përgatitur dhe të ardhur vullnetarisht këtu, ose përgatitja e kuadrit të ri kjo është mungesa e kardiokirurgjisë. Gjithashtu, mendoj se kjo kredi qoftë edhe e butë nuk ka qenë shumë transparente dhe megjithëse kemi kërkuar dokumentacionin edhe në Ministrinë e Shëndetësisë edhe të Financave personalisht nuk jam e sigurt se për çka u dha kjo kredi. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI IMET RRAHAMANI: Më lejoni vetëm të sqaroj një gjë, Qeveria e Kosovës e ka të nënshkruar një marrëveshje me Qeverinë e Austrisë para 4-5 vjetëve për të shfrytëzuar një kredi eksportuese. Kredia eksportuese nënkupton që Qeveria e Austrisë i krediton firmat austriake për t'i ndihmuar Qeverisë së Kosovës.

Deri tash 20 milionë është marrëveshja deri tash kemi shfrytëzuar 4,7 milionë në arsim, kjo është marrëveshja e dytë që po sjellim në Kuvend, nuk shpall tender Qeveria e Kosovës. Nuk ka më transparente, sepse Qeveria e Austrisë vetë i ka kontraktuar firmat vendore për t'i sjellë këto pajisje në Kosovë, vlera e këtyre pajisjeve do të jetë 2,1 milionë euro, ne kemi marrëveshjen për 2,6 milionë. Ne paguajmë e kthejmë këtë kredi aq sa i marrim ato mjete, prandaj do të kthejmë 2,1 milionë. Do të bëhet një proces i verifikimit i sa mjeteve po vijnë dhe sa po shpenzojmë, për këtë mos keni merak, për hir të informimit të drejtë nuk kemi shpall tender, nuk janë kryer procedurat e tenderimit dhe ne po e sjellim para juve, është Qeveria austriake që i kontraktton firmat austriake për t'i sjell këto pajisje në Kosovë. Ndërsa, për informimin juaj kjo kredi është me 0% normë interesi, ne paguajmë një shumë të vogël vetëm për menaxhimin e mjeteve.

Janë faktikisht mjete falas me 273 mijë euro në vit që paguajmë për 11 vjet sa është amortizimi i kredisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Replikë kanë të dy diskutuesit e parë, zonja Brovina.

FLORA BROVINA: nuk janë kushtet dhe rrethanat që të bisedojmë shumë gjatë, por fjala është për buxhetin, pikërisht shembulli i kardiokirurgjisë në Malin e Zi është një shembull nga i cili do të mësoni, sepse atje kjo pajisje është falur nga TIK-a dhe ne këto nuk i kemi shfrytëzuar.

Pra, nuk është hua, por është falje. Edhe plus përgatitja e kuadrit për këtë repart.

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Haxhiu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Nuk desha që të replikoj me ministrin e Financave, për arsye se miratimi i kësaj kredia në Qeveri edhe me pajtimin e ministrit të Financave do të thotë bën një shkelje edhe nga ana e tij, ne e dimë që këto projekte i udhëheq dhe janë udhëhequr në Austri, por është e pakuptueshme dhe jo në rregull që për çështje të cilat kanë përfunduar tenderimet të vijnë marrëveshjet këtu e tha që është një kredi me interes dhe e di që edhe atëherë kur është aprovuar kjo formë e kredisë ka qenë për prioritetet dhe jo për interesat e asnjërit prej kujtdo qoftë prej ministrave, prandaj e kërkoja këtë, nëse është me 0% interes atëherë vërtetë është për tu diskutuar 2 milionë e 100 me 2 milionë e 600 është për tu diskutuar nëse është e vërtetë me këtë shumë dhe e potencoj edhe njëherë, për shërbimin e kardiologjisë invazive donatorët kanë ofruar këtë angiograf pa pagesë nëse edhe furnizimet do ta bëjnë me çmimin të cilin e ka bërë të pajisjeve tjera për nevojat e kardiologjisë invazive me çmimin aktual që furnizohet Ministria e Shëndetësisë dhe këtë angiograf e kanë ofruar pa pagesë.

Dhe, ne tani duam të paguajmë kredi, shqetësimi im, i nderuar ministër, që një kërkesë e tillë ka qenë edhe vitin e kaluar në edhe në kuadër të Qeverisë së kaluar por nuk e ka marr pëlqimin e Ministrisë së Financave... dhe ne kemi pasur buxhetin për këtë projekt. E kemi pas buxhetin 2 milionë e 600 mijë euro i kemi qar në suficit dhe tani po duam të hyjmë në kredit, kjo edhe në aspektin e ... të Ministrisë së Financave nuk do koment. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka kërkuar fjalën. Përgatitet zoti Muja.

MUHAMET MUSTAFA: Unë mendoj se ky është një nga projektet më të mira, ne duhet të investojmë në kardiokirurgji sepse kemi derdhje enorme të mjeteve për trajtimin e këtyre sëmundjeve.

Nën 2, këto çka po i dëgjoj këtu sot i kam lexuar në një artikull e si duket pas sqarimeve që i tha ministri i Financave nuk janë të bazuara as artikulli e as këto tjerat. Mirë është që është 2 milionë e 100 mijë e nuk është 2 milionë e 600 se kursehen 500 mijë, kështu që mendoj që duhet të merremi me çështje...

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Muja e keni fjalën.

SHAIPI MUJA: Faleminderit, zoti kryesues!

Unë nuk ia kisha kërkuar dorëheqjen ministrit siç tha kolegu im Bekim, se është traumatizuar shoqëria dorëheqje Qeveria, dorëheqja po abstenon gjithë. Unë kisha propozuar diçka konkrete meqenëse nuk kemi kurrë urgjencë Komisioni për Shëndetësi nuk ia aprovon të krijohet një komision i cili do t'i numëroj me emra me zëra që thonë këta ekonomistët, vlerësimin e tenderit dhe nuk ka asgjë të përzier me Qeverinë e Austrisë, sepse është pjesëmarrëse edhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Prandaj, mos i komplikoni gjërat publikisht nuk kemi nevojë t'i bëjmë, ta ndërpremë si seancë dhe të kalojmë në obligimet tjera, sepse s'ka asnjë urgjencë. Kjo formë nuk humbin këto lek sepse është shtruar ju e keni lexuar ndoshta në material deri më 16 dhjetor të vitit 2016 kemi mundësi për t'i riprogramuar dhe në këtë mënyrë me 2 milionë e 600 mijë nëse dikush ka bërë hile aty i shohim zërat, ndoshta bën 1 milionë euro krejt tenderi i shtojmë edhe nga 1 milionë blejmë pajisje tjera dhe e fuqizojmë kardiokirurgjinë.

Kardiokirurgjia është bërë si ura Rozafës, ne nuk po gjejmë kënd duhet nur me e sakrifikuar. Prandaj, këtu po bëhet me qëllim kjo punë, sepse kur mund privatët të punojnë në Kardiokirurgji, pse nuk mund të punojnë në kardiokirurgji në shërbimin publik dhe këtu kërkohet problemi tek menaxhimi. Prandaj, zoti kryesues komisioni të ngarkohet me një krijim të një auditimit të strukturës teknike të tenderit dhe vlerës së tregut dhe këtu çka tha ministri i çështjeve sociale nga ato sinqerisht po ju them nga informacionet që është tenderi është vlera reale 1 milionë e 200 mijë. Faleminderit!

(Drejtimitin e mbledhjes plenare e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Ali Sadriu, ju lutem!

ALI SADRIU: Duke dal dikush më tha se firma është e Deçanit. Unë nuk e di prej nga është firma, por unë do të hap një historik të këtij.

KRYESUESI: Ju lusim për qetësi, asgjë nuk po dëgjohej. Keni pak respekt për dikë.

ALI SADRIU: Në vitin 2003 Qendra Klinike Universitare ka pas kërkuar mjete për kardiokirurgjinë invazive, i janë lejuar ato mjete dhe pajisjet janë blerë. Në vitin 2009 kam

shkuar drejtor i Qendrës Klinike Universitare ato i kam gjetur në podrum në najlon, nuk i kanë hapur.

Atje atëherë i kam gjetur 23 specialistë të kardiologjisë invazive, të cilët kanë punuar në klinikat private, por që ato nuk janë funksionalizuar. Deri te funksionalizimi ka qenë një punë shumë e lodhshme e mundimshme, me lloj-lloj justifikimesh se nuk guxon të fillohet kjo punë se rrezikohen jetët e njerëzve deri në atë se rryma nuk është stabile dhe deri në koha prej rrymës në rrymën alternative të gjeneratorëve i kalon 9 sekonda dhe rrezikohet jeta e njeriut.

Gjitha ato kanë rënë me këmbënguljen e një grupi që ka qenë për të filluar, kanë qenë vetëm dy mjekë në mënyrë që... po ky është turpi...

KRYETARI: Ju kisha lutur, kapeni nxirreni jashtë dritares atë kush mund, njëri nga deputetët kapeni menjëherë, vetëm nxirre jashtë dritares. Uluni e vazhdojmë seancën, e vazhdojmë seancën, mos bëni panik. Veç nxirre jashtë dritares, e vazhdojmë seancën. Dilni jashtë, dilni jashtë vetëm qetë, ju lutem. Kujdes, po lëndoheni, qetë!

Secili e tregon veten, vetëm kujdes prej xhamave, ju lutem ngadalë qetë... Turp! Secili e mban përgjegjësinë, veç e turpshme! Kujdes!

* * *

Vazhdimi i mbledhjes, pas pauzës

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Mirëmbërëma të gjithëve!

Jemi në pikën e 7-të të rendit të ditës, ne do ta përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës pastaj në qoftë se ka dikush për të diskutuar për situatën të cilën u krijuar kisha kërkuar mirëkuptimin e juaj nga 2-3 fjalë si kryetar i Kuvendit dhe si deputet ju kisha thënë rreth kësaj situatë, për arsye se ka nevojë edhe publiku, por edhe kiu të nderuar kolegë deputetë të jeni më në rrjedha rreth situatës paraprake si ka qenë, por edhe pak më gjatë.

Kolegu Ali Sadriu e ka pasur fjalën, pastaj para se të futemi në pikën tjetër të rendit të ditës, kisha kërkuar në qoftë se donë dikush, por edhe unë do të flas. Urdhëro, Ali!

Nuk ka, atëherë urdhëro... atëherë edhe këtë pikë të rendit të ditës mbetet për votim në momentin kur të krijohet kuorumi për arsye se na duhen 80 deputetë, aktualisht i kemi 66. Para se të dilja në pikën e tetë të rendit të ditës, unë kisha dëshiruar veç 2-3 fjalë t'i them rreth situatës së fundit.

Mirëmbërëma të gjithëve!

Deputetë të nderuar,

Kabinet qeveritar,

Në fakt desha të flas rreth situatës e cila u krijua paraprakisht nga disa nga kolegët tanë opozitar, mund të ketë edhe nga pak keqkuptime, por sido që të jetë opinioni publik është mirë ta dijë rreth një situatë në të cilën jemi duke kaluar.

Ka tre muaj e gjysmë si Kuvendi i Republikës së Kosovës e veçanërisht ne të gjithë çka jemi këtu si deputetë ballafaqohemi me një tentativë për krijimin e një gjendje kaotike. Realisht kjo situatë ka qenë më se transparente, opozita nëpërmjet një qëndrimi të vet kokëfortë, të cilin është duke tentuar të na imponohen edhe qëndrimin e vetë, por në të njëjtën kohë unë nuk do të ndalem shumë për arsye se qëndrimet e opozitës janë ato të cilat janë, janë transparente dhe fund të fundit ata janë duke e marrë përgjegjësinë politike me aq çfarë edhe po e shohim deri tani dhe po tregojnë përkundër neve një konsistencë të jashtëzakonshme dhe një vendosmëri rreth asaj të cilës janë duke e bërë.

Por, ajo të cilën është një situatë thjeshtë ne të cilën ne po ballafaqohemi që nga unë si kryetar i Kuvendit edhe kolegët tjerë opozitar, është një situatë të cilën shpeshherë po na krijoni gjendje e cila vërtetë nuk është e kënaqshme. Ne paraprakisht patëm edhe një mbledhje të kryesisë, profesori Sabri Hamiti e pati një reagim i cili në momentin ke emocional por dua të ndërlidhem me at emocionalitet deputeti i nderuar të nënkryetarit të Kuvendit, por edhe i cili është real, cila është situata nga do të shkojmë me këtë gjendje si Kuvend, si institucion i Republikës së Kosovës.

Gjithë këtë çmimi po e paguan ky Parlament, edhe gazin lotsjellës të njëjtën kohë edhe çmimin politik, të njëjtën kohë gjatë këtyre tre muajve e gjysmë kemi pasur situata të cilat shumë kush s'na ka kuptuar edhe na ka keqkuptuar ndoshta në raste të caktuara që nga vonesa te veprimi i aspektit juridik rreth dy muajve ka ndodhë gaz në mënyrë recidive dhe paralajmërime askush nuk ka reaguar. Të njëjtën kohë ne e kemi edhe një shqetësim për çka edhe është bërë një kërkesë e deputetëve rreth 82 janë nënshkruar, por një pjesë e madhe edhe disa të tjerëve të cilët nuk janë nënshkruar është një shqetësim qysh me e ndal këtë gaz lotsjellës, për arsye se nuk është se po sfidohemi ne vetëm këtu personalisht, po në të njëjtën kohë po sfidohen edhe të gjitha institucionet.

A kaq lehtë një shtet të cilin me sakrifica e kemi ndërtuar po mund ta thyejë çdo kush sistemin e rregullit tonë? Realisht, unë po e bëj këtu paraprakisht të ditur derisa ne të gjithë jemi munduar t'i ndalim, veç shefi i sigurimit të cilin e kemi pasur këtu në Kuvend ka koketuar së bashku me opozitën dhe askush s'ka marrë, shefi i sigurimit të Kuvendit ka koketuar me opozitën dhe dihet kjo, është transparente. Organet tona kanë qenë të njoftuara dhe është dashur dy muaj ditë për ta larguar të njëjtin njeri. Nuk është në rregull, nuk është në rregull realisht testi i cili po na ndodhë neve këtu në Kuvend.

Kolegët tanë, veçanërisht partnerët e bashkësisë ndërkombëtare, Bashkimi Evropian e ka një shqetësim i cili është real si mos të ndodhë largimi i gjithë opozitës nga punimet e Kuvendit. Ne e pamë edhe pak më herët se çfarë situatë kishim, asnjëherë nuk kemi pasur dëshirë që të ketë përjashtime kolektive të kolegëve tanë opozitarë, por realisht sjelljet e tyre ata po e vetë përjashtojnë vetveten. Edhe më herët kur ishim gjatë punimeve të seancës së Kuvendit, kishte reagim nga partnerët ndërkombëtarë, veçanërisht nga Zyra e Bashkimit Evropian e cila është këtu. Ne ju krijuam këtë mundësi deputetëve, një pjesë tyre kryesia të cilët nuk i përjashtoi

paraprakisht duke e thënë edhe në publik ne e kemi ditur edhe dimë se çdoherë do të vënë gaz lotsjellës kolegët tanë opozitar, për arsye se është një situatë në të cilën është edhe bllokimi i tyre, në qoftë se nuk e bëjnë e lejojmë disa prej tyre të futen të marrin pjesë në seanca atëherë kolegët e tyre mund t'i konsiderojnë se janë tradhtarë që po koketojnë me ne.

Edhe kjo është situata pse na ndodhi edhe herën e kaluar pas një mori insistimesh që t'ju lejohet ardhja në seancë kam dal edhe unë i kam marrë i kam fut në këtë sallë që të jenë pjesëmarrës në mënyrën që ta dëshmojmë se qëllimi i Kuvendit nuk është që ta përjashtojë askënd. Realisht ne jemi para përfundimit të seancave vjeshtore, kemi për të hyrë në sesionin pranveror. Do të ishte mirë edhe institucionet që bashkarish, veçanërisht po flas me Qeverinë të kemi një koordinim më të theksuar, më të thekur në këtë çështje për arsye se munden që të parandalohen edhe duhet të parandalohen edhe ky Kuvend nuk ka mekanizëm tjetër si t'i sfidojë, por janë edhe institucionet të cilat e kanë autoritetin, institucionet e rendit dhe drejtësisë të cilat duhet ta bëjnë këtë.

Duhet ta bëjnë, aq më tepër po flas se vetëm për një çështje teknike ne derisa ballafaqohemi kemi akuza në kryesi me kolegen e kryesisë ajo thotë “po na i fusin duart” duhet një skaner të cilin në internet të gjithë e gjejnë buxheti sot është kaluar, një skaner nuk arrin Qeveria jonë që të na krijojë e cila e bën skanimin total të trupit për me pas mundësi objektet e huaja të ia gjejnë. Si do të vazhdojmë ne në janar, e seanca plenare pastaj.

Vërtetë nuk jemi jetim, por njëfarë situatë veç publiku duhet ta dijë as nuk kishin mundur të futin gaz lotsjellës, as nuk kishin mundur t'i bëjnë këto rrëmuja kolegët tanë të nderuar të opozitës mos të kishin pasur nga pak mundësi me e bërë këtë. Edhe duhet ta dimë edhe këtë e cila është e fundit përmes Kuvendit nuk kanë për ta mundur kurrgjë që të arrijnë se Kuvendi do t'i vazhdojë seancat plenare sa herë të vendos kryesia dhe sa herë donë kryesia. Veç kot po mundohen, janë duke e turpëruar veten, janë duke e dëmtuar shtetin para atyre që s'e duan këtë shtet me tregu që ky shtet s'vlen për kurrgjë por e kanë gabim, edhe marre ju koft. Kjo do të ishte edhe përfundim. Faleminderit!

Kush donë le të urdhërojë në qoftë se dëshiron dikush fjalën. Jemi në pikën e tetë të rendit të ditës:

8. Shqyrtimi i propozim-amendamentit nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, i riproceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës

Në pajtim me nenin 144, paragrafi i parë të Kushtetutës, Qeveria e Kosovës ka ri proceduar Amendamentin nr. 25 në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Ky propozim amendament është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me akt gjykim nr. AGJ 303/12, datë 31 tetor 2012. Ftoj kryeministrin e Kosovës ta merr fjalën ose ministrin e Drejtësisë e kam në protokoll të shkruar. Ministri i Drejtësisë, urdhëro!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!
Kryeministër, anëtarë të Qeverisë,
Të nderuar deputetë,

Besoj se të gjithë me kohë e keni marrë amendamentimin e Kushtetutës që ka për qëllim që shumica e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të zgjidhet nga ana e Këshillit Gjyqësor, pra vetë gjyqtarëve.

Është një rekomandim që është dhënë edhe nga Komisioni Evropian edhe në raportin e progresit, më vjen mirë që edhe komisionet funksionale dhe kryesore e kanë përkrahur një iniciativë të tillë andaj ju ftoj që ta bëjmë një propozim dhe ta mbështesim edhe më tutje. Kjo forcon edhe në një mënyrë tjetër pavarësinë e gjyqësorit në vendin tonë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar ministër!
Selvije Halimi nënkryetare e Komisionit për Legjislacion e ka fjalën.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!
Të nderuar kolegë deputetë dhe ju Kabinet qeveritar,
Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në mbledhjen e mbajtur, më 07.12.2015, e shqyrtoi amendamentin kushtetues i propozuar nga Qeveria dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet amendamenti kushtetues që ka të bëjë me nenin 108, paragrafi 6, nën paragrafi 1 dhe 2, i ri proceduar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

2. Teksti i amendamentit të ri proceduar, më datën 30.11.2015, është i njëjtë me tekstin e propozim amendamentin të datës 31.10.2012 i vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me akt gjykimin nr. AGJ 303/12, arsyetim: Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete në mbledhjen e mbajtur, më 07.12.2015, shqyrtoi amendamentin kushtetues të propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Komisioni vlerësoi se amendamenti kushtetues që ka të bëjë me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 1 dhe 2, është i njëjtë me tekstin në propozim amendamentit të datës 31 tetor 2012, i vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese me akt gjykimin AGJ 303/12 rasti KO61/12. Duke pasur parasysh faktet e theksuara komisioni vlerëson se nuk ka pengesa procedurale që i njëjti të dërgohet për miratim në Kuvend, andaj edhe i ftojme deputetët që ta aprovojnë këtë ndryshim të amendament kushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani radhën e kanë përfaqësuesit apo kryetarët e grupeve parlamentare në qoftë se dëshirojnë fjalën unë do të shkojë me radhë. Partia Demokratike e Kosovës? Zonja Selvije Halimi, në emër të Partisë Demokratike të Kosovës.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar! Partia Demokratike e Kosovës e përkrah plotësim ndryshimin e amendamentit kushtetues. Faleminderit!

KRYETARI: Lidhja Demokratike e Kosovës, Armend Zemaj e ka fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolege e kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe të Komisionit Funkcional për Legjislacion, në kuadër të saj dua të theksoj që e potencoim edhe nënkryetarja e komisionit që ky është një vendim i vitit 2012 dhe logjika e reformimit të sistemit të drejtësisë në vend duke bërë që sistemi i drejtësisë të jetë plotësisht i pavarur nga ndërhyrjet politike, neve konsiderojmë që ky propozim amendament është harmoni edhe me rekomandimet e Komisionit ...të cilat i kemi harmonizuar edhe me projektligjet tjera, siç janë Projektligji për Këshillin Gjyqësor dhe Projektligji për Këshillin Prokurorial.

Andaj, i ftoj deputetët e Kuvendit të Kosovës që ta miratojnë dhe si i tillë besoj që në të ardhmen do të jetë edhe një lloj shembulli i asaj që ne e quajmë pavarësi gjyqësor të plotë. Faleminderit!

KRYETARI: “Vetëvendosje” nuk është, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës nuk është, nga Lista Serbe nuk ka nevojë, nuk dëshirojnë ta marrin fjalën. Nisma nuk është, “6+” nuk dëshiron ta marrë fjalën. Deputetë? Zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar Veseli!

Nuk kam për projektligjin, por bash për çështje politike pasi që u konsultuam edhe më herët në përputhshmëri edhe me mbështetjen e plotë të asaj çka prezantove i nderuar kryetar.

Ne duhet të jemi është pak si vonë, përndryshe unë edhe do të propozoja një seancë të veçantë për gjendjen në vend që të diskutojnë të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës se çka mendojnë për situatën, dhe kjo çështje nuk është punë individuale apo personale as e kryeministrit, as e kryetarit të Parlamentit, as e zëvendëskryeministrit, as e ministrave, as të shefave të grupeve parlamentare.

Prandaj, duhet të jetë shumë e qartë a është i pranueshëm gazi lotsjellës për krejt deputetët apo nuk është i pranueshëm. A janë të pranueshme ato forma të dhunshme të opozitës që po përdoret apo nuk janë të pranueshme. Prandaj, dhe natyrisht se do të ishte me interes me vëmendje më të madhe që ta dëgjojmë zërin e secilit, të secilit ministër dhe të secilit deputetë. Së pari si e vlerësoni gjendjen sepse tek e fundit secili nga ne kemi legjitimitet qytetar dhe secili nga ne marrim pyetje të ndryshme para elektoratit tonë dhe qytetarëve tonë për situatën e re të krijuar.

Natyrisht edhe debati për çështjet e ngritura për neve ka kohë tre muaj apo më tepër si tha edhe kryetari Veseli na mohohet e drejta që të komunikojmë me qytetarët për çështjet që ata i kanë ngritur, na mohohet që t’i informojmë njerëzit edhe për marrëveshjet me Bruksel dhe tash në vend të argumenteve që të ballafaqohemi me ne ata përdorin mjete plotësisht të papranueshme dhe mjete të dhunshme. Prandaj, shqetësimi tim pse dola sot këtu të diskutoj ndoshta edhe pasi që filloi pika tjetër e rendit të ditës është kjo, ne sot u detyruam që të vijmë në këtë sallë dhe në të njëjtën kohë duke i tejkaluar apo mund të themi në një formë apo formën tjetër me papërgjegjësinë më të lartë të veprimeve të tilla të dhunshme shumica e deputetëve 2/3 të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës u detyruan që të vijnë në këtë sallë dhe në të njëjtën kohë të dështojnë 4 marrëveshje ndërkombëtare që janë mbi 60 milionë euro për të ardhur në Kosovë.

Ne po rrezikojmë marrëveshjen ndërkombëtare rreth 60 milionë euro apo mbi 60 milionë euro ministër i nderuar i Financave. Prandaj, kjo çështje është shqetësuese nuk është shqetësuese vetëm për ne si Qeveri, si partnerë të koalicionit, si deputetë është shqetësuese për qytetarët, sepse ... për projektet e ndryshme gjithandej Kosovës. Prandaj, diskutojmë edhe me kryeministrin besoj se ne deputetë e Kuvendit të Kosovës apo Kuvendi i Kosovës po flas ne deputetët se edhe ne jemi të gjithë deputetë pastaj në bazë të Kushtetutës dhe ligjeve jemi liruar nga ato përgjegjësi duke qenë ekzekutiv, por duke qenë edhe përgjegjës dhe liderë të partive politike vlerësojmë se 2/3 e deputetëve që janë sot këtu në këtë sallë do të ishte me interes për opinion publik, por edhe për njerëzit e tyre, edhe për ata që nuk janë të informuar drejtë, të kuptojnë drejtë situatën, neve po na mohohet informimi i qytetarëve, ne jemi të bllokuar për të informuar qytetarët realisht për gjendjen çka është dhe nuk mund të sillemi ne sikur s'po ndodh kurrëgjë, por po ndodh sot Kuvendi i Republikës së Kosovës është i uzurpuar dhunshëm nga një grup deputetësh opozitar dhe ne jemi të detyruar të jemi .. alternative nga një grup i deputetëve që në mënyrë të dhunshme e ka uzurpuar sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Dhe, ne nuk mund të shkojmë vazhdimisht në tërheqje, tërheqje, tërheqje. Prandaj, mendoj që do të ishte me interes që sot Kuvendi i Republikës së Kosovës ne do të mbajmë mbledhje si Qeveri e Kosovës pak më vonë, të dënojmë uzurpimin e dhunshëm të objektit të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga një grup i caktuar deputetësh opozitar. Në të njëjtën kohë, sepse qytetari i Kosovës duhet ta dijë ne nuk jemi këtu për qef, tash u hodh gazi lotsjellës edhe këtu rreth 100 deputetë në këtë derë këtu, në fakt është edhe kundër shëndetit dhe rrezikshëm për krejt njerëzit që ishin këtu, edhe për gazetarët, edhe për shoqërinë civile, edhe për Bashkësinë Ndërkombëtare edhe për të gjithë. Ata po rrezikojnë jetët e deputetëve, të Kabinetit qeveritar, dhe gjithë zyrtarëve që janë këtu, dhe legjitimiteti ynë qytetarë nuk është që të largohemi nga salla e Kuvendit, përkundrazi t'i kryejmë detyrat tona.

Prandaj, vlerësoj që i nderuar kryetar nëse ka mirëkuptimin edhe prej shfave të grupeve parlamentare le ta bëjnë një formulim të një deklarate publike që dënojnë uzurpimin që Kuvendi i Kosovës dënon, nuk ka nevojë të merret vetëm kryetari dhe kryesia e Kuvendit, por që Kuvendi i Republikës së Kosovës dënon uzurpimin e dhunshëm të objekteve të Kuvendit të Republikës së Kosovës nga një grup i caktuar deputetësh.

Nëse vlerësohet që gazi lotsjellës është armë atëherë ai grup është një grup i armatosur që e ka uzurpuar Kuvendin e Republikës së Kosovës, unë nuk jam ekspert i forenzikës për ta vlerësuar se si është, por kjo çështje është e rregulluar edhe me ligj. Në të njëjtën kohë ftojme edhe deputetët të kthehen natyrisht se ne s'kemi asnjë interes ata mos të jenë në Kuvend, përkundrazi jemi të interesuar që të vijnë edhe të ballafaqohemi me argumentet që i kemi. Jemi të bindur se dialogu politik, mirëkuptimi janë zgjidhja e vetme, gjithashtu do të ishte me interes që ata deputetë të rikthehen në Kuvend, të vijnë dhe të diskutojnë dhe t'i prezantojnë argumentet të gjitha që kanë, por jo në këtë formë të tillë të dhunës, të uzurpimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Andaj, kërkesa ime edhe sot përsëri është këtu që ky Kuvend të deklarohet qartë dhe qytetari i Kosovës ta kuptojë shumë qartë se sot Kuvendi i Republikës së Kosovës është uzurpuar dhunshëm nga një grup i caktuar të deputetëve opozitar. Faleminderit dhe ftoj natyrisht që Kuvendi të dal me një deklaratë me mirëkuptim të shfave të grupeve parlamentare dhe të aprovojme at deklaratë, apo komunikatë a qëndrim.

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zëvendëskryeministër! Adem Grabovci e ka kërkuar fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar Kabinet qeverisës,

Shqetësimi jonë nuk është i sodit, ne jemi që 3 muaj e gjysmë duke u përballur me këtë realitet të hidhur. Fatkeqësisht, përveç dëmeve shëndetësore që i janë shkaktuar çdo deputeti, gazetari, përfaqësuesve ndërkombëtar këtu që kanë qenë së bashku me neve, e kanë ndarë këtë fat së bashku me ne, shqetësimi më i madh për mendimin tim është ai që i është shkaktuar vendit tonë politik, mesazhi negativ që ka shkuar para botës demokratike dhe thjesht na qon në një përfundim se e kam thënë edhe në media, po e përsëris një pjesë e opozitës kam bindjen e thellë se ka mision të caktuar për ta destabilizuar vendin dhe nuk mund të them saktësisht që për interesat e kujt po punon, por gjithsesi e them me bindje se asnjëherë, në asnjë moment dhe këto veprime nuk përputhen me interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Po është e vërtetë se ne si deputetë si shumicë na është mohuar e drejta e paraqitjes së qëndrimeve tona rreth dy marrëveshjeve: për asociacionin ne e dimë se si ka shkuar rrjedhja, por ne duhet ta kemi parasysh dhe t'ua bëjmë të qartë qytetarëve të Republikës së Kosovës se për demarkacionin, pra përcaktimin e vijës kufitare mes Kosovës dhe Malit të Zi, deputetët e Kuvendit të Kosovës ende nuk e kanë materien dhe nuk kemi pas për çka të bisedojmë dhe kjo është vetëm një pretekst që ka përdorur dhe po vazhdon të përdorë opozita për të arritur qëllimet e veta, ardhjen në pushtet që do të mbetet një ëndërr e dëshiruar, po e pa realizuar duke i pas parasysh format e veprimit që po i përdorë.

E dimë se në demokraci është qytetari i Republikës së Kosovës ai që na sjell në pushtet, është qytetari i Republikës së Kosovës që përcakton me votë besimin e vetë se kujt i beson t'i përfaqësojë, dhe t'i mbrojë dhe të udhëheqë me shtetin. Ne fatkeqësisht, nuk e besoj një qytetar i vetëm që mund të gjendet diku që ka mundur të mendojë se pas sa viteve pas luftës institucionin që e kemi ndërtuar ne vetë të kthehemi dhe të bëjmë përpjekje ta rrënojmë atë. Kjo është një papërgjegjësi dhe duhet të gjykojnë të gjithë sa më drejtë.

Zoti kryetar, ne pajtohemi edhe konstatimet e zëvendëskryeministrit që po është e vërtetë se salla kryesore e Kuvendit është e uzurpuar dhe jo vetëm sot, por po bëhen rreth 4 muaj me radhë që ajo sallë është e uzurpuar nga pakica, duke përdorur mjete të dhunshme. Ne jemi të gatshëm të dalim në çdo deklaratë, në çdo konstatim në përputhje me realitetin, por unë po përkujtoj se deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë bërë një kërkesë më se 82 nënshkrime edhe një pjesë tjetër që s'ka pas mundësi të nënshkruajë e mbështetë at iniciativë tonën që kemi kërkuar krijimin e kushteve për punë normale në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo ka qenë për një arsye se Rregullorja e Kuvendit të Kosovës është një Rregullore e çoroditur që s'është Rregullore dhe nuk i mundëson kryetarit të Kuvendit, kryesisë të merr masat adekuate ashtu siç veprojnë shtetet tjera fqinje.

Prandaj, duke pas parasysh këtë ne jemi organizuar 82 deputetë kemi dhënë nënshkrime dhe kemi kërkuar arsyeshëm respektim dhe marrjen e masave ligjore nga institucionet përkatëse. Mendoj që duhet t'i vijë fundi, sot ka arrit kulmin e çdo gjëje kur edhe në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit, nënkryetarja e Kuvendit pas shumë përpjekjeve edhe nga kryetari i Kuvendit, pas shumë lutjeve njerëzore edhe nënkryetarët e Kuvendit kolegët e saj që mundësonani vetëm mos e

rrezikoni jetën e deputetëve në sallën e Kuvendit ajo na hedh gaz lotsjellës edhe në kryesinë e Kuvendit.

Edhe pas përpjekjeve tjera të kryetarit që vërtetë të dëshmojnë se ne jemi për dialog, jemi për ta gjetur një gjuhë të përbashkët, për të marrë vendime të përbashkëta, thjesht nëse shprehem edhe me fjalë popullore “e njeh edhe pabesinë” edhe pasi që u mundësoi kryetari që të vijnë dhe të marrin pjesë e keqpërdorën mirësinë, përpjekjen e sinqertë dhe edhe këtu në këtë sallë na hodhën gaz lotsjellës.

Andaj, mendoj se janë konsumuar të gjitha mjetet. Duhet veprime ligjore dhe të krijohen kushte të nevojshme për punë normale të Kuvendit të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ismet Beqiri e ka fjalën, kryetar i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

ISMET BEQIRI: Faleminderit! Unë pa dashur meqenëse jemi në rend ditës duke e kuptuar peshën dhe rëndësinë e gjendjes në të cilën jemi, që të gjithë ju ne e ndajmë shqetësimin bashkë.

Unë nuk dëshiroj ta zgjas absolutisht nëse jeni dakord bëhet një grup qoftë prej shefave, qoftë prej tjerëve 3-4 vetëve bëni një tekst, meqenëse u tha të deklaratës dhe ne e themi atë çfarë mendojmë me 3-4 fjali, pa dashur po e them edhe njëherë, sepse kjo donë kohë, por mbi të gjitha donë angazhim për ta rikthyer ose për ta sanuar gjendjen në të cilën jemi. Unë nuk dëshiroj me thënë normalisht që jam më shumë i shqetësuar se sa që të gjithë ju, por se jemi të shqetësuar dhe duhet bërë përpjekje për të gjetur rrugë zgjidhje, rrugëdalje kjo është e padiskutueshme, prandaj nëse jeni dakord ne shkojmë në këtë mënyrë pa dashur ta zgjas këtu, ne mund ta bëjmë një tekst, një deklaratë thjeshtë të dënimit të sjelljeve të dhunshme, jo ligjore dhe të dënueshme të deputetëve të opozitës, ato që ndodhi në sallë dhe po ashtu edhe në sallën poshtë por edhe këtë më vonë në seancën që e vazhduam. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëro, profesori Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë.

Nuk kemi çka t'i themi situatës ajo është shumë transparente dhe ne po sfidohemi, seriozisht po sfidohemi nga tendencat e uzurpimit të shtetit edhe krijimit të anarkisë. Gjithashtu, po sfidohemi nga nevoja që të gjithë ta ngremë nivelin e përgjegjësisë që institucionet ta kryejnë punën e vet. Unë e mbështes, domethënë që të japim një deklaratë në rregull është të japim një deklaratë, por efekti i saj s' di sa ka me qenë por megjithatë jemi detyruar që ta japim at deklaratë.

Unë për vete mendoj që çdokush kush e shkel ligjin pa marrë parasysh për çfarë arsye duhet të ballafaqohet me veprimin e shtetit ligjor, të prokurorisë dhe të gjyqeve.

Nën dy, çështja e funksionimit të Kuvendit nuk duhet të ballafaqohet vetëm policia, ne jemi këtu që ta zbatojmë Rregulloren e Kuvendit dhe të sigurojmë mbarëvajtjen e Kuvendit.

Prandaj, unë mendoj se nuk duhet të mbetet vetëm një konflikt i organeve të represionit, policisë, prokurorisë dhe deputetëve tonë me veprimet të cilëve nuk pajtohemi, e kemi thënë sa e sa herë. Unë kërkoj nga kryesia, kërkoj nga kryetari i Kuvendit, kërkoj nga të gjithë ne që ne ta zbatojmë Rregulloren. Kjo është përgjegjësia jonë, çështjet tjera të shkeljes të ligjit, veprës penale, tymit, uzurpimit janë çështje të organeve përkatëse. Unë e kam mirëpritur deri vonë edhe angazhimin e juaj që me mirëkuptim mos të krijojmë, mos tensionojmë situatën kjo nuk po jep rezultate dhe prandaj unë kërkoj që të zbatohet Rregullorja, nën 1.

Dhe, në qoftë se ajo Rregullore, siç po thotë është e papërshtatshme le ta ndryshojmë nuk është shumë, ajo që është njëherë le ta zbatojmë atë që është aq sa është në qoftë se duhet ta bëjmë më të mirë e bëjmë më të mirë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Arben Gashi ka kërkuar fjalën. Më falni e patëm një propozim konkret nga zëvendëskryeministri, janë deklarim kryetarët e grupeve parlamentare edhe deputetëve, pastaj pak kësaj do të dalim me një konkluzion, të cilin ju e vendosni.

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Para se me mbërri që ta jap një konkluzion për procesin mendoj se ajo çka ju deklaruat personalisht këtu është jashtëzakonisht e rëndë, e papranueshme dhe e patolerueshme.

Qysh mund të ndodhë që për dy muaj ditë shefi, komandanti i njësisë së sigurimit të Kuvendit paska koketuar për veprime kriminale brenda Kuvendit të Kosovës dhe institucionet e Kosovës nuk kanë mundur të marrin asnjë veprim. Çfarë institucionesh janë këto! çka është bërë ndaj komandantit të policisë, qysh drejtori i policisë duke e dit këtë veprim ka lejuar të ndodh dy muaj ditë në Kuvend. Dy muaj ditë janë torturuar deputetët e Kuvendit të Kosovës, dy muaj ditë është torturuar komplet opinioni publik në Kosovë duke e ditur kush është shkaktori dhe nuk është marrë asnjë masë dhe se unë kam keqkuptuar fjalën “koketim”, sepse kur po thuhet me sa po kuptoj unë “koketim” bashkëpunim i komandantit të sigurimit të Kuvendit me individë të opozitës për të fut mjete brenda Kuvendit të Kosovës për të rrezikuar jetën, trupin dhe shëndetin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës që përbën vepër penale në vetvete dhe nuk është marr asnjë masë, si mundet të ndodh kjo.

Mendoj se kjo nëse ka ndodh është jashtëzakonisht e rëndë dhe deklaratat publike politike këtu s’kanë asnjë lloj vlere përball këtij skandali që ju sapo e prezantuat. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E rikonfirmoj edhe një herë atë çka e thashë është ajo çka u mundove ta përkthesh i nderuar deputetë, bashkëpunim. Shefi i sigurimit të Kuvendit i cili nuk i përgjigjet kryetarit të Kuvendit me opozitën nuk po shkoj në kualifikime më duket si para një jave dite mos është larguar dhe nuk e di a është larguar ende, nuk kam informacion se s’jam marrë kurrë me të po u ditë.

Sido që të jetë, tash po dalim te kjo pjesa kryesore e cila është: kemi një propozim mirë është veç shefat e grupeve parlamentare të merren në koordinim mes vete edhe në qoftë se e vendosim mund të bëjmë deklaratën e Kuvendit, Rregullorja e Kuvendit e njeh me harmonizuar një tekst e cila do të jetë deklarata e Kuvendit në moment kur bëhet gati teksti i përgatitur, atëherë vihet në votim në këtë Kuvend.

Deklaratë të Kuvendit, por për çka për atë arsye, kryetarët e grupeve parlamentare e kryejnë. Urdhëro, zëvendëskryeministri edhe njëherë e ka fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Disa deputetë pyetën se çka është ajo deklaratë. Unë isha më duket shumë i qartë në propozimin tim: ky Kuvend i Kosovës dua të konstatoj uzurpimin e dhunshëm të sallës së Kuvendit të Republikës së Kosovës nga një grup i caktuar i deputetëve të opozitës.

Qytetari i Kosovës duhet ta mësojë të vërtetën, Kuvendi i Kosovës është uzurpuar dhunshëm, këtë e kam kërkuar dhe unë kërkoj nga deputetët, ky është konkluzioni a konstatimi nëse dikush ka ndonjë pyetje shtesë, nëse nuk është kjo e vërtetë urdhëro zbritni poshtë e keni aty dhe pyetja shtrohet pse jemi ne lart këtu. Jemi lart se është uzurpuar salla e Kuvendit edhe kërkoj që të jetë formulim shumë i qartë uzurpim i dhunshëm nga një grup i deputetëve opozitarë duke përdorur mjete të dhunshme.

KRYETARI: Melihate Tërmkolli e ka fjalën, pastaj Fatmiri, Bardhyli. Vetëm të shkojmë me rend, e para e ka kërkuar Melihatja.

MELIHATE TËRMKOLLI: Të nderuar deputetë,

Unë po ju kërkoj falje që edhe njëherë po ju marr ndoshta kohë pak, momentin kur Qeveria jo Qeveria ngushtësisht, por pozita fillon që të ankohet ndaj opozitës nuk është diçka në rregull, ta keni të qartë kjo nuk shkon kurrkund.

Pozita përcakton edhe merr masa, por mos harroni në këtë vend edhe jo veç në këtë vend por gjithkund në botë nuk vlejnë veç masat qofshin ato nga policia, qofshin ato nga sigurimi i Kuvendit, çfarëdo qofshin ato. Pozita do të provojë të gjitha mënyrat dhe unë po ju lus shumë që jam shumë e sigurt pavarësisht shumë keqkuptimeve, shumë të tjerave që po vijnë jo s'po duan të bisedojnë, jo po duan të bisedojnë, jo njëra, jo tjetra. Ne s'kemi qare pa u ulur që të bisedojmë, qare nuk kemi pa u ulur për të biseduar, por është mirë sa s'ka ndodh diçka më e keqe. Unë po i frikohem më shumë, prandaj kujtoj që na duhet një përgjegjësi shumë, shumë më e lartë.

Kjo që e tha zëvendëskryeministri mendoj që mund të bëhet, por nuk e zgjidh problemin. Neve na duhet që ta zgjidhim problemi, kaq! Faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Fatmir Rexhepi e ka fjalën, pastaj Bardhyl ju e kërkuat, si të shkojmë drejt rrumbullakimit kryetarët e grupeve parlamentare, pastaj.

FATMIR REXHEPI: Faleminderit, kryetar!

Përshëndetje për të gjithë,

Këto rrethana vërtetë edhe këto zhvillime të jashtëzakonshme është vështirë njeriu të bëhet i mençur edhe ta gjejë zgjidhjen cilido qoftë se shumë është komplikuar situata por jemi këtu megjithatë me u ndje të përgjegjshëm edhe të shikojmë që ta menaxhojmë edhe politikisht, edhe si Parlament edhe si Qeveri për zhvillimet që na presin.

Prandaj, unë po pajtohem me atë që fillimisht e tha zëvendëskryeministri zoti Hashim Thaçi që t'i kushtojmë një seancë të veçantë të zhvillimeve politike, jo veç në Parlament por për shkak të

impaktit të madh që ka në jetën politike dhe shoqërore të vendit, por edhe në të gjitha sferat tjera t'i kushtojmë pra një vëmendje të posaçme debatit tonë në Parlament që të japim për opinionin, për qytetarët të gjitha përgjigjet të cilat i përmbajnë ato dy marrëveshje për të cilat realisht na është mohuar e drejta në Parlament edhe të marrim një qëndrim politik, së pari një vlerësim pastaj një qëndrim parlamentar si koalicion që e qeveris një vendin dhe të japim një pasqyrë krejt tjetër dhe t'i japim pra një zgjidhje asaj pjese për opinion në variantin që në e vlerësojmë se ato marrëveshje paraqesin interesin apo jo, apo ka gabime apo s'ka.

Prandaj, unë po kërkoj që ta përkrahim për një seancë të veçantë në mënyrë që realisht pas kësaj pastaj thoni bashkarish do t'i gjejmë alternativat tjera. Për këtë dëshirova që ta marr fjalën, prandaj unë e përkrahi seancën e veçantë përndryshe deklaratat jemi dakord, por unë megjithatë nuk jam ihtar i asaj që të ngutemi me deklarata, të biem në provokim e ta provokojmë situatën edhe ma shumë. Neve na duhet ta gjejmë pra një kompromis politik edhe me opozitën edhe pas asaj seance të veçantë duhet të vepruar me alternativën dhe variantin si koalicion si mendon të menaxhojmë situatën e mëtutjeshme në bashkëpunim edhe me opozitën, por pasi të japim sqarimin në Parlament për të gjithë opinionin e vendit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Bardhyl e ke fjalën, Armend, pastaj Selvije.

BARDHYL METAJ: Nuk e kam mend ta zgjas, por po dua të them një aspekt: ne i kemi tash dy palët edhe kemi palën e tretë qytetarët. Edhe qytetarët i kanë mendjet dhe shpirtrat e ndarë në dy pjesë, ato pjesë njëra pjesë është më e vogël, tjetra më e madhe, dikush admiron punën e pozitës, tjetri e urren, pala tjetër mendon se opozita e ka mirë, kurse pozita keq edhe tash domethënë qytetarët e dinë se çfarë opozite kemi, por edhe çfarë pozite kemi, por një nuk e dinë edhe ajo po iu mungon e ajo është çfarë shteti kemi.

Si është e mundur sot deputetë, të cilët janë në arrest shtëpiak po në arrest munden të hyjnë në Kuvend përmes 100 mijë parë dyerve të policëve, çka po dua të them me këtë fjalë unë nuk jam që kolegët e mi deputetë të opozitës të burgosen po unë po ua garantoj se çdo qytetar i Kosovës e kërkon një përgjigje përveç pozitës dhe opozitës a ka shtet në këtë vend për atë kanë luftuar ata edhe për atë janë në gjendje të luftojnë edhe më tutje.

Pra, edhe ministri i Punëve të Brendshme, kryeministri, zëvendëskryeministri, kryetari i Parlamentit edhe krejt ky koalicion e ne si deputetë e kemi borxh t'i bëjmë thirrje atij që e quajmë "shteti i Kosovës" që të funksionojë çdo hallk e tij, përndryshe kemi kontradikta marramendëse. Ke deputetë i cili është në burg, akuzohet për vepër penale ndërkaq nuk është i përjashtuar prej seancës për arsye se Rregulloren e kemi lënë anash.

Nuk jam kah merrem këtu për të gjetur fajtorin, por jam duke u marrë me atë hajde t'i apelojmë shtetit tonë le të funksionojë për të mirën e gjithë qytetarëve. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Armend, Selvije pastaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit! E para çka duhet theksoj kështu personalisht ne nuk kemi Rregullore të çoroditur, por kemi një Rregullore liberale në krahasim me vendet tjera dhe

pretendimet e shtetit të Kosovës, por edhe të Kuvendit, edhe të subjekteve politike deri më tani kanë qenë që vendi ynë të jetë në norma demokratike ashtu siç i kanë vendet më të përparuara.

Tash nuk besoj që asnjë legjislaturë paraprake që e ka miratuar at Rregullore nuk e ka pas në ndër vetëdijen e vetë se mund të ndodhin gjëra të tilla, të cilat kanë ndodh sidomos këta tre muaj e gjysmë. Kjo është logjika e Rregullores së punës së Kuvendit dhe ne jemi krenuar me një Rregullore qoftë para qytetarëve të vendit edhe qoftë para faktorit ndërkombëtar se është një ndër Rregulloret më të avancuara sa i përket raportit pozitiv-opozitiv, por është e drejta edhe të të tjerave komuniteteve në vendin tonë dhe kjo është logjika e saj. Kështu që unë nuk isha ballafaquar me Rregulloren, por isha ballafaquar me respektimin e Rregullores.

Sado që liberale është unë mendoj që nëse Rregullorja respektohet në çdo pikë të saj ne nuk do t'i kemi këto probleme që i kemi, pavarësisht uzurpimit, sulmimit, tendencave tjera, atakimit të deputetëve individualisht apo në mënyrë kolektive dhe kjo është shumë e rregulluar dhe shumë qartë dhe nuk do interpretim tjetër. nëse kërkojmë masa tjera, të cilat neve na fusin në ato kornizat e vendeve të cilat nuk janë për sy të mirë sa i përket raporteve demokratike brenda institucionit unë nuk jam për atë, unë jam për respektim të Rregullores së punës së Kuvendit kjo që është për mua mendoj është më liberale se vendeve tjera, por sido që të jetë kështu është i krijuar edhe shteti i Kosovës. Ndërsa, e potencoi edhe kryetari nxjerrja e deklaratave, mocioneve, rezolutave të gjitha këtyre nuk janë obligative, mund të jetë deklaratë e Kuvendit, por nuk është obligative për askënd, sepse një prej atyre pikave prapë duhet të thirren në respektim të Rregullores së Kuvendit.

Kështu që unë po kërkoj që të respektohet Rregullorja e punës dhe atëherë do të krijohen kushte edhe për deputetët, sepse u tha këtu që janë mbledhur 82 nënshkrime ku deputetët kërkojnë respektim të Rregullores së punës edhe të krijimit të kushteve të punës të saj për atë për të cilët janë të lidhur dhe e kemi mandatin. Jashtë kësaj mendoj që ne atëherë do të krijojmë edhe situata jo të mira, mund të jenë edhe të jashtëzakonshme, por mund të jenë edhe kritike nga faktori vendor dhe nga faktori ndërkombëtar. Faleminderit!

KRYETARI: Armend, a ka mundësi mos ta lëshosh veç një pyetje se këta kolegët jemi të gjithë deputetë, ne si kryesi kemi bukur kokëçarje gjatë çka mendoni ju jeni nën komision kryetar, si duhet ende ta respektojë kryesia në raport me situatën aktuale që s'e kemi ndërmarrë se ta kemi publikisht, po kam dëshirë.

ARMEND ZEMAJ: Publikisht kryetar edhe realisht asgjë më shumë nga ajo që është e shkruar, për mbarëvajtjen e punës në Kuvend përgjegjës është kryetari edhe kryesia e Kuvendit.

Çdo tendencë për ta penguar punën e Kuvendit mbetet në mandatin e juaj, ju jeni ata që duhet të merrni edhe vendime edhe obligime, sigurisht që ju e keni edhe mbështetjen e subjekteve të juaja politike dhe kjo...

(Ndërprerje e incizimit)

KRYETARI: Jo, jo çka konkretisht se ne kemi ndërmarrë bukur shumë, por s'po e dimë ende edhe çka me ndërmarrë jashtë kësaj çka s'kemi ndërmarrë, çka duhet ende? Veç pak jemi duke bashkëbiseduar për hir të publikut jo për shkak të neve.

ARMEND ZEMAJ: Kushdo që këtu e pengon punën edhe fjalën e tjetrit janë masat sanksionuese që janë paraparë në Rregulloren e punës dhe ju ato duhet t'i zbatoni.

KRYETARI: A k drejtë kryesia ose kryetari i Kuvendit ta përjashtojë kolektivisht dikë më tepër se sa një seancë individualisht.

ARMEND ZEMAJ: Jo, se deputetët nuk janë ardhur këtu kolektivisht janë ardhur me emra dhe mbiemër edhe mandati i deputetit është i lirë nuk i nënshtrohet asnjë lloj detyrimi, çdo kush përgjigjet personalisht për aktin të cilin e bën qoftë brenda seancës është në veprimin e tij.

KRYETARI: Faleminderit! Këta e desha. Faleminderit! Jo sa për publik ishte sqarimi, Selvija e ka fjalën. Adem, Selvija po si kryetar grupi urdhëro. Replikë? A, urdhëro!

ADEM GRABOVCI: Shiko, unë kur e thash se kemi Rregullore të çoroditur pikërisht është tepër liberale sa që po na sjell këto probleme që na i ka sjell në Kuvend dhe neni 41, pika 3c, që është masa më e ashpër nëse mund të themi ndaj atyre që pengojnë mbarëvajtjen e seancës: "kryetari në konsultë me kryesinë i përjashton nga një seancë" të gjitha parlamentet nga një seancë nuk ka drejtë më tepër se një seancë, ju lutem, në mënyrë individuale dhe atë që e kemi kërkuar pikërisht nga zoti Zemaj në komision që është edhe zonja Halimi dhe komisioni përkatës konsultohuni si e kanë të rregulluar këtë çështjet shtetet në regjion dhe shtetet të gjitha pa përjashtim e kanë tre muaj, gjashtë muaj edhe më tepër masë.

Rregullorja jonë na detyron që ne opozitën ta presim deri të na e qet një gaz lotsjellës dhe pastaj merren masa, kaq është.

KRYETARI: Selvija e ka fjalën, por kishim dalë te ajo nëse po do kundër-replikë Armend? Si dëshiron për atë, më fal Selvije, është çështje për publik më tepër nuk prish punë, nuk po e shoh negative hiç këtë debat.

ARMEND ZEMAJ: Unë e theksova shumë saktë që vendet tjera edhe ato që janë demokratike që janë shtet më shumë se 100 e sa vjet i kanë sanksionet më të ashpra në Rregulloren e punës së tyre të Kuvendit, por kjo nuk do të thotë që ne duhet t'i marrim model ato pavarësisht dallimeve dhe zhvillimeve që kanë.

Edhe shteti i Kosovës i shpallur kanë qenë më shumë në aspektin e konsensusit që ne e quajmë gjithë kombëtarë dhe kjo frymë ka mbizotëruar deri më tani.

Unë prapë po e them që askush nuk e ka parë ndonjëherë në logjikën ndër vetëdijen e tij që dikush mundet me gjuajt me një mjet të ndaluar që sipas Kodit Penal është armë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

KRYETARI: Selvije urdhëro, më fal!

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Gjendja në të cilën po kalojmë nuk do koment, mirëpo një gjë duhet ta kemi parasysh të gjithë sepse të gjithë e dimë, por duhet t'ia kujtojmë vetvetes.

Shteti vepron apo edhe duhet të veprojë si një tërësi me organe dhe përgjegjësi të ndarë dhe të rregulluar me ligj, këto organe i vijnë në ndihmë njëri-tjetrit në momente të caktuara. Për këta tre muaj thuajse ne kemi neglizhuar pak ca punën e ndonjë organi të caktuar i cili është i thirrur për të siguruar rend dhe qetësi. Nuk dua ta komentoj kush më shumë e kush më pak e ka neglizhuar këtë, por secili ka mundësi t'ia bëjë vetit pyetjen.

Kemi ardhur në situata kur jemi shantazhuar, kur jemi kërcënuar për veprim apo mos veprim. Por, dikush hesht sepse e dinë se një ditë shteti vërtetë do të veprojë, por nuk duhet ta lëmë të bëhet vonë. Dispozitat ligjore kur po flasim për rregulloret dhe ligjet që i kemi aprovuar në këtë Kuvend nuk interpretohen dhe nuk zbatohen si të vetme jashtë sistemit, por ato interpretohen dhe zbatohen brenda sistemit juridik. Në qoftë se një ligj për siguri në punë dhe ne kemi ... Kuvendit pas momentit kur kemi fituar të drejtën të jemi deputetë, nuk mund të zbatohet si i tillë si i vetëm e plotëson Rregullorja.

Nëse Rregullorja ka mangësi dhe Ligji për sigurimin e kushteve në punë ka mangësi e plotëson ligji tjetër për sigurinë publike të qytetarëve kudo që ata veprojnë dhe punojnë. Mirëpo, e dimë pse nuk është vepruar ashpër në fillim, sepse kemi menduar që të gjithë jemi një dhe mendojmë njësoj për shtetin. Mirëpo, kohëve të fundit po del ndryshe, nuk ruhet shteti duke u shkatërruar, nuk ruhet shteti duke u thirrur në marrëveshje që as ata vetë nuk po mund t'i argumentojnë qysh dhe çka duhet të bëjë.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryetar dhe ju Kabinet qeveritar,

Unë e kam një propozim konkret: të mbajmë një seancë dhe kjo mos të jetë seanca e fundit por të mbajmë një seancë para festave të Vitit të Ri, pavarësisht a do vijnë kolegët opozitar apo jo. Të diskutojmë për situatën politike që është krijuar në vend tash e tre muaj, sepse na takon si legjislativ sepse pengesat po na bëhen neve direkt në fund të fundit jemi institucioni më i lartë i këtij vendi.

Përveç situatës politike të diskutojmë edhe për çështjet tjera, pavarësisht që asociacioni është i dërguar në Kushtetuese nga presidentja nuk prish punë asgjë në marrjen e vendimit apo të aktgjykimit nga ana e kushtetueses po që se jep kryeministri një informatë e cila është dashur të jepet para tre muajve por është penguar nga opozita. Të diskutojmë edhe për demarkacionin, unë personalisht dua t'i di edhe njëherë publikisht në Kuvend argumentet pro që është nënshkruar marrëveshja dhe argumentet që tash na dalin kontra, jo pse u besoj më shumë, por dua t'i dëgjoj publikisht së bashku me juve.

Dhe, vetëm atëherë mendoj që krijohen rrethana për të biseduar dhe për të ulur tensionin, në të kundërtën po e shohim se ku do na qojnë këto veprime po që se ne si organe po e përsëris

fillimin edhe njëherë nuk i dalim në mbrojtje njëri-tjetrit, sepse ashtu jemi të obliguar edhe me Kushtetutë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po shkojmë drejt rrumbullakimit. Kryeministri e ka fjalën.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Të nderuar deputetë,
Zëvendëskryeministra, ministra,

Tani është vështirë që të përshkruhet kjo gjendje ose të cilësohet gjendja. Është e vështirë, është shumë e vështirë, është e pakëndshme, mirëpo vërtetë kjo gjendje kërkon marrjen e masave dhe kërkon sanimin e saj.

Dhe, unë nuk shoh askënd që këtë gjendje duhet ta sanojë dhe ta rregullojë përpos neve këtu Kuvendin e Republikës së Kosovës, Qeverinë e Republikës së Kosovës, institucionet e Republikës së Kosovës. Nuk mundet gjendja të degradojë që pastaj të ftohet dikush tjetër dhe të vjen ta korrigjojë ose të ndërmarrë masa, sepse ne e kemi shpall pavarësinë, ne me bindje i kemi marrë përgjegjësitë që institucionet tona duhet të funksionojnë. Nuk kemi këtu të bëjmë tash me problemin e dështimit të institucioneve, kemi të bëjmë me opozitën e cila po përdor mjete të dhunshme., të paarsyeshme për këtë situatë edhe për gjendjen në të cilën gjendet Kosova.

Nuk po ngjajnë problemet vetëm në Kuvend, përmes bllokimit të seancave të Kuvendit hedhjes së gazit lotsjellës, sprejit, po por ngjajnë edhe jashtë Kuvendit. Po digjen automjete zyrtare, po shkatërrohen prona publike, po shkatërrohen prona private kështu që dimensionet e problemit nuk janë dimensione vetëm të Kuvendit janë dimensione të cilat po kapërcejnë gjendjen në Kuvend për të cilat ne duhet të jemi koshientë edhe duhet që secili prej institucioneve ta merr përgjegjësinë e vetë. Askush nuk ka drejtë ta uzurpojë institucionin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, askush nuk ka drejtë që të rrezikojë funksionimin e sistemit kushtetues të këtij vendi dhe të gjithë ne jemi të obliguar që ta bëjmë punën tonë.

Vetëm dëshiroj të ftoj edhe një herë opozitën që të paraqes arsyet e vërteta, sepse për mua arsye e vërtetë më nuk është asociacioni, s'është as demarkacionit. Edhe njëra edhe tjetra e kanë zgjidhjen e vetë shumë të qartë, kurrkush nuk mund ta merr si kauzë asociacionin e komunave ose demarkacionin për të bërë veprime të tilla, për të djeg automobila, për të shkatërruar prona qeveritare, për të hedhur gaz lotsjellës, për të demonstruar dhunë në institucionet e Republikës së Kosovës. Duhet të jetë diçka më e madhe se sa kjo, sepse këto janë të zgjidhshme edhe njëra edhe tjetra e ka zgjidhjen e vetë, kurrkush nga ne s'e kemi rrezikuar sistemin kushtetues të këtij vendi në mënyrë që dikush del me dhunë të tentojë..., sepse nuk mbrohet sistemi kushtetues duke e rrënuar Kushtetutën, nuk mbrohet sistemi kushtetues duke e penguar funksionimin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, ashtu vetëm rrënohet ne nuk e kemi penguar ne dëshirojmë të komunikojmë me opinionin, të komunikojmë me qytetarët tanë të ju themi atyre të vërtetën dhe të merret përkrahja e shumicës dërmuese të qytetarëve për veprime të caktuara të Qeverisë dhe Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe ne jemi të gatshëm atë ta bëjmë.

Jo me dhunë, ta bëjmë me argumente, ta bëjmë me argumente edhe demarkacionin edhe do t'i ballafaqojmë argumentet unë ju garantoj që do t'i ballafaqojmë argumentet për çdo centimetër tokë të Kosovës edhe çdo njëri pastaj do ta bart përgjegjësinë e vetë për punën që e ka bërë në qoftë se komisioni shtetëror ka bërë gabime do ta bartë përgjegjësinë, në qoftë se tjerët kanë

thënë të pavërteta edhe ata duhet të dalin publikisht edhe ta pranojnë se kanë një përgjegjësi të caktuar për konfuzionin që po krijohet në opinionin tonë.

Do t'ia lëmë një komisioni ndërkombëtar i cili do ta marrë gjithë dokumentacionin edhe të komisionit tonë, edhe të opozitës, edhe të ekspertëve le ta shqyrtojnë do ta vërtetojnë kufijtë nuk janë gjë abstrakte ata kufijtë kanë ekzistuar prej vitit '58 e këndeja na po thirrim '74, mirëpo janë kufijtë që janë të pandryshuar prej vitit '58 me pakon e Ahtisarit janë të përmbyllura 31 dhjetor 1988, si të tillë dhe të pranohet territori i Republikës së Kosovës në ata kufi prandaj s'ka askush pse hedh gaz lotsjellës, pse djeg automobila, pse i sulmon objektet qeveritare për këto gjëra, sepse janë gjëra, të cilat zgjidhen.

Unë i përkrahi të gjitha masat që i kanë marrë institucionet e Republikës së Kosovës sepse i kanë marrë masat mbi bazën e vendimeve, nuk i kanë kapërcyer në asnjë rast vendimet as të Kuvendit, as të kryesisë së Kuvendit, nuk e kanë kapërcyer as ligjin është situatë mjaftë e rëndë në të cilën ne po veprojmë, sepse është e vështirë që me rregulla normale të menaxhohet një situatë e cila është jo normale, kemi të bëjmë me sjellje jo normale, me sjellje të dhunshme, por unë mendoj që me arsyen që këtu po diskutohet në Kuvend edhe me përpjekjet që po i bën ky Kuvend edhe Qeveria edhe institucionet tjera ne do ta kapërcejmë këtë gjendje, mirëpo duhet edhe opozita të tregojë se ku i ka problemet e vërteta, sepse këto probleme nuk janë probleme të vërteta për një veprim të tillë ndaj vendit, ndaj shtetit sepse në këtë rast nuk po sulmohet Parlamenti, në këtë rast nuk po sulmohet Qeveria, në këtë rast po sulmohet dhe po atakohet shteti i Kosovës, shteti i ri i Kosovës këtë të drejtë nuk e ka askush ta bëjë.

Ne duhet ta mbrojmë këtë, ne duhet të kujdesemi për këtë shtet, sepse nuk është më Rezoluta 1244 e cila duhet të rikthehet edhe të na mbrojë shtetin, nuk janë misionet ndërkombëtare, të cilat duhet të vijjnë dhe të na mbrojnë shtetin, nuk është UNMIK-u i cili pastaj duhet të kthehet dhe të na i mbrojë këtë shtet, por duhet të jemi koshientë se ne duhet të marrim masa që ta kryejmë punën tonë, edhe ne jemi përgjegjës në qoftë se dështohet në këto unaza diku në mbrojtjen e sovranitetit tonë edhe në mbrojtje të shtetësisë, të cilën ne e kemi shpall. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, kryeministër!

Ne po vazhdojmë me seancën ndërkohë kryetarët e grupeve parlamentare në qoftë se harmonizojnë tekstin gjatë seancës ne e votojmë si deklaratë politike të Kuvendit, Shaip. Po shkojmë në konkludim, vazhdojmë me pikat e rendit të ditës.

A ke propozim, a? Urdhëro, Shaip!

SHAIP MUJA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë mendoj që nëse e analizojmë të gjitha palët obligimet edhe detyrimet zyrtare mund ta gjejmë edhe shpjegimin publik për popullin e Kosovës jo për opozitën, opozita i ka qëllimet edhe detyrimet çka donë ajo me bë, mirëpo ne duhet ta qartësojmë unë jam dakord në shumë pika me kryeministrin, mirëpo tha “konfuzionin që po futet disa edhe nga pozita edhe nga opozita për çështjen e demarkacionit” unë mendoj që proceduralisht janë bërë lëshime të cilat publikisht asnjë deputetë këtu nuk e ka të qartë se a është demarkacioni i vërtetë ky apo nuk është.

Dhe, nuk janë zgjedhur procedurat të cilat është zotuar në Parlament, me rezolutë dhe është obliguar Qeveria ta respektojë si pjesë paraprake para se të nënshkruhet. Është e arsyeshme që është nxituar nga interesi më i madh ndërkombëtar dhe kombëtar për të arritur qëllimet e MSA-së dhe të NATO-së mirëpo kanë mundur të kryhen të gjitha pyetjet dhe përgjigjet në komisione dhe pa ardhur në atë rrugë prapëseprapë nuk mundet të kalojë askund tjetër.

Kuvendi i Kosovës është formacioni i fundit përgjegjës kushtetues për ta ratifikuar një dokument të tillë i cili i jep vlerën juridike. Momentalisht dy marrëveshjet nuk prodhojnë asnjë efekt juridik, opozita e dinë qartë, mirëpo ne nuk jemi bërë si pozitë shpjegim të mjaftueshëm publik për ta bind edhe njëherë vetë deputetët mes veti edhe t'i kuptojmë edhe ne si pozitë, sepse unë nuk e di që dikush po del edhe nëpër media po thuhet "ejani në Kuvend të bisedojmë" në Kuvend nuk është dashur të bisedohet demarkacioni para se të kalojë nëpër komisione.

Prandaj ne kemi shkel Rregulloren edhe duhet të themi se kemi shkel edhe rregullat e informimit, edhe të obligimit që i kemi. Ndërsa, sa i përket problemeve që paraqet opozita në këtë rast zoti Ramush Haradinaj ka kërkuar demarkacionin, ndërsa bashkë dyzimi me "Vetëvendosjen" e cila e mbron Republikën e Kosovës që fatmirësisht ishalla kanë evoluar në sistemin përmbajtësor të vetvetes të menduarit, por unë mendoj që nuk po mbrohet republika, por nëse kanë qëllimin të rrezikimit të Republikës ka njerëz edhe në sistemin, edhe mbi sistem që nuk do ta lë këtë republikë të rrënohet pavarësisht kush donë ta rrëzojë, e kemi mbrojt, e kemi sjell por ne të marrim obligimet Qeveria të thotë kam gabuar këtu, do t'i kthehem kësaj procedurës, komisionit zoti kryeministër dy muaj e gjysmë tre muaj ke pasur mundësi ta sjellësh at komision.

Në ditën e parë kur është bërë incidenti s'është dashur më ne të mbajmë seanca, është dashur t'i japim përgjigje të saktë shkencore është kritikuar nga deputetët e juaj të LDK-së, është kritikuar nga deputetët edhe të kryesisë edhe të Parlamentit zoti Haliti e ka thënë vetë problemin e demarkacionit dhe unë nuk jam, unë vetë nuk jam ekspertë që të them kush e ka mirë dhe kush e ka keq. Pse ne s'po flasim kështu hapur, por po mendohejmë që ta krijojmë njëfarë dominimi të një reflektimi të një lidhësit të pashpjeguar.

Ne duhet të marrim guxim qytetarë dhe të bëjmë shpjegime dhe obligime. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Konkrete Adem, a po na jenip ti dhe Ismeti një përkufizim të emrave rreth deklaratës së Kuvendit.

ADEM GRABOVCI: Unë propozoj të krijojmë një grup i cili do të merret në hartimin e kësaj deklarate. Nga Grupi Parlamentar i PDK-së propozoj Selvije Halimin që të jetë në përbërje të këtij grupi, ndërsa për ato që tha zoti Muja unë mendoj se kryeministri ishte shumë i qartë, Qeveria duhet të analizojë dhe veprojë në përputhje me rrethanat që i dinë më mirë se sa ne, sepse kemi të bëjmë me një shtet mik me të cilin duhet të gjejmë gjuhën e përbashkët dhe unë besoj se Qeveria punon në at drejtim. Faleminderit!

KRYETARI: Ismeti e ka fjalën, Selvije Halimi është e propozuara.

ISMET BEQIRI: Unë e propozoj zotin Armend Zemaj.

KRYETARI: Armendi është nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Lista serbe, po ki të drejtë vetëm të merr prej listës serbe le ta kryejmë komisionin. Lista serbe, bëhet gati “6+” pastaj.

SAŠA MILOSAVJEVIĆ: Hvala, predsedniče!

Poslanička grupa Srpska lista predlaže poslanicu Milena Miličević za Radnu grupa.

KRYETARI: Faleminderit! “6+”? Urdhëro, i nderuar Kujtim!

KUJTIM PAÇAKU: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar “6+” propozon deputetin Fikrim Damka.

KRYETARI: Faleminderit! E përfunduar komisionin, pa grup Shaip Muja e ka edhe një propozim.

SHAIP MUJA: Zoti kryetar, me 15 tetor ky Kuvend e ka miratuar një rezolutë do t’i tregoj zotit Grabovci e ka në dokumente, pika 2 e Rezolutës thuhet: “për demarkacionin para se të vendoset nënshkrimi ndërshtetëror duhet të raportohet në komisionet përgjegjëse”.

Dhe në pikën 6 bëhet një “dhe pastaj të vendoset nënshkrimi në Qeveri. Pasi të kryhen këto të gjitha ne kishim bërë vetëm një ratifikim formal i cili do të ishte më shumë ceremonial, prandaj merri lexojeni i keni juristët pyetni a është shkel rezoluta apo jo.

KRYETARI: Propozimi Shaip pa grup kush ishte, për komision. Në emër të grupit pa grup. S’keni propozim, atëherë vazhdojmë jemi në situatën të pika e 7 e rendit të ditës, nuk kemi kuorum, kisha lut kryetarët e grupeve parlamentare.

Jemi 76 deputetë, me këtë situatën këtu, por në qoftë se mund të bëhen 80 ne po vazhdojmë me pikat e rendit të ditës. I kemi tri çështje shumë me rëndësi, të cilat presin 2/3 e votave.

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar miratimin e tij. Ftoj ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit zotin Kujtim Shala që para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Për të krijuar bazë ligjore dhe kushte sa më të mira për zhvillimin e veprimtarisë sportive, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit ka punuar me përkushtim për përgatitjen e Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive.

Siç është e njohur deri më tani nuk kemi pasur ndonjë akt normativ që do bënte të mundur trajtimin, rregullimin dhe përmbledhjen e dispozitave përkatëse për të adresuar dhe vënë në kornizat juridike problematikën e dhunës në sport dhe të sjelljeve të palejueshme në ngjarjet sportive. Me anë të këtij projektligji parashihen masat për parandalimin e dhunës dhe të sjelljeve

të palejueshme gjatë ngjarjeve sportive, obligimet e organizatorit në ngjarjet sportive, si dhe kompetencat e organeve zyrtare.

KRYETARI: Ju kisha lutur pak qetësi se ministri mund edhe të mos lexoj fare në qoftë se doni ju, por për t'i dëgjuar mirë.

MINISTRI KUJTIM SHALA: Ky projektligj rregullon, përcakton dhe njeh autoritetin e subjekteve që mund të organizojnë ngjarje sportive, kushtet të cilat duhet të plotësohen për t'u organizuar ngjarjet sportive, obligimet e subjektit i cili i organizon ngjarjet sportive, pastaj përcaktohet se çfarë konsiderohet dhunë dhe sjellje e palejueshme në ngjarjet sportive.

Dispozitat e Projektligjit për sanksionimin dhe parandalimin e dhunës në ngjarjet sportive janë në përputhje me dispozitat e Bashkimit Evropian dhe në pjesët e aplikueshme në Republikën e Kosovës është i harmonizuar me konventat evropiane mbi dhunën e spektatorit, dhe sjelljeve të pahijshme në ngjarjet sportive e në veçanti në ngjarjet e futbollit.

Ndërsa, sa i takon kostos buxhetore Ministria e Kulturës, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave kanë analizuar dhe kanë përgatitur vlerësimin e ndikimin financiar të këtij projektligji, si dhe ka paraparë masa dhe aktivitet që do të realizojnë funksion të zbatimit të tij. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, pas prezantimit të Projektligjit hapi debatin për diskutime në parim. Kryetari i Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport zotin Nait Hasani.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

E shoh që pak janë të interesuar deputetët që të dëgjojnë. Po ashtu, edhe Qeveria po më duket. Komisioni në parim e ka shqyrtuar Projektligjin për dhunën në ngjarjet sportive.

Pas shqyrtimit të Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive vlerësojmë, se projektligji plotëson kushtet e parapara me nenin 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandojmë Kuvendit për miratimin në parim të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Është mirë të kemi qetësi. Kryetarët, përfaqësuesit e grupeve parlamentare PDK-ja, LDK-ja, "Nisma", AAK-ja, "Vetëvendosja", Lista serbe, "6+"-i. Bekim Haxhiu e ka fjalën. Para dy vjetësh e ka sponsorizuar, tash...

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar i Kuvendit!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Po flas në cilësinë e deputetit, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike ka shqyrtuar projektligjin dhe e ka analizuar me vëmendje, i jep përkrahje dhe mbështetje këtij projektligji. Gjithashtu, për vëmendjen dhe rikujtesën tuaj potencoj, se në vitin 2013 Kuvendi i Kosovës ka debatuar për sportin dhe gjendjen

e sportit në Kosovë dhe atëherë kemi nxjerrë rekomandime, ku kemi kërkuar që Kuvendi i Kosovës të miratojë tri ligje bazike për zhvillimin e sportit.

Unë e kuptoj që shumë prej deputetëve këtu do të sanksionoheshin pastaj me anë të këtij ligji, që e pengojnë zhvillimin e një aktiviteti dhe ky aktivitet tani është Kuvendi me zhurmën që po bëjnë, mirëpo atëherë kemi debatuar dhe kemi trajtuar që Kuvendi i Kosovës ka nevojë të aprovojë tri ligje: Ligjin për sponsorizimet; Ligjin kundër... dhe Ligjin për menaxhimin e objekteve sportive. Njërën nga këto ligje po e plotëson ministri i Sportit sot dhe shpresojmë, që shumë shpejt të na i sjell edhe dy ligjet tjera dhe ne si Kuvend t'i trajtojmë.

Konkretisht, mund të them lirisht që ky projektligj parasheh masat ndëshkuese dhe masat prevenuese për parandalimin e dhunës në sport. Mirëpo, ky ligj nuk parasheh sanksionimet konkrete për shkaktarët e dhunës dhe unë mendoj, që këto pastaj do t'i plotësojmë në komision bashkërisht, duke filluar edhe prej vet termit të projektligjit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, shumë! Urdhëroni zoti Salih Morina nga Lidhja Demokratike e Kosovës. Vetëm ju kisha lutur për pak qetësi!

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike ka shqyrtuar dhe analizuar këtë projektligj dhe në parim do ta mbështesim. Kontributin tonë do ta japim gjatë leximit të dytë. Njëkohësisht, i bashkëngjitëm kërkesës së kolegut deputet, Bekimit, që ministri i Kulturës për t'i kompletuar ligjet në aspektin e sportit sa më shpejt ta sjellë edhe Ligjin për sponsorizime, sepse do të jetë një ligj i cili do t'u shërbeje shumë klubeve sportive dhe sportit në përgjithësi në Kosovë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se të vazhdoj, kisha pasur dëshirë, i paskemi mediat të gjitha këtu. Në këtë ambient më mirë është të shkojmë në pauzë, ose ta dëgjojmë, për arsye se e humbim seriozitetin e kësaj situatë. A po e vazhdojmë seancën? Po vazhdojmë! Atëherë, ju lutem për vëmendje!

“6+”i, Lista serbe, dëshironi për këtë projektligj fjalën? “6+”-i, Nenad e dëshiron fjalën, apo?... Jo. Atëherë, përfaqësues i Qeverisë e kërkon fjalën? Jo.

Të nderuar deputetë, kërkoj nga administrata t'i thërrasin deputetët që të kthehen në sallë të Kuvendit. E di se kanë nevojë deputetët për pushim, por unë po i lexoj vetëm procedurat. Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive. Duhet shumica e thjeshtë, por duhet të jenë 61 deputet në sallë.

Vazhdojmë me tjetrën, mirë e keni.

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Projektligji është propozuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Qeveria e Kosovës nuk ka dërguar në Kuvend mendim lidhur me këtë projektligj.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim në parim.

Ftoj deputeten Sala Berisha-Shala në cilësinë e propozuesit, që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, kryetar i Kuvendit!

Përshëndetje Kabinet qeveritar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Medie dhe ju të pranishëm,

Unë nuk do të marr shumë kohë. Shkurtazi do ta bëj një ekspozë të ligjit. Jemi në rrethana të jashtëzakonshme dhe uroj që këto rrethana të jashtëzakonshme të mos na krijojnë situata të pakëndshme në të ardhmen të jashtëzakonshme.

Projektligjin e ka sponsorizuar Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Tregti dhe Industri. Kemi mbajtur edhe “work-shop”-e me aktorë relevantë, me institucione të cilat janë të thirrura ta zbatojnë këtë ligj. Projektligji ka 17 nene, nuk ka implikime buxhetore, është i harmonizuar me standardet e Bashkimit Evropian dhe, të nderuar deputetë, ju ftoj që ta mbështesni në parim dhe ta jepni kontributin tuaj gjatë fazës së amendamentimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, e nderuar deputete!

Të nderuar deputetë,

Pas paraqitjes së projektligjit hap debatin për diskutim në parim. Përfaqësuesi i Qeverisë e ka fjalën, nëse e kërkon fjalën, gjithmonë. Kryetarët ose përfaqësuesit e Grupeve Parlamentare? Deputetët, sipas paraqitjes. Përfaqësuesi i Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri nëse e do prapë fjalën?

Atëherë, në vazhdim kërkohet deklarimi për votim për miratimin në parim të Projektligjit për siguri në punë në veprimtari minerare. Po vazhdojmë ne. Është mirë të kthehen deputetët.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115

Po e tejkalojmë njëherë, se nuk janë 61 deputetë në sallë. Duhet me shmangie nga Rregullorja.

Kalojmë në pikën e 12-të. Na nevojiten deputetët në sallë, kijeni parasysh!

Po vazhdojmë me pikën e 12-të, por...

(Ndërprerje e incizimit)

Kryetarët e grupeve parlamentare. Unë mendova pak më herët, në qoftë se dëshironi pauzë, ose thërrisni deputetët. Atëherë, thërrisni deputetët. Le ta mbarojnë duhanin në korridor dhe le të kthehen.

(Ndërprerje e incizimit)

Jemi në pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive

Jemi në fazën e votimit. Të nderuar deputetë, me ngritje dore kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive. Gjithsej janë në sallë 66 deputetë. Kush është për? A ka kundër? A ka abstenim?

Me 66 vota për Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës në ngjarjet sportive. Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Jemi tek votimi!

10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare

Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare. Po shkojmë, kush është kundër? Kush është për abstenim? Atëherë të gjithë jemi për.

Kuvendi miratoi në parim me 68 vota Projektligjin për siguri në punë në veprimtarinë minerare. Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se kryeministri i Kosovës, zoti Isa Mustafa, ka parashtruar kërkesë për shqyrtimin e këtij projektligji me procedurë të përsheptuar, shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

Komisioni Funkcional për Zhvillim Ekonomik ka përkrahur kërkesën e kryeministrit Mustafa, që shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit të bëhet me procedurë të përsheptuar, shmangie nga afatet procedurale të parapara me Rregulloren e Kuvendit.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, zotin Muhamet Musrtafa, që të paraqesë propozimin për shmangie nga Rregullorja e Kuvendit.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri në mbledhjen e mbajtur më 4.12.2015 ka shqyrtuar projektligjin që e kemi në rend dite sot dhe ka vendosur, që të miratohet në parim projektligji nr. 05/L-080 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i cili ka qenë edhe një herë i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115.

Gjithashtu, Komisioni ka aprovuar kërkesën e kryeministrit që Kuvendi ta aprovojë këtë kërkesë për procedurë të përshpejtuar lidhur me aprovimin e këtij ligji. Shqyrtimi i parë i projektligjit duhet të bëhet sonte dhe pas aprovimit në parim të këtij shqyrtimi, ne duhet të tubohemi në Komisionin FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri dhe komisionet tjera të përhershme, në mënyrë që ta shqyrtojmë këtë projektligj dhe pas kësaj në një seancë që do të mbahej sonte duhet të aprovohet, pra ky projektligj. Aprovimi i tij është shumë me rëndësi, sepse në këtë mënyrë ne duhet ta bëjmë funksional në një afat sa më të shkurtër Bordin e Agjencisë Kosovare për Privatizim.

Së këndejmi, pra ftoj deputetët që të votojnë propozimin e komisionit për shmangie nga afatet procedurale, të parapara me Rregulloren e Kuvendit në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, për shqyrtim dhe miratim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit, të cilin sot e kemi në rend dite. Faleminderit!

Gjithashtu ju informoj, se ne e kemi aprovuar në parim këtë ligj dhe i propozojmë Kuvendit, që ta aprovojë në parim. Gjatë trajtimit anëtarët e komisionit e kanë vlerësuar rëndësinë e këtij ligji dhe në leximin e dytë do të ketë, ndoshta një amendamentim për ta precizuar më mirë funksionimin dhe autorizimet e Bordit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin e propozimit për shmangie nga Rregullorja në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit, lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e projektligjit të lartpërmendur.

E keni parasysh çfarë tha profesori. Leximi i parë, leximi i dytë pastaj bëhet në një seancë të re, pasi që të përfundojnë të gjitha pikat e rendit të ditës, sonte. Seancë e re, ta kemi parasysh.

Atëherë, a ka nevojë ta lexojmë çfarë thotë neni 84 i Rregullores së Kuvendit? S'ka nevojë. Duhen 2/3-at e të pranishmëve, jemi 70 deputetë. Votojmë!

Kush është për propozimin e profesorit Muhamet Mustafa në emër të komisionit? Kush është kundër? Abstenim? Nuk ka.

71 deputetë kanë qenë në sallë, 60 janë për, 9 kundër, një nuk ka votuar.

Atëherë, Kuvendi e miratoi propozimin për shmangie nga Rregullorja në përputhje me nenin 84 të Rregullores së Kuvendit lidhur me afatet kohore për shqyrtimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendi ia ka rekomanduar miratimin e tij. E ftoj kryeministrin e Kosovës, zotin Isa Mustafa, OK! Atëherë, ftoj që para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit, zoti kryetar!

Unë sot po prezantoj para jush Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115.

Po e shkurttoj pak këtë që kam shkruar për arsye të kushteve, në të cilat po punojmë.

Dëshiroj të them, se nxjerrja e këtij projektligji ka për qëllim ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave të caktuara në Ligj, me qëllim të sqarimit të emërimit të Bordit të drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, pasi që mandati i anëtarëve ndërkombëtarë ka qenë deri më 31 gusht të vitit 2014 dhe në Ligj nuk është përcaktuar qartë, se si do të veprohet me këto pozita pas datës 31 gusht të vitit 2014.

Në këtë projektligj përcaktohet që Bordi i AKP-së të përbëhet nga 8 anëtarë, 8 drejtorë. Në bazë të propozimit të Qeverisë Kuvendi emëron këta 8 anëtarë të Bordit duke përfshirë një përfaqësues të komunitetit joshumicë dhe një përfaqësues të sindikatave të Kosovës. Çështjet tjera nuk janë paraparë që të përfshihen me këtë plotësim dhe ndryshim të Ligjit, prandaj dëshiroj që edhe komunitetet që janë këtu, që kanë shprehur brengosje për të, që do të vazhdojë ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për AKP-në më vonë, në dispozitat tjera. Mirëpo, tash kemi qenë të detyruar që të bëjmë këtë ndryshim dhe plotësim, në mënyrë që ta mundësojmë që sot të zgjidhet Bordi i Agjencisë dhe kjo vetëm e përkufizon mënyrën e punës së Bordit, por jo edhe çështjet tjera të fushëveprimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, të cilat pastaj në një rast tjetër do t'i trajtojmë në këtë Kuvend.

Unë ju ftoj që ta aprovoni këtë dhe po ashtu, ju ftoj të keni durimin që sot ta aprovojme këtë ligj edhe në leximin e dytë, në mënyrë që sot ta caktojmë Bordin e Agjencisë së Privatizimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Të nderuar deputetë, pas prezantimit të projektligjit hap debatin për diskutim në parim. Profesori Muhamet Mustafa, në emër të Komisionit Funkcional nuk ka nevojë. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare, a ka dikush të flasë. Jo.

Deputetë, përfaqësues i Qeverisë, a ka dikush, se s'po shoh. Atëherë, vetëm po shkojmë drejt në votim. Në vazhdim kërkohet deklarimi... E dëshiron fjalën? Po, urdhëro. Armendi e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Pasi që jemi në procedurë të shpejt dhe u aprovua kjo dhe çështjet që kanë të bëjnë në mes dy leximeve, që i përket edhe Komisionit për Legjislacion, këto vërejtje janë më shumë parimore për Komisionin Funksional, te kriteret për përzgjedhjen e drejtorëve.

Domethënë te pika 6, “Asnjë person nuk mund të bëhet, ose të mbetet drejtor, nëse...” ajo duhet të ndryshohet, sepse po flet për përzgjedhje të reja dhe të cilët janë në harmoni me ligjin dhe 6.1, ku thotë: “Është i dënuar për kryerje të ndonjë veprë penale, që ngërthen elemente të mashtrimit. Pas një procedura përkatëse dhe në pajtim me standardet ndërkombëtare dhe kosovare.”

Unë mendoj që kjo duhet të jetë “është i dënuar për kryerje të veprës penale” dhe pikë, sepse nëse ia lëmë vepra penale veç të mashtrimit, ai domethënë mund të jetë i dënuar për vjedhje dhe vepra të tjera dhe mundet me qenë anëtar i këtij.

Ndërsa, edhe 6.2-shi pothuajse është i njëjtë dhe lë shumë hapësirë për manovrim dhe kur flitet për standarde ndërkombëtare, unë mendoj që duhet të përkufizohen në harmoni me ligjin. Standardet ndërkombëtare kuptohen nëse ne e respektojmë ligjin.

Domethënë, këto si vërejtje. Ka edhe dy-tri pika që ju i vëreni, nëse e ndryshoni të parën, i ndryshoni komplet kriteret për zgjedhjen e një anëtari të këtij bordi.

KRYETARI: Raifi e ka kërkuar fjalën.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Nuk desha ta marr fjalën, por meqenëse deputeti Zemaj theksoi lidhur me këtë propozimin për amendament, po them se në Komision ne kemi shqyrtuar këtë shumë mirë dhe i kemi përgatitur, pothuajse i gëmi gati edhe amendamentet edhe lidhur me çështjen të cilën e debatoi deputeti Zemaj.

Kështu që, ndër të tjera po i them vetëm dy si më të rëndësishme. Edhe në ligjin bazik edhe në amendamentet në projektligjin që po propozohet është e theksuar një shprehje, e cila nuk është kushtetuese. “Komuniteti joshumicë” kjo duhet të ndryshohet “komuniteti joshqiptar” është e duhet të ndryshohet, të bëhet “komuniteti joshumicë” në përputhje me Kushtetutën.

Tjetra, lidhur me propozimin për amendamentin 3 është neni 2, paragrafi 6, nënparagrafi 6.1 i ligjit bazik, në të cilin është thënë edhe komisioni është pajtuar unanimisht që duhet të ndryshohet, se “është i dënuar për kryerje të ndonjë veprë penale, që ngërthen elemente të mashtrimit, e të tjera...”, kjo nuk mjafton. Në një institucion kaq të rëndësishëm, siç është Agjencia Kosovare e Privatizimit të jetë vetëm për elemente të mashtrimit dhe të mos ngërthehen vepra të tjera penale, kjo është kufizim tepër i vogël. Çka të themi për kriminelë ordinerë, të cilët me ligj edhe mund të propozohen. Prandaj, propozimi im është ky dhe komisioni e ka përkrahur deri më tani. “Është dënuar për kryerje të ndonjë veprë penale me përjashtim të veprave të lehta penale të kryera nga pakujdesia, nga lajthimi faktik apo lajthimi juridik dhe për të cilat i është shqiptuar dënimi me burg në kohëzgjatje jo më shumë se 6 muaj, ose dënim me kusht. Mund të jetë dënim për gabim trafiku, i cili mund të ketë pasoja jo të mëdha. Ndërsa, të kufizohet vetëm në vepra penale të tilla, siç është vetëm mashtrim, kjo është pak, tepër pak. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Atëherë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Aktualisht në sallë janë 74 deputetë. Shkojmë në votim me ngritje dore. Kush është për?

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Kush është kundër? Kush abstenon?

Atëherë, me 64 vota për, 8 kundër, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në bazë të vendimit të seancës së sotme ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Muhamet Mustafa, që të para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Është në rregull.

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 7 amendamente, të gjitha janë me përkrahjen e Komisionit Funkcional. A ka kush kundër këtyre shtatë amendamenteve në tërësi? A ka kush... Armend, e dëshiron fjalën? Armendi e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Komisioni për Legjislacion i ka rekomanduar Komisionit Funkcional, sa i përket me amendamentin e parë dhe kjo është standard dhe praktikë parlamentare e hartimit të legjislacionit, të cilin e përdor Kuvendi i Kosovës.

Ju keni përdorur një përkufizim që thotë: “Ministria” dhe shpjegimin e keni dhënë “ministria kompetente” për emërtimet e origjinës dhe treguesve gjeografikë. Nuk duhet të jetë kështu, por duhet të jetë vetëm “ministria kompetente”, sepse nëse ju e përmendni edhe emërtimin e origjinës dhe treguesve gjeografikë, do të thotë që nënkupton që ju duhet të formoni edhe një ministri tjetër kompetente me Ligj. Kjo është në kuadër të ministrisë kompetente, e cila aktualisht është Ministria për Tregti dhe Industri, ndërsa kjo është për të dy projektligjet edhe ky projektligj edhe projektligji tjetër pasardhës. Duhet të përmirësohet, të mbetet vetëm ministria përkatëse, që është Ministria për Tregti dhe Industri.

KRYETARI: Faleminderit! Kryetari i Komisionit Funkcional.

MUHAMET MUSTAFA: E kemi diskutuar edhe në komision, nuk prish punë që të jetë “ministria kompetente”, “ministria përkatëse”, sepse në rast se bëhet ndonjë riorganizim në

Qeveri dhe mund të ketë emërtime të tjera të ministrive, mund të vijë deri tek problemi. Prandaj, unë mendoj se mund të aprovohet ky korrigjim në amendament.

Propozoj që të aprovohet intervenimi i deputetit Zemaj.

KRYETARI: Profesor, në cilin amendament ishte? Armend na e konkretizo pak më saktë! Deputetët, kur ta fusim në votim. Theksoje që ta evidentojmë, profesor, vetëm ta qartësojmë saktë se çfarë po votojmë.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Ka qenë një nga amendamentet që nuk kanë ardhur me kohë. Prandaj, ne nuk kemi mundur t'i aprovojmë për arsye se nuk kanë ardhur me kohë, por kjo këtu "ministria", amendamenti paragrafi 4, neni 4, paragrafi 1.1, riformulohet si vijon: "Ministria - ministria kompetente për emërtimet e origjinës dhe treguesve gjeografikë".

Mendoj që është në rregull që të aprovohet ky amendament sot.

KRYETARI: Atëherë, ndërhyrja është te amendamenti 1, propozimi i deputetit Armend Zemaj. Ta dëgjojmë!

ARMEND ZEMAJ: Kryetar, amendamenti 1 dhe amendamenti 2, në dy amendamente ka ndërhyrë Komisioni për Legjislacion, kompetencë e të cilit është. Pas shqyrtimit të amendamenteve në mes dy leximeve të komisioneve tjera e bën shqyrtimin për të rishikuar nëse është në harmoni me ligjet dhe Kushtetutën. Kaq.

Dhe tash, për ta pasur më të qartë, komisioni ka propozuar që të mbetet emërtimi "Ministria përkatëse për Tregti dhe Industri në kuadër të së cilës është Agjencia e Origjinës dhe Treguesve Gjeografikë", shumë qartë. E kuptuat? Bravo!

KRYETARI: Atëherë, është në votim amendamenti 1 me këto ndërhyrjet e deputetit Armend Zemaj.

Kush është kundër? Kundër janë 3 deputetë.

Abstenim? Kush është për? Kalon.

Amendamenti 2, sërish me ndërhyrjet e deputetit Armend Zemaj.

Kush është kundër? S'ka.

Abstenim? S'ka. Kalon me shumicën e 74 deputetëve.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Aprovohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Aprovohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Aprovohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Aprovohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Aprovohet.

Janë 70 deputetë në sallë. E votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Lus deputetët, që me ngritje dore të deklarohen kush është për, së pari? Kush është kundër? Kush abstenon?

Me 60 vota për, kundër s'ka, abstenim s'ka. Kuvendi miratoi Ligjin për treguesit gjeografikë dhe për emërtimet e origjinës.

Jemi tek shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnin industrial.

(Drejtimin e mbledhjes plenare e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Po vazhdojmë me pikën 13-të të rendit të ditës:

13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për dizajnimin industrial

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për dizajnim industrial dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij, me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Ju ftoj që t'i votoni amendamentet e propozuara nga komisioni, si dhe amendamentin nga Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete dhe Rregulloren e Kuvendit, etj., që precizon më mirë nenin 3, paragrafin 1.2, që riformulohet "ministër", pika 1.2, riformulohet si vijon: "ministër – ministri i ministrisë kompetente për pronësinë industriale", për të njëjtat arsye siç debatuar edhe më herët.

Domethënë, këto amendamente neve nuk na kanë ardhur me kohë, prandaj edhe nuk e kemi dhënë mendimin për to. Propozoj që sot t'i aprovojme. Faleminderit!

KRYESUESI: Atëherë, po vazhdojmë me amendamentet. Janë 13 amendamente.

Amendamenti 1 i propozuar është pa përkrahje të Komisionit për Legjislacion. Kush është për? Sa janë për amendamentin e parë, pa përkrahje të Komisionit për Legjislacion. Kundër? S'ka. Abstenim? Një. Miratohet.

Amendamenti 2 pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Kush është për? Kundër? Sa janë kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Kush është për? Kundër? S'ka. Me 66 vota për Kuvendi miratoi Ligjin për dizajn industrial.

14. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, zotin Mustafa, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Mustafa, a jeni dakord?

MUHAMET MUSTAFA: Kemi të bëjmë me një ligj mjaft të rëndësishëm, prandaj ju lutem për vëmendje!

Ne kemi formuluar amendamentet pas një konsultimi shumë të gjerë me të gjithë aktorët e interesuar. Ju ftoj që t'i aprovoni. Kemi sërish një amendament tek amendamenti 3, pa përkrahje të komisionit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, por mendoj se duhet të aprovohet ashtu siç e ka propozuar Komisioni Funkcional. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Po procedojmë me votim. Në sallë janë 66 deputetë.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3 pa përkrahje të Komisionit për Legjislacion, Mandate dhe Imunitete, po dihet ajo punë. Votojmë tani. Kush është për? Në rregull. Kush është kundër? Një është kundër. Abstenim? Nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21 pa përkrahjen e Komisionit për Legjislacion. Komisioni Funkcional e ka mbështetur. Kush është për? Kush është kundër? Një është kundër. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Kush është për? Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Me 68 vota për Kuvendi miratoi Ligjin për themelimin e Fondit kosovar për garanci kreditor.

15. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për provimin e maturës shtetërore

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për provimin e maturës shtetërore dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zotin Nait Hasani, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Hasani, e keni fjalën.

NAIT HASANI: Faleminderit, nënkryetar!

Kryetar,

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport Projektligjin për provimin e maturës shtetërore e ka shqyrtuar dhe ka mbajtur debate me drejtoritë komunale, me Këshillin e Maturës Shtetërore, Ministrisë, ka pasur sesione pune dhe ka nxjerrë amendamentet për plotësim dhe ndryshim.

Të gjitha amendamentet janë të harmonizuara nga komisioni dhe është kërkuar, që të paktën t'u jepet një mundësi, që nxënësit ta kenë një maturë më të mirë, të kenë edhe studime më të mira, ta kemi edhe një dije më të mirë në arsim. Me anë të maturës komisioni ka vlerësuar gjithë punën, si të ministrisë ashtu edhe të komisionit e të institucioneve tjera, që ky ligj është në përputhje me standardet që sot në rrethanat tona i duhen Kosovës.

Në debatet që i kemi pasur në Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj e Gjiilan dhe tri punëtori të tjera kanë rezultuar me amendamentimin e Projektligjit dhe nxjerrjen e përfundimeve. Prandaj, të gjitha amendamentet janë në harmoni dhe në pajtim me komisionin, që kërkojmë që bashkërisht t'i votojmë dhe t'i japim mundësinë që ta kemi një test të maturës shtetërore më të mirë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për amendamentin numër 4 janë dhënë dy propozime. Propozimi i parë është i Komisionit FunkSIONAL dhe propozimi i Komisionit për Drejtësi, Interesa të Komuniteteve dhe Kthim, pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL

Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës paraqitur në raportin e Komisionit FunkSIONAL.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4, kemi dy propozime:

a) Propozimi i Komisionit FunkSIONAL.

Kush është për? Kush është kundër? Një është kundër, dy, tre. Miratohet.

b) Propozimi i Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pa përkrahjen e Komisionit FunkSIONAL. Tash, rezultati ishte. Ne veç sa e qesim në votim kot.

Amendamenti 5.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17. Bekim Haxhiu e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kolegë deputetë,

Edhe në komision edhe në grup parlamentar kemi debatuar shumë, sa i përket amendamentit 17, gjegjësisht nenit 16 të ligjit bazik, pika 3, që ka të bëjë me pragun e kalueshmërisë në provimin shtetëror të maturës.

Ne si komision në koordinim me ministrinë e kemi lënë pragun e kalueshmërisë 40%, por vërtet do të doja që për këtë çështje kaq të ndjeshme, e cila ka të bëjë me cilësinë në arsim dhe me

objektivat edhe të Ministrisë së Arsimit për një ngritje graduale të cilësisë në arsim, mendoj që ky prag i kalueshmërisë do të duhej të ngritët gradualisht me vite. Për këtë i propozoj seancës që vërtet kjo ngritje e pragut të kalueshmërisë të jetë graduale dhe të jetë me vite.

Në vitin 2016 pragu i kalueshmërisë të jetë 40%, siç është propozuar në koordinim me ministrinë, në vitin 2017 të jetë 42%, në vitin 2018 të jetë 44%, në vitin 2018 46% dhe pas vitit 2020 pragu i kalueshmërisë të jetë 50%, me objektivat e Ministrisë së Arsimit dhe të Qeverisë për një ngritje graduale të cilësisë së arsimit. Faleminderit!

Përndryshe sa u përket propozimeve që i dhamë, ua jap edhe të shkruara administratës. Do të thotë, për çdo vit kemi nga një ngritje 2%, ndërsa prej vitit 2020 kemi një ngritje të cilësisë në arsim, që pragu i kalueshmërisë të jetë 50%. Faleminderit!

KRYESUESI: Nait, ke ndonjë koment? Në rregull.

Atëherë, unë e kam amendamentin 17. Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 29.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 30.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 31.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 32.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 33.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 34.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Kush është për? Kundër? 8 veta janë kundër. Konstatohet që Kuvendi miratoi Ligjin për provimin e maturës shtetërore.

16. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për rregullimin e shërbimeve të ujit

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj zotin Damka, që ta bëjë arsyetimin. Nuk ka nevojë, është dakord kryetari i Komisionit. Atëherë, futemi në votimin e amendamenteve.

Kemi gjithsej 13 amendamente.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5 është propozim i Komisionit për Buxhet i përkrahur nga Komisioni Funkcional.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6. Komisioni Funksional. Kërkohej deklarimi i kryetarit të Komisionit Funksional, zotit Damka. A ka nevojë? S'ka nevojë.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6. a. Komisioni për Buxhet i përkrahur nga Komisioni Funksional. Kush është për? Të gjithë janë për. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Kush është për? Kush është kundër? S'ka kundër. Abstenim? S'ka.

Konstatohet se Kuvendi miratoi Ligjin për rregullimin e shërbimeve të ujit. Janë 61 vota.

17. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për energjinë termike

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për energjinë termike dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri zotin Mustafa, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Zoti Mustafa... ah, Fatmir Rexhepi. Zoti Rexhepi e ka fjalën.

FATMIR REXHEPI: Komisioni Parlamentar dhe Grupi Punues i ka ofruar amendamentet, që besojmë se plotësimet dhe ndryshimet e mundësojnë që ky Projektligj të jetë më i zbatueshëm në

praktikë. I shtojmë kompetencat dhe përgjegjësitë te operatorët e caktuar. Po ashtu, i japim kompetenca edhe komunave në fushën e planifikimeve strategjike për energjinë termike, që s'ka qenë deri më tani, si dhe rritë një transparencë në mes konsumatorit dhe vetë operatorëve. Prandaj, propozojmë që ta miratoni. Faleminderit!

KRYESUESI: Në këtë projektligj kemi gjithsej 28 amendamente. Fillojmë me votimin.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 3.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 4.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 5, nuk paska hiç. Po, këtu s'e paskemi fare. A dëshiron të flasësh për amendamentin pesë? Mirë!

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,

Sipas amendamentit të pestë është dashur të zëvendësohet fjala “mbyllur” me “të drejtpërdrejtë” në nënparagrafin 1.30. Në ligjin bazik thuhet “sistemi i mbyllur i energjisë termike është sistemi termik, i cili mund të përfshijë më shumë ndërtesa industriale, komerciale, ...”. Ky ligj bazik është marrë prej ligjit të Kroacisë, aq sa kam parë unë, sepse fjalë për fjalë është përkthyer prej kroatishtes. Ndërsa, në amendamente thuhet që kjo të ndryshohet nga fjala “mbyllur” në fjalën “i drejtpërdrejtë”.

Kështu siç ka qenë në ligjin bazik është mirë, sepse në terminologjinë teknike të ngrohjeve qendrore ka të mbyllur dhe të hapur, “sealed central heating system layout”, ndërsa në ligjin kroat edhe në gjuhën angleze edhe në gjuhën kroate thuhet “i mbyllur”. I bie “closed heating system” dhe “zatvoreni”, me fjalë tjera nëse e ndryshojmë veç bëjmë gabim.

Në ligjin bazik ka qenë mirë dhe po që se ndryshohet, ia japim një terminologji e cila nuk do të thotë asgjë. Fjala “drejtpërdrejt” në këtë ligj nuk ka vend. Prandaj, ju ftoj që këtë amendament të mos e miratoni. Në komision nuk kemi arritur ta shtjellojmë aq sa duhet, tash kam argumente të bollshme, se edhe në ligjin kroat është kështu edhe në terminologjinë teknike është kështu, siç ka qenë në ligjin bazik. Amendamenti është i tepërt. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Fatmir, a keni për të thënë diçka? “Të mbyllur”, “drejtpërdrejt”, apo?...

FATMIR REXHEPI: Amendamentimi është në rregull, e ka shpjegimin e vet. Ne kemi debatuar, prandaj s'kemi nevojë të shtojmë këtu. Unë propozoj që ta votoni ashtu siç është.

KRYESUESI: Në rregull. Atëherë, komisioni është që të mbetet ashtu siç është.

Amendamenti 5.

A ka kundër? Nuk ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 6.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 7.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 8.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 9.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 10.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 11.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 12.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 13.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 14.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 15.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 16.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 17.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 18.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 19.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 20.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 21.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 22.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 23.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 24.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 25.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 26.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 27.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 28.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e miratuara. Votojmë tash! Kundër a ka? Nuk ka. Abstenim a ka? Nuk ka. Konstatohet që Kuvendi me 63 vota miratoi Ligjin për energjinë termike.

(Drejtimitin e mbledhjes plenare e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

18. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport, zotin Nait Hasani, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

NAIT HASANI: Faleminderit, kryetar!

Komisioni ka marrë Projektligjin për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve nga ministria dhe ka amendamentuar. Në bashkëpunim ka pasur edhe debate, dëgjime publike, ka takuar dhe kontaktuar drejtpërdrejt me Këshillin e Akademisë, akademikët, kanë qenë në takime tek ne,

kanë dhënë vërejtjet e sugjerimet dhe komisioni ka miratuar në përgjithësi amendamentet dhe në amendamentin 2 është pika e katërt “Akademia për punën e vet financiare një herë në vit informon Kuvendin e Republikës së Kosovës.” Kjo pikë është në projektligje të ndryshme të akademive. Republika e Shqipërisë e ka, Akademia e Shkencave brenda datës 15 të çdo viti paraqet informacion për veprimtarinë vjetore pranë Këshillit të Ministrave dhe kryeministrit.

Akademia e Kroacisë, në të cilën është bazuar edhe ligji, në nenin 7 thotë: “O svom radu u protekloj godini Akademija izveštava Sabor Republike Hrvatske”. Të njëjtën e ka edhe Akademia e Francës, të njëjtën e ka Akademia e Anglisë apo Britanisë së Madhe dhe pothuajse, të gjitha akademitë kanë këtë përgjegjësi.

Ne kemi pasur edhe një vërejtje, po ashtu te akademikët. Në amendamentin ku është kërkuar që anëtarët e Akademisë mbi moshën 70-vjeçare të mos jenë drejtues të Akademisë, të mos e udhëheqin. Kjo është një arsye që po të njëjtën e ka edhe Akademia e Francës, këtë na e kanë thënë edhe akademikët tanë, që i kemi pasur aty dhe kjo është një nga arsyet, që neve na jep mundësinë ta rinojmë Akademinë, ta bëjmë aktive Akademinë dhe ajo të jetë e gatshme të përballët edhe me sfidat e kohës. Vërejtjet që i kanë dhënë ata, kanë kërkuar që kjo moshë të jetë 75 vjet, por për ne ka qenë shumë e largët, prandaj aftësia udhëheqëse, menaxhuese, duhet të jetë pikërisht deri në moshën 70-vjeçare.

Prandaj, kërkoj që këto amendamente dhe këtë projektligj ta miratojmë dhe t’ia japim mundësinë Akademisë, që ajo të punojë dhe t’i përgjigjet vetvetes dhe institucioneve që e kanë zgjedhur. Faleminderit!

KRYETARI: Nait, faleminderit shumë, megjithëse kemi s’përputhje në qëndrimet tona të përbashkëta. Dyshi dhe dymbëdhjetëshi, e dëgjojmë përfaqësuesin e Qeverisë për amendamentet, sepse kemi qëndrim të ndarë.

MINISTRI ARSIM BAJRAMI: Faleminderit!

Falënderoj në mënyrë të veçantë Komisionin për Arsim dhe Shkencë, që ka bërë një punë shumë të mirë edhe te Ligji për maturën, që e votuam bashkë edhe te Ligji për Akademinë.

Tek Ligji për Akademinë ka qenë një praktikë shumë e mirë, sepse komisioni tërë kohën ka bashkëpunuar me Komisionin e Akademisë dhe ka pasur disa debate publike. Kjo është një praktikë e bashkëpunimit të shkëlqyeshëm me institucionet, të cilave u dedikohet. Shumica e amendamenteve janë plotësim i mirë i ligjeve, por unë do të kërkoja mirëkuptim për dy propozime.

Amendamenti 2, pika 4, kryetari i komisionit e riformuloi, tha se i përgjigjet për punën financiare. Unë mendoj se s’ka fare nevojë, sepse dihet është edhe auditimi i jashtëm, që kontrollon Akademinë, po ashtu edhe komisioni i zotit Ali Sadriu, që çdo kohë mund ta thërrasë Akademinë në raportim. Nuk kemi nevojë, sepse mund të keqkuptohet edhe me interpretime që Akademia duhet t’i raportojë për projekte shkencore Kuvendit të Kosovës.

Kështu që, kërkoj mirëkuptimin, se nuk kemi nevojë fare që ta kemi këtë paragrafin 4. edhe te mosha 70-vjeçare. Në fakt, ligji ka marrë masa që Akademia të përtërihet me njerëz të rinj, sepse kemi një nen i cili thotë se askush në Akademi nuk mund të pranohet pas moshës 65 vjeçare.

Pra, ne jemi marrë vesh se çfarë dëshirojmë të bëjmë në të ardhmen, por duhet ta marrim parasysh gjendjen ekzistuese në Akademi dhe ne mendojmë, se mosha 75-vjeçare duhet një moshë deri kur akademikët që janë tani anëtarë të Akademisë mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse. Pas kësaj moshe ata nuk kanë të drejtë dhe duhet të marrin parasysh edhe situatën aktuale në Akademi, sepse nuk mundemi me një veprim të menjëhershëm të bëjmë rinime.

Ne kemi vendosur pragun e dëshiruar, pra 65 vjet moshë më e vjetër e pranimit dhe mendoj, se po hapim rrugën që të pranohen njerëz sa më të rinj në Akademi. Kështu që, kërkoj mirëkuptim. Me zotin Hasani ne kemi biseduar. Ai sot... do të thotë, nuk kemi nevojë të themi se “jep raport për punën financiare”, sepse ai është obligim ligjor dhe fare s’kemi nevojë. Çdo institucion jep llogaridhënie për menaxhimin e Buxhetit.

KRYETARI: Faleminderit!

Salihu nga komisioni dhe Enver Hoxhaj të përgatitet, sepse ka qëndrim nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

SALIH MORINA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Kolegë deputetë,

Është e vërtetë se është bërë një punë e madhe në Komisionin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport dhe kanë qenë të angazhuar të gjithë anëtarët e komisionit, por ajo që vlen të theksohet është, se përfaqësues nga Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës kanë qenë prezentë edhe në dëgjimin publik, por njëkohësisht kanë qenë prezentë sa herë që ne kemi mbajtur takime gjatë leximit të dytë dhe kanë dhënë kontributin e tyre. Njëkohësisht, kanë sqaruar shumë çështje sa i përket Ligjit për Akademinë e Shkencës dhe Arteve të Kosovës.

Unë e mbështes ministrin e Arsimit në këtë rast. Është e vërtetë që në komision ka pasur edhe mospajtime. Kur kemi hyrë në votime ka pasur mospajtime po ashtu, por megjithatë edhe ministri i Arsimit potencoi se ne pajtohemi me amendamentin 2, por nuk pajtohemi tek amendamenti 2, pika 4, ku thuhet se “Akademia për punën e vet një herë në vit...” domethënë, këtu ka qenë “... informon Kuvendin e Kosovës, propozimi i kryetarit tash është që “t’i raportojë”, “t’i bëjë raport financiar”, por... bën informim, në kuptimin e asaj financiar, këtu nuk ka qenë “financiar”, kur e kemi miratuar ne. Por, mendoj se sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike çdo agjenci, në këtë rast edhe institucioni siç është Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës i raporton Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike.

Pra, raporti financiar shkon tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe në njëfarë forme domethënë, me raport financiar ky institucion i përgjigjet institucionit përkatës.

Ndërsa, te pika, te amendamenti 16, ku thuhet “prej moshës 70...”. Ne si komision në fillim i kemi ndryshuar gjithsej diku 18 amendamente, domethënë plotësim ndryshimin e kemi bërë në

bashkëpunim me përfaqësues të Akademisë së Arteve dhe Shkencave të Kosovës dhe propozimi ynë në fillim ka qenë që moshë të jetë 75-vjeçare, pastaj ka qenë një kërkesë e kryetarit të komisionit në këtë rast, që kjo moshë të zbritet prej 75 në 70, por ne mendojmë që nuk kemi nevojë të ndërhyjmë, sepse e sqaroi edhe ministri. Por, unë qëndroj që tek amendamenti 16, pika 5, anëtarët e akademisë mbi moshën 75-vjeçare nuk mund të ushtrojnë funksion udhëheqës dhe jo nën moshën 70-vjeçare, siç është dhënë propozimi nga disa anëtarë të komisionit.

Prandaj, ju ftoj deputetët që të përkrahin propozimin e ministrit dhe njëkohësisht të përkrahin edhe propozimin tim i nënkryetari këtij komisioni, në kuadër të Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport. Faleminderit!

KRYETARI: Enver Hoxhaj e ka fjalën. Pastaj përgatitemi për votim të amendamenteve një nga një.

ENVER HOXHAI: Faleminderit, zoti kryetar!

I nderuar zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Mendoj që është njëri prej ligjeve më të mira që ka një vend në rajon, sa i takon Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Dua ta përgëzoj ministrin për punën që ka bërë. Dua po ashtu, ta falënderoj kryetarin e komisionit, zotin Hasani, po edhe të gjithë anëtarët tjerë që kanë bërë një punë brilante, në mënyrë që ky ligj të jetë sa më i plotë.

Kemi dy shqetësime themelore. Shqetësimi i parë ka të bëjë me moshën. Mua ma merr mendja që në shkencë vlen parimi, që dija akumulohet. Një njeri mund të jetë me moshë më të thellë, por dija akumulohet dhe nuk është mirë që ju ta masni kapacitetin e të menduarit të një anëtari të Akademisë, në përputhje me moshën. Do të thotë, kreativiteti nuk varet prej asaj se dikush a del tetë orë në punë apo dhjetë orë në punë, nëse e ka këtë moshë apo atë moshë. Kështu që, ne duhet të sillemi në përputhje me standardet evropiane të cilat në shumicën e vendeve nuk e kanë të kufizuar moshën, se kur dikush mund të pranohet apo mund ta udhëheq akademinë, ose kur i skadon afati një akademiku. Mendoj që këtu duhet të jemi goxha të kujdesshëm.

Përtej kësaj, ne duhet ta kemi edhe një kontekst vendor. Ne kemi të bëjmë me një grup të njerëzve, të cilët kanë bërë shumë për këtë vend, të cilët i kanë prirë zhvillimeve politike dhe shkencore në këtë vend dhe në këtë drejtim nuk do ta bëja problem çështjen e moshës.

Ma merr mendja që ne si Kuvend i Kosovës duhet të asocohemi me atë se si ta përkufizojmë punën e Akademisë në përputhje me moshën.

Së dyti, ky është një institucion ku Kuvendi i Kosovës duhet të ketë pritje tjera. Ne po debatojmë për atë se ku duhet ta dorëzojë Akademia e Shkencave raportin financiar. Unë mendoj që dilemën kryesore që ne e kemi me Akademinë e Shkencave, është se cila duhet të jetë puna e tyre kërkimore, shkencore, hulumtuese dhe jo raporti financiar.

Kështu që, në emër të grupit tim parlamentar dua ta falënderoj ministrin për punën që ka bërë, si dhe komisionin parlamentar. Dhe, kur jemi në këtë sallë të improvizuar, ma merr mendja që kemi shqetësime më të mëdha, se sa mosha e anëtarëve të Akademisë dhe raporti financiar i Akademisë. Ky është qëndrimi i grupit parlamentar, unë po flas në emër të grupit parlamentar.

KRYETARI: Faleminderit! Nait, e dëshiron fjalën edhe një herë? Pse s'po pret kur e qesim në votim e në amendament të bësh vërejtje, se unë e qes edhe variantin... Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Në fillim falënderoj ministrin, i cili para se të vijmë në seancë kërkoi që pika e katërt e amendamentit të hyjë si çështje financiare, të mos jetë pjesë e projekteve, amendamenti dy...

KRYETARI: Po e specifikon amendamentin dy.

NAIT HASANI: Po. Të mos jetë që ata për projektet e tyre t'i raportojnë Kuvendit, por çështjet financiare. Secili shtet, ose kuvend, ose organizatë që zgjedh të paktën financiarisht tregojnë se ku e kanë shpenzuar buxhetin e vet. Ne nuk po kërkojmë se çfarë librash kanë shkruar, çfarë kanë bërë, cila është puna e tyre... Aty janë 44 punëtorë të Akademisë, kanë edhe administratë, marrin paga ata. Ata duhet t'i përgjigjen dikujt. Duhet të japin një llogari financiare, e të thonë "unë duhet dikujt t'i përgjigjem".

Prandaj, pika katër e amendamentit duhet të jetë, plus ka konflikt interesi tash në këtë rast, se është akademik, flet në emër të Akademisë bashkë me kryeministrin këtu, ja ku e kemi edhe profën atje, po më vjen mirë që s'po flet. Por, megjithatë në anën tjetër, foli në emër të grupit deputeti, më vjen mirë që foli, por nuk e tha atë që u desh të thuhet. Këtu kanë secili interesat ish-profesorë, ministra e të tjerë, që nesër të shkojnë pjesa e Akademisë edhe mos ta kenë atë kufizimin e moshës.

Kurrkush nuk mund t'ia marrë dijen akademikëve. Përkundrazi, akademikët e akumulojnë dijen, e marrin dijen. Ai akumulim nuk do të thotë që ata të jenë menaxherë të mirë, ata mund të jenë studiues të mirë të fushës së caktuar, ata mund të jenë edhe kuvendarë të mirë, kryeministra të mirë, krejt mund të jenë, por nuk mund të jenë edhe menaxherë të mirë të Akademisë. Prandaj, Akademia ka nevojë për rinimin e saj dhe ne e kemi qitur moshën 70-vjeçare. Nuk kemi nevojë t'i çojmë akademikët për dore atje në Kuvend. Nëse dëshironi, ja ku është ministri, kryeministri dhe deputeti që foli, e që ka pretendime që të bëhet akademik. Tash, në moshën 100-vjeçare... edhe ajo moshë 100-vjeçare jep mundësi edhe kështu, e keni pa limit këtë fushë. Prandaj, e rrisim këtë numër sa herë të duam. Po, nëse duam të kemi një ligj funksional, ne na duhet ligji që jep mundësinë që mosha 70-vjeçare është mosha maksimale që ai mund ta drejtojë Akademinë. Mosha 65-vjeçare që është kërkuar, ne nuk e kemi ndryshuar, që mos të pranohen pas moshës 65-vjeçare. Prandaj, ky është ai limiti dhe ne kërkojmë, e kemi pasur Mark Krasniqin 92 vjeç, askush nuk e ka ndalur, ka shkruar e punuar të gjitha ato, por nuk ka qenë udhëheqës i Akademisë.

Prandaj, nëse duam t'i çojmë për dore ne akademikët e t'ua tregojmë rrugën akademikëve tanë se kah duhet shkuar në Akademi, atëherë i lëmë ato që po kërkon ministri, që po kërkon Sala dhe deputeti që po dëshiron të jetë i mirësjellshëm. Por, Evropa i ka standardet e veta, standardet

evropiane në të cilat ne thirremi janë 70-vjeçare, prandaj thirruri në Evropën dhe veproni si Evropa. Faleminderit!

KRYETARI: Veç, u desh edhe liri për të krijuar të kemi si Evropa, më gjatë. Shkojmë amendament për amendament.

Amendamenti 1.

Kundër? S'ka. Abstenim? S'ka. Miratohet.

Amendamenti 2. Më lejoni, do t'i kemi dy propozime për hir të korrektësisë.

Akademia për punën e vet, është propozim i komisionit, informon një herë në vit Kuvendin e Republikës së Kosovës. Komisioni Funkcional, përkatësisht Naiti e ka këtë propozim. Por kijeni parasysh, Akademia është institucioni të cilit i bëhet çdo vit auditimi, e cila e ka një performancë të shkëlqyeshme. Vetëm se është një formalizëm i tepruar çfarë u vihet, edhe është gjynah t'u vihet. Ministri e dha propozimin e vet.

Kush është për propozimin e ministrit Arsim Bajrami? Kush është për? Pastaj dalim edhe te i juaji.

Kush është për propozimin e Nait Hasanit, cilin me e futë, ia imponon Akademisë me e informua një herë në vit? Propozimi i ministrit është për ta larguar atë pikë... dëgjo, po vjen duke votuar Nait, nuk e kam çështjen e konfliktit të interesit. Po votojmë, po i krijoj dy mundësi... Propozim! Edhe një herë Nait, nuk po krijojmë favore, këta deputetë do të votojnë.

NAIT HASANI: Favore, favore...

KRYETARI: Jo, kjo është imponim i yti për të mos na lënë të votojmë. Nait Hasani e ka propozimin që Akademisë t'i imponohet një herë në vit të japë raport financiar. Dëshironi ta përkrahni? Kush është për? Kush është kundër? Deputetë, kush është kundër propozimit të Nait Hasanit? Komisionit, pika e katërt. Po, Komisioni ka dalë kundër. Kush është kundër?

Dëgjo, derisa ne po flasim 38 janë kundër propozimit tënd, Nait. Vetëm 9 janë për.

Ne do të shkojmë me propozimin e ministrit Arsim Bajrami, që është i njëjti amendament, vetëm se i hiqet pika e 4-të "Akademia për punën e vet një herë në vit informon Kuvendin e Republikës së Kosovës" të largohet, mbetet amendamenti i njëjtë.

Kush është për propozimin e ministrit Arsim Bajramit? Amendamenti 2. Kush është për?

(Debat në sallë)

Vetëm pak! Kush është kundër? Një është kundër.

Nait, 66 deputetë janë në sallë, për janë 35, vetëm një është kundër, të tjerët abstenojnë.

Amendamenti i dytë duhet të kalojë sonte. Dhe, të jeni korrektë, merrni përgjegjësi, deputetë të nderuar, ose votoni për, ose votoni kundër! O Bekim, edhe tri ditë, veç po na dhunoni përmes qartësimeve, këto janë sende shumë të qarta. Çfarë dëshiron të na qartësosh më shumë? Urdhëro fol, pasi që ne nuk po marrim vesh, na e qartëso!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar kryetar,

Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë,

Po të ishte çështja e sqaruar, unë besoj se do të votohej më mirë. Dhe, po shihet që... nuk e kam ndërmend të bërtas, kush dëshiron të dëgjojë, dëgjon. Nuk e kam ndërmend të bërtas.

Është çështje që nuk është e sqaruar, prandaj e ke këtë rezultat, i nderuar kryetar. Po të ishte e sqaruar do të ishte mundësia të sqarohemi. Ne në komision vërtet kemi bashkëpunuar me Akademinë e Shkencave. Edhe këtu po them publikisht, që mendjet e ndritura të kombit nuk duhet t'i raportojnë për çështje të tilla Kuvendit të Kosovës. Ato duhet që me projekte shkencore të maten me akademitë tjera shkencore në Rajon dhe në Botë. Dhe, të lutem, ne po diskutojmë këtu për një raport financiar që duhet të na bien në Kuvend, nëse do ta zgjidhim ne punën e raportit financiar që na bien në Kuvend. Dhe çfarë na duhet ne ajo punë?

Ne kemi aprovuar një ligj, që vërtet i japim mundësi zhvillimit dhe hulumtimit shkencor. T'i japim mundësi zhvillimit dhe hulumtimit shkencor dhe ky ligj vërtet jep mundësi që Akademikët tanë të jenë konkurrues me akademikë në nivele botërore dhe evropiane.

Dhe, këto dy nene që janë këtu, nuk janë vendosur në komisionin parlamentar. Duhet të jem i hapur edhe me Naitin edhe me Salihun. Ia kemi lënë seancës që t'i miratojë, pasi që nuk ka pasur një akordim në mes kryetarit të komisionit dhe nënkryetarit të komisionit dhe ne si komision ia kemi lënë seancës të vendosë.

Unë po e them mendimin tim, që për këtë çështje nuk duhet Akademia ta informojë Kuvendin për punën shkencore, ndërsa raportimi financiar ka mundësi të raportohet edhe përmes mekanizmave, auditimit, Auditorit Gjeneral, komisionit përkatës... unë do të doja që vërtet akademikët tanë të na bien projekte shkencore dhe me ato ne të mburremi si deputetë, po edhe si qytetarë.

Ajo që po ndodhë sot, ne kemi kërkuar bashkë me ministrin që ta përtërijmë Akademinë. Është kërkesë jo vetëm e jona si deputetë, por është kërkesë e qytetarëve, që të ripërtërihet Akademia e Shkencave, në mënyrë që ajo në vitet e mëpastajshme të rinohet.

Faqja aktuale edhe e Ministrisë së Arsimit, po them lirisht, edhe e Akademisë deri më tani nuk ka qenë në promovimin e hulumtimeve shkencore dhe bërjen e shkencës në Akademi. Uroj që ajo të ndodhë që nga sot e tutje. Faleminderit!

KRYETARI: Unë do ta vazhdoj diskutimin. Vetëm ta kemi parasysh, se një shoqëri është bukur në krizë kur prej një Akademie që ka buxhet shumë të vogël mundohet gjoja t'i ndalë gjërat negative, një akademi që çdo vit boton edhe periodikun e shpenzimeve të veta dhe s'ka fare

buxhet. Po sido që të jetë, është në moralin tonë. Nuk është mirë të abuzohet përmes ngritjes së tematikës aq shumë për këtë çështje. Është më mirë të votohet.

Kush e dëshiron fjalën? Profesori Muhamet, Shpejtimi. Shpejtim...

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

SHPEJTIM BULLIQI: I respektuar, zoti kryetar i Kuvendit,

Kryeministër,

Zëvendëskryeministër,

Ministra,

Të respektuar deputetë,

Nuk e pata në plan që të dal ta marr fjalën për këtë projektligj, për arsye se ç'është e vërteta, ne kemi pasur një bashkëpunim jashtëzakonisht të mirë si komision me Akademinë e Shkencave dhe Arteve të Kosovës dhe pothuajse, komplet këtë projektligj e kemi hartuar me një marrëveshje me ta dhe në një bashkëpunim shumë të ngushtë, gjatë krejt kësaj faze.

Dola vetëm që për hir të opinionit të informoj, se nuk është e vërtetë që nuk kemi pasur konsensus në komision, por komisioni na ka mundur 3 : 2 me vota, sepse vetëm unë e Salihu kemi qenë kundër, 3 vetë kanë qenë për dhe ka ardhur në këtë formën çfarë ka ardhur në Kuvend, me këto dy ndryshime, si tek mosha edhe te dhënia e raportit.

Ç'është e vërteta për punë të projekteve dhe punë profesionale Akademia nuk ka nevojë që Kuvendit t'i raportojë, sepse s'është në rregull. Ndërsa, në aspektin financiar veç po dihet se kësaj i bëhet një lloj auditimi vjetor apo në çfarë forme shkon ajo, që unë nuk e di. Prandaj po them, ne le të shpresojmë që të punojnë ata njerëz që janë zgjedhur aty, t'i ndihmojnë këtë shteti, të punojnë projekte për të mirën e këtij shteti, sepse këto gjërat tjera mendoj se nuk janë... ose janë shumë irelevante në këtë rast. Plus asaj, kryetari i Kuvendit ka qenë për vizitë në Akademi dhe u ka premtuar akademikëve, që ligjin do t'ua aprovoj sido që ta bëni ju, prandaj ne është mirë që ta përkrahim këtë formë dhe të vazhdojë procedura. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, Shpejtim! Është çështja që çdokush i ka emocionet e veta. Në Kosovë Universiteti dhe Akademia ka qenë për secilin prej nesh diçka e veçantë, më e rëndë se sa në Kuvend, t'u krijohet gjyq i tillë... nuk e di pse! Pse? Se, çfarë buxheti ka Akademia, në radhë të parë të gjithë e dimë që s'ka fare buxhet. E dyta, t'ua kufizosh moshën 70-75-vjeçare është edhe ajo... A shkojmë në votim edhe një herë? Shkojmë, a?

Votojmë amendamentin 2 edhe një herë. I kemi dy propozimet... Urdhëro, Nait!

NAIT HASANI: Kryetar, më erdhi mirë që e përmendët Universitetin e Prishtinës dhe mendoj, se të gjithë ministrat këtu që i kemi kanë qenë pjesë e Universitetit të Prishtinës dhe ata që kanë studiuar në Universitetin e Prishtinës, të paktën kanë pasur një dinjitet. Dhe, ata kanë mësuar dhe kanë shkuar për dije. Të paktën, nuk e kanë menduar se si do t'u vijë fundi për një informatë, ose njoftim financiar, se ku do të bëhet.

Universiteti i Prishtinës i krijuar nga Kuvendi i Kosovës i përgjigjet dhe raporton për çështjet financiare në Kuvend të Kosovës. Nëse të gjithë i bëjnë raportet financiare e i bien këtu, atëherë pse një organ që ne e zgjedhim, të mos e bëjë? Ne nuk po kërkojmë cilin projekt e ka bërë, ose e bën filan akademiku, ne kemi mjaftë akademikë që me një libër kanë hyrë dhe ende janë aty me një libër. Ne kemi mjaftë akademikë, që asnjëherë nuk merren me studime por me pagat e veta, që i quajnë shpërblime. Por, nuk dua të merrem me atë çështje, le të mbetet çështje e tyre, e dijes dhe e dinjitetit, e ndërgjegjes së tyre të punës, se si e mbajnë titullin më të lartë shkencor në Kosovë. Por, neve na duhen akademikë, të cilët janë funksionalë që i përgjigjen kohës, që i përgjigjen zhvillimit të vendit, zhvillimit ekonomik dhe politik. Ata duhet të japin përgjigje.

KRYETARI: Ministri i Financave e ka fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

Vetëm një sqarim sa i përket raportimit financiar. Akademia e Shkencave është organizatë buxhetore. Çdokush që përdorë para publike i përfill dhe duhet të respektojë plotësisht rregullat e thesarit.

Raporti financiar i Qeverisë, që vjen një herë në vit edhe në Kuvend, e ka edhe Akademinë e Shkencave ku tregohet çdo cent se si është shpenzuar nga Akademia e Shkencave, plus një herë në vit Akademia e Shkencave i nënshtrohet auditimit të jashtëm.

Pra sa i përket raportimit financiar, këtu nuk ka asnjë nevojë të përfshihet ndonjë nen shtesë në këtë ligj. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Po shkojmë për të bërë debat. Dy propozime i kemi për amendamentin 2. Njëri është i Nait Hasanit, dhe po e quaj kështu, mos më keqkupto, pra i komisionit funksional, me pikën 4, dhe njëri është i ministrit Arsim Bajrami.

Atëherë, po shkojmë në votimin e amendamentit 2. Një herë po shkojmë me të Komisionit funksional sikur që Nait Hasani e qartësoi.

Kush është për propozimin e Naitit? 5 janë për.

A abstenon ndokush? 2 abstenime!

Kush është kundër?

Nait, jemi duke votuar. Pra me 42 vota kundër, 2 abstenime dhe 6 për dhe s'i kanë kaluar 67.

Kalojmë në propozimin, që është pa pikën 4, i ministrit të Arsimit. I njëjti amendament është, pa pikën 4.

Kush është për?

Kush është kundër?

A abstenon ndokush? 2 abstenime!

Nait, me 63 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, kalon amendamenti i ministrit të Arsimit. Urime dhe faleminderit!

Amendamenti 3.

Kush është kundër?

Kush abstenon? Kalon.

Amendamenti 4.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 5.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 6.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 7.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 8.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 9.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 10.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 11.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Te amendamenti 12, pika 5 është kontestuese. Nait! A dëshiron ta marrësh fjalën? Fjalën e ka Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit edhe një herë kryetar!

E bëni shkeljen... Ministri mund vetëm ta tërheq projektligjin, e amendament nuk ka të drejtë të vendosë dhe kjo është një shkelje që e bëri sekretari i Kuvendit dhe do të kesh përgjegjësinë.

Megjithatë për mua është amendamenti dhe pika 5 e amendamentit: Anëtarët e Akademisë mbi moshën 70 vjeçare, me votim në komision, Komisioni ka votuar që të jetë 70 vjeçare, me vota 3:2.

Tani është një çështje tjetër e seancës. Seanca mund të votojë të ndryshojë, të heqë, të plotësojë, por unë po e shoh që ne do t'i marrim akademikët për dore do t'i çojmë atje dhe do të ju tregojmë çfarë përralla të shkruajnë atje se disa e kanë edhe atë sesion të përrallave dhe ne që 20 vjet nuk kemi asnjë program të Akademisë, vetëm i kemi përrallat e Akademisë për të ardhmen. Faleminderit!

KRYETARI: Ministri i arsimit do të japë variacionin pse Akademia e konsideron si 70 vjeçar. 70 vjeçar do të thotë me mbet Akademia pa organe udhëheqëse shumë shpejt, për arsye se kjo është gjendja reale e Akademisë.

Në qoftë se propozohet propozimi i Komisionit funksional, Akademia mbetet pa organe udhëheqëse shumë shpejt.

Atëherë, prapë i kemi 2 propozime.

(Ndërhyrje)

Jo, jo! 75 vjeçar. Është propozimi i dytë, pika 5 vetëm ndërrohet “mbi moshën 75 vjeçare nuk mund të ushtrojë funksione udhëheqëse”.

Atëherë po shkojmë te propozimi i Naitit që ia kufizon Akademisë deri në moshën 70-vjeçare.

Atëherë, kush është për?

NAIT HASANI: E kam propozimin më kanë quajtur me këtë formën edhe të amendamentit financiar sovjetik thoshin. Më kanë quajtur anarkist dhe sovjetik. Të lutem!

Unë propozoj që në sistemet sovjetike mund të themi komuniste apo qysh doni, ka pasur zgjedhje dhe nuk ka pasur shkarkime. Pra, në atë moment kur janë zgjedhur kryetar, deri e kanë krye, veç zoti i ka ndalë... Prandaj unë po kërkoj që ta kemi sistemin sovjetik të akademisë, na pëlqen më mirë dhe na bie tamam. Faleminderit!

KRYETARI: Edhe një herë! Në qoftë se e votojmë amendamentin e Naitit, Naiti pa të drejtë ka punuar shumë por pa drejtë edhe po hidhërohet. Organet udhëheqëse të Akademisë, e kemi këtu edhe akademikun Arsim Bajrami, i kemi edhe tjerët të cilët janë të asociuar, por mbete pa organe udhëheqëse Nait. Këtë e din këtë.

Atëherë, janë dy propozime, propozimi i Komisionit Funksional, që e prezantoi Naiti, që ua kufizon në 70-vjeçar.

Kush është për? Abstenim?

Kundër kush është? Nuk kalon.

Atëherë ndërrohet pika 5 me propozimin e ministrit Arsim Bajrami. “Anëtarët e Akademisë mbi moshën 75-vjeçare, nuk mund të ushtrojnë funksione udhëheqëse”.

Amendamenti 12.
Kush është për? 61.

Kundër?
Abstenim?
Me 61 vota, kalon amendamenti 12, propozimi i ministrit Arsim Bajrami “75 vjeç”

Amendamenti 13.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 14.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 15.

Amendamenti 16.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 17.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 18.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 19.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 20.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 21.
Kundër?
Abstenim? Kalon.

Amendamenti 22.
Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 23.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Amendamenti 24.

Kundër?

Abstenim? Kalon.

Tani e votojmë tekstin e projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.

Lus të deklarohen deputetit me ngritje dore.

Kush është për?

Kush abstenon?

Kundër?

Me 67 vota miratohet ligji. Ia uroj ligjin Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës.

19. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për buxhet e financa, zotëriun Naser Osmani që para deputetëve të paraqet dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

Është në rregull, a?

Për këtë projektligji janë propozuar gjithsej 5 amendamente nga Komisioni funksional.

Naim, a e deshe fjalën? Urdhëro, para se të futemi në votim!

NAIM FETAHU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministra,

Kabinet qeveritar,

Sa i përket pikës 19 - Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit numër 03/R-048 për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin numër 3/L-221, numër 04/L-116 dhe numër 04/L-194, unë kam një propozim tek amendamenti numër 6 që ka të bëjë me organizimin e buxhetit dhe ky amendament të hiqet.

Mendoj që organizimi që ka ekzistuar në ligjin bazik ka qenë funksional dhe kërkoj që ky amendament të hiqet dhe të mbetet ashtu siç ka qenë në ligjin bazik. Faleminderit!

KRYETARI: Kryetari i Komisionit Funksional, çfarë qëndrimi ka?

Atëherë, ne duhet të shkojmë në bazë të kësaj që e keni marrë, qëndrimi i deputetëve është.

Amendamenti 1.
Kush është kundër?
Abstenim? Aprovohet.

Amendamenti 2.
Naim, cilin amendament e patët...? 6, por 5 i kemi vetëm.

NAIM FETAHU: Unë e kam fjalën për Projektligjin që është ardhur për plotësim-ndryshim kryetar dhe besoj që, nëse nuk e keni, mund të ua ofroj të shkruar. Faleminderit!

KRYETARI: Në ndërkohë, deri sa të lexon, se diku ka shkruar 6 diku 5.

NAIM FETAHU: Unë kryetar kërkoj që nenin 6 të Projektligjit ta heqim dhe këtu e kam kopjen time, që mund tua ofroj.

KRYETARI: Kryetari i Komisionit FunkSIONAL e ka fjalën!

NASER OSMANI: Unë kërkoj falje, nuk desha edhe ta marr fjalën meqë jemi lodhur dhe jemi në çfarë kushte jemi.

Komisioni i ka bërë gjithsej 5 amendamente, pranë të cilave qëndron që vetëm këto 5 amendamente të votohen. Këtë që po e propozon kolegu, është amendament i ri dhe këtë Komisioni nuk e ka marrë parasysh dhe e ka lënë ashtu si e ka prua në ndryshim të ligjit Qeveria dhe e ka përkrahë, do të thotë, ashtu si është dhe mbetemi ashtu si e ka prua Qeveria. Nuk është amendament i Komisionit dhe asgjë që nuk është amendament i Komisionit të mos aprovohet.

KRYETARI: Në ndërkohë, për amendamentin 2 merruni vesh ju. Naim, konsultohu.

Amendamenti 3, kurse amendamentit 2 i kthehemi në fund, kur të konsultoheni ju për çfarëdo qëndrim.

Pra, amendamenti 3.
Kush është kundër?
Abstenim? Aprovohet.

Amendamenti 4.
Kush është kundër?
Abstenim? Aprovohet.

Amendamenti 5.
Kush është kundër?
Abstenim? Aprovohet.

Për amendamentin 2, po e shoh që Grupi ynë parlamentar...
Naser, jemi kthyer te amendamenti 2 të Komisionit.

Kush është për amendamentin 2?
Kush është kundër?
Kush abstenon? 1 abstenim!
Amendamenti 2, nuk kalon!

40 vota i keni! Për t'u aprovuar duhet të votojnë 60. I keni 40 vota!

Dëgjo, a i hymë edhe një herë votimit? Thirri edhe një herë deputetët.
Unë po shoh se këta po votojnë kundër, kjo është arsyeja, pra s'po donë ta votojnë dhe për atë u thashë, merruni vesh në mes veti.

Jo, ligji mund të kalojë pa amendament. Ligjin s'mund ta bllokoni, mund të bllokojë një amendament.

I keni 41 vota. A po doni ju të koalicionit të merreni vesh për të marrë pauzë apo për të vazhduar.

Atëherë, amendamenti 2 nuk kalon.
Tani e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me 4 amendamente të miratuara, kurse amendamenti 2, nuk ka kaluar.

Pra tash e votojmë tekstin në tërësi, pa amendamentin 2. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim me dorë për ligjin në tërësi, pa amendamentin 2.

Kush është për?
Kush është kundër?
Abstenim?
Me 62 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, konstatoj se Kuvendi e miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

20. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Ftoj kryetarin e Komisionit funksional për buxhet e financa Naser Osmani që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime. Në rregull!

Në këtë projektligj janë propozuar gjithsej 21 amendamente nga Komisioni funksional dhe të gjitha me përkrahjen e Komisionit funksional dhe në qoftë se ju pajtoheni shkojmë nga amendamenti 1 deri 21.

Kush është kundër? Në cilin e ke Armend? Urdhëro, më mirë merre fjalën!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë që e keni përkrahur. Vetëm ta sqarojmë. Dëgjo, të shohim por një herë të japi shpjegimin dhe mund të flisni se ne në seancë jemi.

Bordi i KRPP-së përbëhet prej 3 anëtarëve. Pikë! Anëtarët e KRPP-së emërohen për një mandat 5 vjeçar pa të drejtë riemërimi, rekomandim të cilin e ka dhënë Komisioni për legjislacion dhe e keni përkrahur. Pas kësaj prapë mbetet një tekst, që vazhdon dhe unë propozoj të hiqet ky dhe tash ky është propozimi që e kemi dhënë: Bordi i KRPP-së i emëruar nën miratimi në mëhershëm, do të mbajë mandatin deri te skadimi të atij emërimi, presje dhe në çdo rast, presje, deri sa të zgjidhen anëtarët e ri nga Kuvendi. Me ligj nuk i vazhdohet kurrkujt mandati.

Në momentin që i kalon me ligj, propozuesi është i obliguar paraprakisht me ia pru Kuvendit për miratim. Andaj, kjo duhet të jetë deri te pika dhe jo këtu ku i lejohet - vazhdimi i mandatit, sepse mund të jetë vazhdimi i mandatit pa fundësi, me pas neglizhencë të procedurave dhe kështu një mandat nuk është më 5 vjeç por mund të jetë 6 vjeç.

KRYETARI: Është pika 21. Je duke folur për amendamentin 21.

ARMEND ZEMAJ: Është amendamenti 13, i nenit 51, të cilin këta e kanë riformuluar.

KRYETARI: Atëherë, shkojmë, ta kryejmë me amendamentin 13. Pra, amendamenti 1 deri 21, pa amendamentin 13.

Atëherë, kush është kundër në tërësi, pa 13 kurse 13 mbetet i veçantë.

Kush është kundër?

A ka që abstenon?

Aprovohen amendamentet 1 deri 21.

Tani kemi amendamentin 13. E kemi një propozim nga Komisioni funksional, por e kemi edhe një ndërhyrje nga deputeti Armend Zemaj.

Atëherë, a ka mundësi Komisioni Funksional të na japë një pozicion më të qartë, apo të hyjmë me dy propozime?

NASER OSMANI: Kryetar, Komisioni e ka marrë për bazë rekomandimin e Komisionit për legjislacion që ka të bëjë me mandatet e KRPP-së. Përndryshe në të njëjtin rekomandim e kemi marrë edhe për organin e OVSH-së, do të thotë e kemi bërë në mënyrë unike dhe e kemi lënë që këta që kanë mandat 5 vjeç, mos me pas të drejtën e riemërimit, por në momentin kur i skadon mandati dhe Qeveria nuk e ka dërguar ta plotësojë, ai vazhdon punën për arsye që ka të bëjë me forum. Pra, nuk mund të mbetet vendi vakant deri sa nuk e çon Qeveria emrin e ri. Kjo është bë për këtë arsye.

Përndryshe, ata nuk kanë të drejtë të riemërohen në pozitën e njëjtë.

KRYETARI: Atëherë, Komisioni funksional propozon të votohet ashtu si është.

Së pari, kush është kundër? Gjithmonë kemi të bëjmë me Komisionin funksional dhe gjithmonë po shkojmë me propozim të Komisionit funksional.

Kush është kundër? 5!

Abstenim?

Atëherë, të gjithë tjerët a konsiderohen të aprovuar.

Sa deputetë janë? Janë 65 deputetë!

Kanë abstenuar 5!
60 janë për.

Tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara.
Votojmë me ngritje dore!

Kush është për?
Kush është kundër?
Abstenim?

Atëherë, me 65 vota për, Kuvendi e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për prokurimin publik të Republikës së Kosovës.

21. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës

Më falni! Sa vetë duhet të tërhiqen të Komisionit që të mos bëjmë pauzë? Jemi 65. Mund të tërhiqen 4-5.

(Ndërhyrje)

Atëherë, po vazhdojmë edhe për këtë pikë, e pastaj do të kemi pauzë për t'ia dhënë mundësinë Komisionit funksional.

(Ndërhyrje)

Vazhdojmë!

Atëherë, Komisioni Funksional për Legjislacion, e ka shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Kuvendit i ka rekomanduar për të mos e miratuar.

Ftoj raportuesin e Komisionit funksional për legjislacion, zotëriun Armend Zemaj që para deputetëve të paraqet dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Ashtu, sikur që e potencuat, Komisioni për Legjislacion ka rekomanduar që të mos miratohet Projektligji Numër 05/L-070 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Numër 03/L-224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, me këtë arsyetim:

Komisioni për legjislacion e ka shqyrtuar Projektligjin e theksuar dhe ka rekomanduar për mosmiratimin e tij.

Komisioni gjatë shqyrtimit të Projektligjit, pas debatit ka qenë konstatim i përgjithshëm se neni 1 i Projektligjit përkatësisht mundësia e zgjedhjes së një anëtari të Këshillit edhe për një mandat

shtesë, të njëpasnjëshëm, u vlerësua se është në kundërshtim me opinionin e Komisionit të Venedikut i dhënë sa i përket Këshillit Prokurorial edhe në vendin tonë.

Ndërsa lidhur me nenin 2 të Projektligjit që ka të bëjë me mandatin e anëtarëve të Këshillit aktual, u konstatua se dispozitat e legjislacionit në fuqi janë mjaftueshëm të qarta dhe si të tilla përcaktojnë që Këshilli të fillojë punën në përbërje të re nga 1 janar 2016 dhe një formulim i tillë është tërësisht i panevojshëm.

Andaj, duke pasur parasysh fakte të theksuara u vlerësua se Projektligji i ka 2 nene - dispozita përmbajtësore, të cilat nuk u përkrahën nga Komisioni, i njëjti mbetet pa përkrahje dhe si i tillë rekomandohet të mos miratohet.

KRYETARI: Faleminderit! Urdhëroni! Ministri e ka fjalën!

MINISTRI HAJREDIN KUÇI: Faleminderit kryetar i Kuvendit!

Më lejoni që t'jap një tri sqarime. E para, ky propozim i Këshillit Prokurorial të Kosovës, e dyta ka ardhur si rezultat në amendamentimin e ligjit paraprak, Komisioni për legjislacion ka bërë ndërhyrje që e ka vënë në siklet funksionimin dhe e treta, pajtohem për nenin 1 që mund të hiqet, por neni 2 që ka të bëjë me dispozitat kalimtare nuk e dëmton ligjin aktual, përkundrazi e sqaron që ka të bëjë me mandatin aktual dhe shumica e anëtarëve prokurorë tanimë janë të zgjedhur, dhe unë besoj që neni 2 respektivisht neni 44a pika 1 dhe 3 duhet të miratohen. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, të nderuar deputetë, në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për Projektligjin. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMA: Është e vërtetë që ky propozim ka dalë i sponsorizuar nga Qeveria e Kosovës por me opinionin e Këshillit prokuroria dhe dilemat që i kanë pasur ata gjatë kësaj periudhe pas miratimit të këtij ligji, sepse ky ligj është miratuar pak muaj më parë.

Edhe sot, paraprakisht kur diskutuam përcaktimi i Komisionit bashkërisht edhe me partnerët që e mbështesin Kuvendin e Kosovës, ka qenë që nuk është e shëndoshë për vet Këshillin Prokurorial - Këshillin Gjyqësor vazhdimi i mandateve të njëpasnjëshme dhe kjo është treguar qartë, e u përkrah edhe nga Komisioni edhe nga sponsorizuesi, por edhe nga vetë Këshilli Prokurorial.

Për dy nenet që u potencuan, do të thotë që ka dispozita tjera, neve qartë, në koordinim edhe me partnerët tjerë, por edhe me vetë Këshillin Prokurorial dhe Këshillin Gjyqësor është potencuar që më nuk janë objekt sepse 1 janari 2016 veç është ofruar dhe kjo nuk lë ndonjë dilemë, e ju e keni parë se tash është zgjedhur edhe Këshilli i ri prokuroria, që u kanë dhënë hapësirë nga të gjitha prokuroritë, nivelet e prokurorive dhe 3 anëtarë që janë 'ex officio', sigurisht se edhe ata do të zgjidhen dhe do ta marrin mandatin e ri nga 1 janar 2016.

Unë sa e kuptova, edhe vetë ministri e ka çështjen për këto tri pozicione, por Komisioni ka menduar që një këshill i ri prokuroria tërësisht me një kryetar të ri, është vlerësuar se do të jetë në të mirën e prokurorisë por edhe të avancimit të performancës së punës së tyre.

KRYETARI: Me gjithë këtë, ne në fund duhet të deklarohe mi votim për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

Komisioni funksional ka rekomanduar që ky projektligj të mos miratohet.

E patëm dhe dëgjua m edhe qëndrimin e Qeverisë. Ne do të votojmë për propozimin e Komisionit funksional që të mos miratohet.

Sa për qartësim, nëse votojmë për, nuk miratohet.

(Ndërhyrje)

Atëherë, si me e zbut unë këtë thënie?

Po vazhdojmë me votimin.

Kush është për Komisionin Funksional për mosmiratimin e Projektligjit?

Mund të theksojmë se 61 janë për mosmiratimin.

Kush është kundër?

Kush abstenon? 5 abstenojnë.

Atëherë, me 61 për, 5 abstenime, Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Këshillin Prokurorial të Kosovës.

22. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Urdhëro, zëvendëskryeministër!

ZËVENDËSKRYEMINISTRI KUJTIM SHALA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Meqë Qeveria ka nevojë të bëjë disa konsulta shtesë, e tërheq këtë Projektligj.

Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, e konsiderojmë që e përfundua m. Faleminderit!

Jemi te pika e rendit të ditës, e cila meriton spostim. Urdhëro, profesor! Jo, është tërhequr, tash jemi te anëtarët e Bordit të AKP-së.

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem, propozoj në emër të Komisionit që të bëhet pauzë dhe Komisioni ta paraqet ligjin e propozuar për leximin e dytë, sepse s'mund të kryhen asnjë pikë më. Ju lutem, propozoj të kemi pauzë!

KRYETARI: Atëherë, po vazhdojmë! Profesor, do t'i vazhdojmë dhe përfundojmë edhe 3-4 pika, por kështu e ashtu, i kemi edhe 2 pika.

MUHAMET MUSTAFA: Zoti kryetar, ne duhet të kemi një seancë të veçantë pas leximit që e bëjmë. Prandaj, nuk mund të kalojmë në pika pa e kryer këtë seancë.

KRYETARI: Dëgjo, profesor! Është në rregull, do të vazhdojmë edhe me dy pika, kurse pika 23 shtyhet për më vonë. Tash jemi në pikën 24 dhe do të marrim pauzën sepse i duhet Komisionit funksional.

(Ndërhyrje)

Pikën 23 e tërhoqëm apo tejkaluam dhe pa e kaluar ligjin ne nuk mundemi... sepse është çështje inekzistente, megjithëse edhe kur ta kalojmë ligjin pastaj do të bashkëbisedojmë për këtë pikë.

Atëherë, kush propozon që të tërhiqet? Komisioni, a e tërheq pikën 23? Po de, tërhiqeni, se unë s'mundem si kryetar i Kuvendit. Urdhëro kryeministër!

KRYEMINISTRI ISA MUSTAFA: Faleminderit!

Është një arsye procedurale që neve na shtyn tash ta tërheqim pikën 23 përkatësisht Bordin për AKP-në dhe ta propozojmë pasi që të bëhet ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit të AKP në mënyrë që propozimi pastaj të jepet bazuar në ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të AKP në seancën tjetër.

KRYETARI: Faleminderit! Atëherë, pika 23 tërhiqet dhe mbetet për seancën e radhës.

24. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Në ndërkohë, edhe kandidati i propozuar, zotëri Qemajl Mustafa e ka dërguar dokumentacionin e kërkuar nga Komisioni funksional.

Përfaqësuesi i Qeverisë nuk e do fjalën!

Kryetari i Komisionit funksional, nuk e merr fjalën!

Përfaqësuesit e grupeve parlamentare? Nuk e marrin fjalën!

Deputetët? Nait Hasani e ka fjalën! Më falni, i japim përparësi profesor Mustafës!

MUHAMET MUSTAFA: Ju lutem, ne kemi diskutuar këtu shumë. Janë disa rekomandime të Komisionit për të cilat dëshiroj të tërheq vëmendjen deputetëve dhe të veprohet ashtu në bazë të këtyre rekomandimeve.

Domethënë, nën një është rekomanduar që Kuvendi ta aprovojë propozimi në Qeverisë për anëtarë të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, në përbërje: zoti Janova, zoti Mustafa, zoti Sejfiqaj. Dihet që kandidati 2 e ka plotësuar obligimin dhe i ka prurë dokumentet, siç tha edhe kryetari.

Unë dola këtu të flas për pikën 3 të rekomandimeve. Të gjithë kandidatët, pas zgjedhjes, sipas Ligjit, duhet të japin dorëheqje nga anëtarësimi në partitë politike, jo vetëm nga funksionet, por nga partitë politike si thotë ligji, në pajtim me nenin 5 paragrafi 3 të Ligjit 03/L-185 të Zyrës së Rregullatorit.

Këtë po e theksoj për arsye se disa prej tyre kanë funksione politike, dhe Armend desha të ndiesh edhe ti.

Nën 4. Kemi diskutuar edhe për pikën tjetër. Rekomandohet që institucionet përgjegjëse të iniciojnë ndryshimet për plotësimin e ligjeve përkatëse në mënyrë që për bordet e agjencive të pavarura të votohet veç e veç për secilin kandidat e jo në paket, siç është rasti tash në shumicën e rasteve. Domethënë, në të ardhmen të iniciohen ndryshimet në ligje. Ju lutem! Po e kryejmë zoti Adem!

Megjithatë, ne kemi këto ditë komente në media, se po veprojmë jashtë ligjit. Dhe e gjithë kjo që ne po veprojmë, është brenda ligjit dhe këto kërkesa që po i bëjmë ne janë që të vijmë në ligj. Tjetër është që ne në propozime të ardhshme të mundohemi të propozojmë më pak kandidatë që kanë qenë aktivë në politikë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit për mirëkuptim! Nait, urdhëro, merre fjalën!

NAIT HASANI: Faleminderit kryetar!

Po më vjen mirë që Profa foli pak përpara meje dhe kërkoj që anëtarët të cilët ne po i propozojmë t'i rehatojmë një herë, e ata pastaj le të japin dorëheqje nga punët ose veprimet ku kanë qenë ata nëpër parti.

Mendoj që ZRRE ose AKRP-i janë njerëz krejt partiakë, dhe njëri më tha: po ne për parti i kemi prurë këtu. E vërtetë është!

Nijazi Ademaj, është kryetar i degës. Bedri Adolli ka konflikt interesi, se punon në Radio Dukagjini. Hajrizi, është nënkryetar i degës.

(Ndërhyrje)

KRYETARI: Vazhdo, të lutem! Përfundoi të dyja përnjëherë!

NAIT HASANI: Dhe, këtu është mirë që t'i zgjidhim këto probleme mirë e mirë. Profa tha, t'i zgjedhim këta e pastaj tjerët i bëjmë me ligj. Domethënë, ta rehatojmë veten e për tjerët tani...

Pra, është më mirë që një herë t'i zgjedhim, mos t'i shkarkojmë më. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në vazhdim kërkohet deklarimi për votim për emërimin e anëtarëve të Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë.

Deputetët emrat i kanë pasur secili. A kam nevojë t'i lexoj?

Atëherë, i kemi 3 kandidatë. Votojmë me ngritje dore!

Kush është për?

Kush është kundër?

A abstenon ndokush?

Atëherë, kanë abstenuar 2, 1 është kundër dhe tjerët janë për.

Pra, me 61 vota për, 2 abstenime dhe 1 kundër, Kuvendi i emëroi anëtarët e Bordit të Zyrës së Rregullatorit të Energjisë, si vijon:

1. Arsim Janova, anëtar,
2. Qemajl Mustafa, anëtar,
3. Besim Sejfiqaj, anëtar.

25. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë për emërimi në anëtarëve në Bordin e Aautoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare.

Komisioni për zhvillim ekonomik, infrastrukturë, tregti dhe industri e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të ARKEP-it dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Përfaqësuesi i Qeverisë? Për Komisionin funksional, fjalën e ka kryetari zoti Muhamet Mustafa!

MUHAMET MUSTAFA: E keni raportin e Komisionit përpara, ju lutem! Ne i kemi trajtuar me kujdes të gjitha pikat e Ligjit dhe të gjitha kufizimet që i bën ligji. Kemi konstatuar se të gjithë anëtarët e kanë përvojën e nevojshme, të propozuar nga Qeveria dhe sa i përket kualifikimit kandidati Nijazi Ademaj, nuk e ka kualifikimin që kërkohet me ligj. Është inxhinier i makinerisë kurse anëtarët duhet të kenë kualifikime superiore nga fusha e elektronikës, ekonomisë ose juridike.

Ju lutem, ne tash e kemi aprovuar listën por kemi problem këtu, sepse duhet Komisioni i ligjeve apo tjetërkush ta interpretojë këtë çështje. Gjithashtu, edhe këtu vlen e njëjta gjë, që duhet të kemi kujdes që ditën që emërohen duhet të deklarojnë se heqin dorë nga funksionet politike dhe nga të gjitha punët që mund të paraqesin konflikt interesi, prandaj unë e kuptoj atë që tha Naiti, por në ligj obligohet që pasi të zgjidhet ai duhet të largohet nga të gjitha detyrat që mund të paraqesin konflikt interesi. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit profesor! Është vërejtje që po na i japin edhe partnerët ndërkombëtarë shpesh. Përfaqësuesit e grupeve parlamentare?

Nait, ti fole edhe për këtë pikë, më herët?

NAIT HASANI: Unë e mbështes Profën që tha pikërisht për shkeljet dhe kemi kandidat që kanë skandale diplomatike. Skandale diplomatike! Nesër kenë me pasur përgjegjësi ju që kenë me i votua sot.

(Ndërhyrje)

E merrni vesh më vonë pra! Për mua është ekip i papranueshëm i zgjedhjes, për shkak se kanë me na kundërshtuar pikërisht këto zgjedhje nesër kur të vijmë për shkak të skandalit që i kemi pasur njerëzit nëpër ambasada. Faleminderit!

KRYETARI: Ishim në një situatë kur deputeti ngriti disa shqetësime, por nuk sqaroi.

A e do fjalën edhe ndokush, para se të shkojmë në votim? Nuk e do.

Atëherë, votojmë. Kërkohej deklarimi me votim për emërimin e anëtarëve të Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike e Postare, dhe janë 5 kandidatë.

Kush është për?

Kush është kundër?

A abstenon ndokush?

Sa deputetë i kemi në sallë? Janë 68 deputetë në sallë.

Për votuan 60, abstenuan 3 dhe kundër 3.

Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Bordit të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike e Postare, si në vijim:

1. Kreshnik Gashi,
2. Nijazi Ademaj,
3. Hajzir Hajdaraj,
4. Bahtir Adolli,
5. Shqipërim Pula.

26. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit

Komisioni për Integritet Evropian e ka bërë mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Raportuesja e Komisionit Funkcional, deputeten Luljeta Veselaj-Gutaj e ftoj ta marrë fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime.

Atëherë, urdhëro Teuta Sahatqija!

TEUTA SAHATQIJA: I nderuar kryetar i Kuvendit,
Kryeministër, kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,

Bazuar në Planin e punës së Komisionit për integritet evropian, në mbledhjen e datës 10 shkurt 2015, mori vendim për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Për këtë Komisioni formoi Grupin punues i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë është marrë me mbikëqyrjen e Ligjit me qëllim të analizimit të nivelit të zbatimit të këtij ligji.

Bazuar në mandatin e autorizuar nga Komisioni, Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit ka zhvilluar aktivitete të nevojshme dhe vizitat në terren me qëllim të mbledhjes së informatave dhe të dhënave për zbatimin e Ligjit për parandalimin e luftimit të trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Grupi punues i ka realizuar këto vizita në terren, në Ministrinë e Punëve të Brendshme, në Policinë e Kosovës, në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, në strehimore, në Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe në fund të aktivitetit të tij, Grupi punues e ka hartuar raportin me rekomandime.

Kështu, në mbledhjen e datës 7 dhjetor 2015 Komisioni për Integritet Evropian ka miratuar Raportin me rekomandime të Grupit punues dhe i njëjti është proceduar për miratim në seancë.

Duke pasur parasysh se Grupin punues e ka udhëhequr deputetja Luljeta Veselaj-Gutaj, të cilën e kisha ftuar të japë rekomandimet lidhur me mbikëqyrjen e Ligjit 04/L-218 për parandalimin e luftimit të trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Kryetar, ju lutem, e thirrni zonjën Luljeta Gutaj-Veselaj për rekomandimet!

KRYETARI: Atëherë, urdhëro!

LULJETA GUTAJ-VESELAJ: Faleminderit kryetar!

Përshëndetje i nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër, kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,

Meqë është një çështje shumë e ndjeshme kisha dashur t'i dëgjoni me kujdes rekomandimet, të cilat i kemi nxjerr si Grup punues pas një pune të gjatë dhe një diskutimi në një dëgjim publik, ku ishin të pranishëm të gjithë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore për të dhënë kontributin për këtë çështje shumë të ndjeshme.

Komisioni për integritet evropian, në mbledhjen e mbajtur më 7 dhjetor 2015, pas raportimit të Grupit punues, ka dalë me këto rekomandime:

1. Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me autoritet përkatëse të hartojë listën e treguesve lidhur me trafikimin me njerëz, me qëllim të lehtësimit të identifikimit të viktimave, në përputhje me nenin 12 paragrafi 2 të Ligjit Numër 04/L-218 për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

2. Intensifikimi i takimeve dhe ngritja e bashkëpunimit të gjithë përfaqësuesve në autoritetin kombëtar kundër trafikimit me njerëz dhe koordinatorit kombëtar kundër trafikimit me njerëz.
3. Qeveria t'i vlerësojë mundësitë e ndarjes së një linje buxhetore për blerjen e shërbimeve për mbrojtjen e viktimave kundër trafikimit dhe dhunës.
4. Krijimi i një linje të veçantë buxhetore dhe të qëndrueshme që ka të bëjë vetëm me mbrojtjen sociale të fëmijëve, duke përfshirë edhe financimin e strehimoreve që ofrojnë shërbime strehimi për fëmijë.
5. Organizatat që janë jo fitimprurëse, si strehimoret që kanë prona në emër të organizatës të mos faturohen si biznese fitimprurëse.
6. Rekomandohet krijimi i një kategorie të veçantë për faturimin e strehimoreve, dhe
7. Krijimi i një bashkëpunimi në mes nivelit komunal, strehimoreve dhe bizneseve private për t'u dalë në ndihmë strehimoreve që akomodojnë viktima të formave të ndryshme të krimit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit shumë! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare, por si po shoh, s'donë ta marrin fjalën.

Deputetët? S'po e do fjalën! Përfaqësuesi i Qeverisë, jo!

Të nderuar deputetë, vazhdojmë me votimin e raportit me rekomandimet e Komisionit për integritet evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

Lus deputetët që me ngritjen e dorës të deklarohen për votim.

Kush është për?

A ka kundër?

Abstenim?

Konstatohet se me 63 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Integritet Evropian për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

27. Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Ankesave në Komisionin e Pavarur për Media

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 3 dhjetor 2015 ka kërkuar nga grupet parlamentare që deri me datën 11 dhjetor 2015 t'i propozojnë kryetarit, zëvendëskryetarit dhe anëtarët për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për ankesa në Komisionin e Pavarur për Media.

Ftoj kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare t'i propozojnë deputetët për Komisionin ad-hoc. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë.

Ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së të propozojë 1 deputet kryetar dhe 1 deputet anëtar të Komisionit. E ka fjalën Adem Grabovci!

ADEM GRABOVCI: Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së anëtarë të këtij Komisioni i propozoj Hajdar Beqajn dhe Luljeta Veselajn.

KRYETARI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, për 2 deputetë anëtarë.

ISMET BEQIRI: Grupi Parlamentar i LDK-së i propozon Sadri Feratin dhe Adem Salijaj.

KRYETARI: “Vetëvendosja”, 1 deputet e ka për zëvendëskryetar! Nuk është këtu.

AAK-ja, nuk është këtu.

Lista serbe, 1 anëtar!

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala predsedniče!
Poslanička grupa Srpske liste za ad-hoc komisiju predlaže Jelenu Bontić.

KRYETARI: Faleminderit! “Nisma”, nuk është këtu! “6+”? Kujtimi, si zakonisht!
Të nderuar deputetë, po vazhdojmë me votim.
Kush është për këtë propozim?
Kryesuese është Luljeta Gutaj-Veselja, ta keni parasysh.

A ka kundër?

A abstenon ndokush?

Janë 65 për, asnjë kundër, asnjë që abstenon.

Konstatohet se Kuvendi i emëroi anëtarët e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për ankesa në Komisionin e Pavarur për Media.

Kërkohet nga Komisioni ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Ankesa në Komisionin e Pavarur për Media që të veprojnë në pajtim me Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media.

28. Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për zëvendësimin e një anëtari në Komisionin Parlamentar

Grupi Parlamentar i PDK-së ka propozuar zëvendësimin e 1 anëtari në Komisionin Parlamentar, si në vijim:

- Deputeti Adem Grabovci tërhiqet nga Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike dhe propozohet anëtar në Komisionin për buxhet dhe financa, në vend të deputetit Latif Gashi.

Të nderuar deputetë, kërkoj nga ju që, përmes një votimi me ngritjen e dorës, të deklaroheni për propozimin e Grupit Parlamentar të PDK-së.

Kundër nuk ka!

Atëherë, me 64 për, e urojmë Ademin për zgjedhjen anëtar i Komisionit.

Me këtë i mbyllim punimet e seancës së sotme. Mirupafshim në seancën e radhës, pas 45 minutave.

* * *

E enjte, 17 tetor
Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 14 dhjetor
Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër, zëvendëskryeministër,
Kabinet qeveritar,
Po vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e filluar më 14 dhjetor 2015.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 75 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë. Para se të procedojmë me pikat e rendit të ditës, zëvendëskryeministri zoti Hashim Thaçi e ka kërkuar fjalën.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, i nderuar kryetar i Parlamentit të Republikës së Kosovës, zoti Veseli!
I nderuar kryeministër i Qeverisë së Republikës së Kosovës, zoti Mustafa,
Të nderuar ministra,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Natyrisht se ndjejmë obligim moral, qytetarë, kushtetues, ligjor edhe politik që përsëri t'i drejtohem opinionit të brendshëm, por edhe atij ndërkombëtar rreth zhvillimeve të fundit sa i përket trajtimit nga ana e Bashkimit Evropian në raport me Republikën e Kosovës me shtetin e Kosovës. Ne jemi shumë të vetëdijshëm se ende pesë vendet e Bashkimit Evropian nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës, por në të njëjtën kohë ne falënderojmë shumë këto pesë vende që e kanë mbështetur vazhdimisht perspektivën evropiane të Republikës së Kosovës.

Këto pesë vende që nuk e kanë njohur ende Republikën e Kosovës nuk janë kundër shtetit të Kosovës, por vendimi i tyre për të njohur apo vendimit tyre për kohën se kur do të merret për ta njohur Republikën e Kosovës është çështje e tyre e brendshme dhe asgjë nuk ndërlidhet drejtpërdrejtë me Kosovën apo pse janë kundër Kosovës, ato janë shtete mike të Kosovës dhe do të vazhdojnë të jenë. Të gjitha këto vende e kanë pranuar dokumentin e presidentit Ahtisari mbi bazën të cilit ne e kemi shpallur Kosovën të pavarur dhe sovranë.

Sido që të jetë, sot kemi 111 njohje ndërkombëtare, jemi anëtarësuar në shumë organizata rajonale dhe ndërkombëtare. Jemi shumë mirënjohës Bashkimit Evropian për mundësinë që Kosova, kryeministri Mustafa në emër të institucioneve të Republikës së Kosovës të nënshkruajë Marrëveshjen e Stabilizim- Asociimit. Në të njëjtën kohë ky ishte një sukses i madh, një progres i madh, një progres substancial në të ardhmen e sigurt evropiane të Republikës së Kosovës, por dua të them me përgjegjësinë më të lartë pasi që kemi punuar për tërë këto vite për implementimin e të gjitha kriterëve dhe standardeve demokratike për të fituar të drejtën sikur të gjithë qytetarët tjerë të rajonit, pra të drejtat tona që na takojnë që ndërlidhet drejtpërdrejtë me jo vetëm kuptimin gjeografik, por edhe në kuptimin politik të trajtohemi si evropianë.

Prandaj, përsëri edhe sot dua të shpreh zhgënjimin e thellë për vonesat tërësisht të pakuptimta të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën. Këtë vonesë të Bashkimit Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën në të njëjtën kohë përsëri dua ta konsideroj edhe si provokim të rëndë dhe rezultat të paaftësisë dhe mungesës së vullnetit politik të lidershit në Bruksel. Qytetarëve të Kosovës duhet t'u thuhet e vërteta, institucionet e Republikës së Kosovës, Qeveria, Kuvendi, Presidenca, komunat të gjitha autoritetet që kanë qenë të ndërlidhura në procesin integruar evropian kanë implementuar në tërësi kriteret e kërkuara nga Bashkimi Evropian për Kosovën, përkundrazi dua ta them se Bashkimi Evropian ka kërkuar kriteret shtesë për Kosovën edhe ato i kemi mirëpritur, i kemi implementuar dhe i kemi dorëzuar, dhe sot nuk futen në një raport teknik që kërkohet një punë prej dhjetë minutash në kompjuter.

Prandaj, vlerësoj se është një marrëzi që të shtyhet ky proces qoftë edhe për disa ditë e më për disa javë. Ani se dikush mund të thotë se ende nuk ka dalë raporti, po kjo është e vërtetë dhe ne e dimë se ende nuk ka dalë raporti. Po është e vërtetë se duhet t'i thuhet qartësisht Kosovës dhe qytetarët e Kosovës se çka përmban raportin, a i ka kryer Kosova punët apo s'i ka kryer, e jo vetëm me një formulim të paqartë. Edhe institucionet e Kosovës edhe qytetarët e Kosovës janë lodhur me formulimet shterpe perspektivë evropiane, shpresë evropiane, drita në fund të tunelit ne qorr nuk jemi asnjë. Përkundrazi jemi më evropian se gjithë qytetarët e rajonit.

Sot, opinioni në Kosovë në krahasim edhe me shumë vende tjera të Bashkimit Evropian është më proevropian dhe pro NATO-s dhe kjo duhet të na bëjë krenarë. Ky orientim provlerave euroatlantike nuk është as i nevojës as i zorit në kuptimin fizik por është mishërimi i vlerave tona dhe kjo duhet t'i thërras, ky realitet kosovar duhet ta thërras ndërgjegjen e lidershit evropian për vendim të drejtë për Kosovën.

E kam theksuar dhe e theksoj edhe sot këto vonesa absurde dhe të qëllimshme janë të padrejta për Kosovën jo vetëm të padrejta por në të njëjtën kohë mund të nxisin edhe fenomene negative për vendin tonë dhe përsëri të akuzohemi dhe të bllokohemi ne apo të fajësohemi ne.

Është e vërtetë Kosova vazhdon të mbetet për fat të mirë kampione në luftë kundër ekstremizmit fetar, kundër terrorizmit është vlerësim ndërkombëtarë i sekretarit të Shtetit të Bashkuara të Amerikës zotit Kery për vlerësim të të gjitha vendeve tona mike.

Por edhe është e vërtetë se ne duhet të lëvizim më shpejtë kah Bashkimi Evropian dhe këto të arritura duhet t'i pranojnë edhe në Bruksel.

Po, nuk mund të themi se edhe Kosova nuk është argat i këtij kundër mentalizmi sikur edhe vendet tjera. Ndërsa sa më tepër zgjat ky izolim i Kosovës, po aq më i rrezikshëm bëhet ky fenomen edhe për Kosovën, sa më tepër zgjat ky izolim i padrejtë i Kosovës nga Bashkimi Evropian, po aq më tepër do të rritet edhe ekstremizmi politik në Kosovë.

Natyrishë se njerëzit mund të fillojnë edhe për projekte të tjera politike që nuk janë në kuadër të kornizave euroatlantike që është edhe vullneti i qytetarëve të Kosovës edhe vizioni i politikës kosovare, kjo nuk sjell vetëm frustrim të qytetarët, kjo është fyerje direkt që i bëhet qytetarëve të Kosovës mosnxjerrja e raportit nga Bashkimi Evropian për liberalizimin e vizave për Kosovën.

Të nderuar të pranishëm,

Ne këtu sa i përket numrave disa kemi numra më shumë jetësorë do të thotë dikush jemi më të moshuar dikush jemi gjeneratë e mesme e dikush të rinj, dikush i mbanë më mirë mend ato vitet e mëhershme por ne kemi qenë të trajtuar si qytetarë të rendit të dytë pa dashur të bëjë paralele në kohën e Jugosllavisë, asnjë nostalgji se kem as për Jugosllavinë as për Titon. Përkundrazi, por qytetari ka udhëtua në krejt Evropën me qatë realitet që ka qenë. Është një krahasim krejt paradoksal, ndërsa sot qytetari i Kosovës për fat të keq ka mbetur i izoluar në Kosovë. E ritheksoj pa dashur të bëjë ndonjë paralele mes ati sistemi dhe Brukseli, por sot vazhdon trajtimi i qytetarit të Kosovës sikur me qenë qytetar i kategorisë së dytë në Evropë.

Mos shko në dialog, nuk është zgjidhje mos me shkua në dialog. Jo, jo, se edhe ti kishe shkuar, ... edhe ti, është fat që s'ke qenë. Vjosës po i them!

Prandaj, ne duhet të vazhdojmë të punojmë këmbëngulësisht natyrisht për të ardhmen evropiane. Po në të njëjtën kohë kjo vonesë e padrejtë e Bashkimit Evropian është e vërtetë ka rrezikuar të gjitha proceset që si parlament i Kosovës, si Qeveri e Kosovës institucioni i Kosovës apo po rrezikon të gjitha proceset duke filluar edhe ai proces për normalizimin e marrëdhënieve me shtetin e Kosovës dhe Serbisë.

Dikush mund të thotë po pse keni shkua? Po cila është përgjigja, mos me zhvillua dialog, qysh normalizohen marrëdhëniet pa zhvillua dialog. Nuk jemi vendet e para që kemi luftuar me njëra-tjetrën, kemi arritur marrëveshje, mund të arrijmë paqe dhe përsëri do të integrohemi në NATO dhe në Bashkimin Evropian të dyja vendet, por jo duke qenë në armiqësi. Ne nuk e harrojmë të kaluarën, e kujtojmë shumë mirë. Por natyrisht, po punojmë më shumë për të ardhmen. Kjo vonesë e Bashkimit Evropian është e vërtetë se vonon në zbatimin e të gjitha marrëveshjeve të arritura në Bruksel dhe arritjen e marrëveshjeve të reja.

Prandaj, edhe njëherë, konsideroj se Bashkimi Evropian duhet t'i japë fund këtij trajtimi diskriminues kundër Kosovës. Përmbyllja e këtij, unë po them, trajtimi diskriminues ndaj Kosovës e ndihmon edhe paqen edhe stabilitetin në Rajon.

Natyrisht se e theksoj, durimi ynë është më i fuqishëm për të ardhmen evropiane, se sa paaftësia e lidërshit evropian, sot e lidërshit të Brukselit në raport me Kosovën, se ne tjetër rrugë nuk kemi. Ne nuk kemi ndonjë kartë, që t'i kërcënohemi askujt, as nuk kemi tjetër opsion, përpos Bashkimit Evropian dhe NATO-s dhe është mirë që s'kemi. Por, edhe duhet të jetë një guxim i madh i atyre njerëzve në Bruksel, për të vazhduar këtë ndëshkim të Kosovës. Prandaj, do të ishte me interes që ky trajtim diskriminues të ndërpritet, të trajtohemi sikurse janë trajtuar të gjithë qytetarët e rajonit.

Të nderuar të pranishëm,

I nderuar kryetar i Kuvendit, zoti Veseli,

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Miq dhe partnerë ndërkombëtarë,

Kosova është kampione në luftë kundër ekstremizmit fetar. Kosova është kampione, po, në luftë edhe kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar në Rajon, sepse tetë vjet kanë qenë administratorët ndërkombëtarë të OKB-së, na kanë ndihmuar shumë. Tash që tetë vjet po bëhet që është edhe EULEX-i këtu, ka sjellë përvojën e vet dhe i falënderojmë për punën e tyre, që kanë bërë. Ka qenë një bashkëpunim i shkëlqyer.

Këtë përvojë të cilën e ka sot Kosova, nuk e ka asnjë vend në rajon. Legjislacionin evropian, që sot e ka Kosova, asnjë vend në Rajon nuk e ka, po flas me përgjegjësi të lartë. Në cilin segment jemi më keq, se sa vendet tjera të rajonit? Bash në asnjë, as sa i përket Kushtetutës, as ligjeve, as zbatimit të ligjeve. Por, jemi këta që jemi, prandaj nuk duhet të ndëshkohemi vetëm pse jemi ata që jemi këtu.

E kam theksuar, se realisht, dhe ritheksoj fuqishëm, pa asnjë kokëfortësi, asnjë nervozë, përkundrazi me qetësinë më të madhe dhe përgjegjësinë më të lartë kushtetuese, ligjore, politike, kombëtare dhe morale. Po, qytetarët e Kosovës sot ndjehen të fyer nga kjo vonesë e Bashkimit Evropian dhe me të drejtë dhe arsyeshëm kanë të drejtë 2 milionë qytetarë të Republikës së Kosovës të ngrenë zërin e tyre të protestën ndaj këso vonese të Bashkimit Evropian.

Unë s'po them me protestua, por zërin e tyre të protestës, zëri i qytetarëve dhe institucioneve natyrisht se do të ketë efektet e veta, sepse nuk mund të kalojë asnjë justifikim i paqëndrueshëm i Bashkimit Evropian për shtyrje të këtij procesi.

Natyrisht, ky izolim nxit edhe migrimin e qytetarëve të Kosovës dhe, përsëri Kosova fajtores. Jo! Për migrimin e mëtutjeshëm të qytetarëve të Kosovës përgjegjësinë e ka izolimi që po i ndodh sot Kosovës nga Bashkimi Evropian. Dhe, këtë duhet ta themi të gjithë zëshëm, se në një formë a tjetër, të gjithë që jemi këtu kemi qenë pushtet në Kosovë. Dikush më herët në Qeveri, dikush në opozitë, kemi punuar të gjithë bashkë për të ardhmen evropiane, pa dallim partie, ideologjie, regjioni a etnie.

Dhe sot, çka? Qytetarët detyrohen shumica të shkojnë në Tiranë dhe Shkup shqiptarët që t'i marrin pasaportat, dyshtetësinë dhe t'i marrin vizat, serbët në Beograd, disa të tjerë në kryeqytete të tjera. Dhe, kush po mbetet në Kosovë, me pasaportë të Kosovës, me identitetin shtetëror të Kosovës? Ata që nuk kanë ndonjë fuqi, mund ta themi lirisht, për të përshpejtuar, filluar, përshpejtuar dhe arritjen e këtij objekti për dyshtetësinë, e drejtë kushtetuese dhe ligjore.

Edhe një herë e theksoj se është me interes që Bashkimi Evropian të na kuptojë dhe natyrisht t'i jap fund këtij izolimi dhe të na ndihmojë në implementimin e të gjitha kritereve dhe përgjegjësi që i kemi para qytetarëve dhe bashkësisë ndërkombëtare.

Ne tjetër rrugë nuk kemi e as që po kërkojmë të jemi plotësisht të durueshëm sepse edhe s'kemi tjetër rrugë, por natyrisht të kuptohet drejt zëri ynë, tek e fundit. Unë sot jam kritik, por kam qenë, dhe secili prej jush ndoshta keni të drejtë të më atakoni nga pak, sepse kam qenë një prej njerëzve më avokues të këtij procesi, por unë edhe sot besoj në Bashkimin Evropian dhe besoj fuqishëm, edhe më tepër se ata që e kritikojnë pa argumente, por tash e tutje me të vërtetë asnjë argument Bashkimi Evropian nuk e ka për të shtyrë procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuar zëvendëskryeministër!

(Ndërhyrje, polemikë)

Krejt po thonë jo! Le të deklarohen edhe kryetarët e grupeve parlamentare, se a po hapim diskutim!

(Ndërhyrje)

Atëherë, deklarohuni se s'po ju ndal! Më mirë është të deklaroheni, mos të jetë vendim..

ADEM GRABOVCI: Zoti kryetar!

Ne kemi pikën e rendit të ditës dhe është vazhdim i seancës. Çështja që e ngriti zëvendëskryeministri është shqetësim dhe e ngriti me shumë të drejtë dhe na përfaqëson të gjithëve, edhe Qeverinë, dhe me siguri është në marrëveshje me Qeverinë dhe nuk mund tash të dalë gjithsecili të shprehë teket tona, por unë kërkoj që të procedojmë me rendin e ditës.

KRYETARI: Faleminderit! Lidhja Demokratike e Kosovës! E ka të njëjtin qëndrim. Lista serbe? Urdhëro, nëse do të marrësh fjalën. E ka të njëjtin...! Edhe "6+2 njëjtë.

Vazhdojmë të procedojmë. Më vjen keq!

Të nderuar deputetë, ju njoftoj se për 5 pikat ë vijim, diskutimet kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur me 14 dhjetor 2015, por në mungesë të kuorumit, nuk janë proceduar për votim.

Prandaj, në seancën e sotme, ne procedojmë vetëm me votimin e tyre. Do të theksoj që, deri sa të shkojmë në votimin e tyre, nga 5 pika të cilat i kemi, 4 janë për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare me 2/3 e deputetëve.

Jemi vetëm 75 deputetë. Do të vazhdojmë me vetëm një pikë të rendit të ditës, që është:

1. Propozim-vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit

Ju lutem për qetësi, sepse ka të drejtë secili si do të veprojë!

Para se të procedojmë me votimin e anëtarëve të Bordit të Agjencisë Kosovare për Privatizim, të përgatitemi të votojmë. Adem, a i the emrat? 8 janë.

Dëgjo! Qeveria ka autoritet!

Tash e qesim këtë pikë në votim. Nëse ka ndokush kundër, s'voton.

Janë 8 emra, a ka nevojë t'i lexojmë? OK!

Jemi 75 deputetë të pranishëm!

Kush është për?
Kush është kundër?
A abstenon ndokush?

Ju lus, i ngritni duart ata që abstenojnë!

Atëherë, me 64 vota për, 4 kundër dhe 3 abstenime, Kuvendi emëroi kryesuesin dhe anëtarët e Bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si në vijim:

1. Petrit Gashi, kryesues,
2. Hasime Mazreku, anëtare,
3. Hamdi Jaha, anëtar,
4. Skender Komoni, anëtar,
5. Ismajl Jonuzi, anëtar,
6. Haxhi Arifi, anëtar,
7. Ranko Gjokiq, anëtar,
8. Bajram Zejnullahu, anëtar.

Mandati i kryesuesit dhe zëvendëskryesuesit është 3 vjet, kurse i anëtarëve është 2 vjet, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Të nderuar deputetë,
Më lejoni të theksoj se aktualisht nuk e kemi asnjë çështje në pritje për shqyrtim në seancën plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Do të thotë, shkojmë në pushim dimëror dhe në të njëjtën kohë kishim dëshiruar që të kthehet edhe normaliteti për të gjithë deputetët e Kuvendit të Kosovës.

I përshëndetim organet e rendit dhe organet e drejtësisë për punën e tyre, dhe shpresoj se kolegët tanë deputetë do të lirohen e të kthehen në familjet e tyre, veçanërisht para festave të fund vitit.

Urime festat të gjithëve, deputetë, media, shoqëri civile dhe përfaqësues ndërkombëtarë!
Faleminderit!

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*